

Kuvend

Qarku Berat

Arbjan Mazniku:

Faleminderit për prezencën tuaj sot në komision. Fillojmë dëgjezën e tretë, por në fakt kjo është grupi i shtatë i bashkive, qarku i Beratit, në dëgjezën me kryetarët e bashkive. Për sa i përket reformës administrative territoriale, synimi i dëgjezës është që ne të dëgjojmë opinionet tuaja në raport me ato tre që janë shpallur si kolonat kryesore të punës së komisionit. Së pari, çështja e kompetencave, gjëra që kanë të bëjnë me kompetencat që bashkitë kanë, nisur dhe nga ideja që reforma e vitit 2014-2015 ka deleguar një seri funksionesh të reja tek bashkitë, përveç atyre që kanë qenë tradicionalet, për të kuptuar si ka funksionuar zbatimi i tyre, ku ka pasur probleme, ku ka nevojë për qartësime ligjore, nëse ka kompetenca të cilat janë shumë të vështira për t'u operuar nga ana e bashkive, në qoftë se ka kompetenca të tjera të cilat bashkitë do të mendonin që të bënte sens që t'i operonin, t'i funksiononin ato. Kolona e dytë lidhet me financat vendore dhe me çështjet që kanë të bëjnë me si financohen bashkitë, qofshin nga të ardhurat e tyre, qofshin nga granti, problemet që bashkitë kanë hasur në këtë fushë, çfarë ka funksionuar mirë, çfarë s'ka funksionuar mirë, çfarë mund të përmirësohet. Dhe së fundmi, një element që i lidh të gjitha këto bashki ka të bëjë me territorin dhe qeverisjen e territorit, çështjet që kanë të bëjnë me madhësinë e bashkisë, me mekanizmin e qeverisjes, detyrat që ka kryetari, detyrat që ka këshilli, dhe ky është një element që duhet cekur. Këto janë pak a shumë kategoritë e temave që do të donim të diskutonim, t'ju pyesim dhe të marrim një opinion nga ju. Nga pikëpërshkrimi i modalitetit të punës, ne kemi rënë dakord që deputetët bëjnë pyetje të cilat mund të jenë drejtuar njërit nga kryetarëve ose të gjithë kryetarëve bashkarisht, dhe nëse pyetja është për një prej kryetarëve, përgjigjet ai kryetar që për të cilin është drejtuar pyetja. Nëse është për të gjithë, atëherë secili merr një-dy ose tre minuta për t'iu përgjigjur pyetjes. Do ju kërkonim për sa kohë që është e mundur që t'i mbajmë përgjigjet koncize, në mënyrë që t'i japim mundësi në një periudhë rreth 120 minutash, dy orësh, të mbulojmë sa më shumë çështje që mund të prekim në këtë dëgjezë publike. Pika e tjetër që kam të rëndësishme të theksoj është që një pjesë e pyetjeve të cilat mbeten pa përgjigje, ne pasi të bëjmë zbatimin, do t'jua çojmë dhe me shkrim, në mënyrë që të keni mundësi t'i përgjigjeni eventualisht nëse ka pyetje që kërkojnë të dhëna specifike apo një shtjellim më teknik, në mënyrë që më pas të administrohet nga komisioni në mënyrë të shkruar. Pra, do kemi dhe oportunitet për të plotësuar informacionin nëse diçka mungon. Kështu që kjo është pak a shumë modaliteti i dëgjezës, qëllimi i dëgjezës, sërish duke u falënderuar për kohën. Është shumë e rëndësishme gjithashtu të theksoj që ky është një komision ku ne synojmë të bëjmë një bashkëbisedim, të kuptojmë nga ju, nuk ka tonet apo senset e një komisioni hetimor. Pra, nuk jemi këtu për të vlerësuar si keni punuar ju si kryetar apo institucioni juaj, por jemi këtu të interesuar për të kuptuar çfarë funksionon dhe çfarë s'funksionon dhe çfarë nuk funksionon më mirë në thelb. Është

shumë e rëndësishme dhe këtë ta theksojmë. Faleminderit shumë dhe mezi po pres që të fillojmë të dëgjojmë. Kërkesa e vetme që kam sërish është që për të gjithë kolegët dhe anëtarët e komisionit që t'i mundohemi të mbajmë pyetjet e përmbledhura, në mënyrë që t'i japim sa më shumë kohë kryetarëve për t'u përgjigjur. Ju faleminderit!

Luçiano Boçi:

Të nderuar kolegë deputetë, nderuar kryetarë të bashkive të qarkut Berat, mirë se keni ardhur në këtë dëgjezë. Konsideruar shumë të rëndësishme nga ana e komisionit tonë një komunikim i cili është në vazhden e dëgjezave që kemi ngritur në raport me publikun. Gjykojmë që edhe mendimi juaj si ofruet të shërbimeve, si kompetencë e pushtetit vendor, të dëgjoheni dhe të paraqisni para këtij komisioni mendimet tuaja, problemet dhe shqetësimet. Po, është e saktë, është e vërtetë, nuk është komision hetimor, është dëgjimor dhe këtu duhet një lloj bashkëpunimi dhe jo keqkuptim, sepse nga përvoja që kemi pasur përgjatë kësaj kohe, qasja e kryetarëve të bashkive ka qenë paksa e kompleksuar me idenë që jemi në një komision ku ne duam të nxjerrim në pah punën tuaj të keqe apo të mirë. Jo, këtu jemi për të marrë nga ju ato probleme reale, konkrete, që ju i ndesni çdo ditë në punën tuaj, në shërbimet që ofroni dhe në pushtetin vendor që ushtroni. Dhe në këtë marrëdhënie ne duam që ju të jeni të saktë në përgjigjet e pyetjeve që drejtojnë deputetët. Dhe patjetër që nga ju presim përgjigjet e sakta për shërbimin, për cilësinë e shërbimit që ju pretendoni që jepni në raport me qytetarin, pavarësisht ku është ai, në raport me mundësitë financiare që ju keni, jeni të kënaqur apo jo nga shëndoshja financiare që keni si pushtet vendor, pavarësisht bashkive, mesme apo të mëdha apo të vogla, dhe a i keni të gjitha kompetencat që parashikon ligji në bazë të funksionalitetit që ka përcaktuar ai? A jeni dakord me ndërhyrjet që herë pas here bën qeveria? E di që është pak e vështirë për ju në këtë pikë të shprehni, por komisioni është shumë i interesuar, pasi të gjitha mendimet tuaja do jenë pjesë dhe e punës përfundimtare të tij për të reflektuar ato ndryshime, qofshin dhe ligjore, që ndihmojnë punën tuaj. Dhe sigurisht, patjetër që duam mendimin tuaj për çështjen e territorit, që është një çështje që shmanget, por gjithmonë e themi që është matrica kryesore që përcakton dhe elementët e tjerë të funksionimit të pushtetit vendor, që lidhen me kompetencat, me autonominë financiare apo me aspekte të tjera. Dhe mendimi juaj për çështjen e territorit, që duhet të ekzistoni si bashki, duhet t'i bashkangjiteni bashkive më të mëdha apo të formateve të rretheve sipas variantit të PS-së, apo duhet të qëndroni ose të shtoni numrin e bashkive për shkak të largësive të mëdha që ndërtohen në territor me qytetarin ku cedon pas prej kësaj largësie dhe çështja e shërbimeve, e mungesës së tyre, por dhe e cilësisë së tyre. Duhet të shmangni çfarëdo lloj konfliktualiteti që e kemi hasur vazhdimisht. Qëllimi i anëtarëve të komisionit, i dy akrave, nuk po bëj ndarje, është krejtësisht një qasje më shumë marrje problemesh. Nuk jemi këtu për të bërë lëvdata administrative sa e bukur ka qenë reforma e 2014-s në raport me 2005-ën, apo përcaktime që është bërë ky investim, i cili nuk do bëhet për 500 vite. E kemi dëgjuar dhe këtë, për 500 vite. Absurditete të tilla që hyjnë në pjesën e lëvdatave. Patjetër që dikush do thojë që s'jemi dhe për të sharë reformën e 2014-ës. Jemi për ta korigjuar atë në ato elementë që ajo ka dështuar apo në tërësinë e saj ku shfaqet qartë dështimi në raport me pritshmëritë që ajo ndërtoi, qëllimet për të cilat ajo u bë. Pra, në këtë nivel duhet mbajtur edhe pjesa e dëgjezës, por sidomos pjesa e

përgjigjeve që ju do jepni. Të jeni të bindur që në qoftë se ju paraqisni shqetësime reale, konkrete, ato do reflektohen. Në qoftë se ju i fshini ato për arsye, qofshin këto dhe politike, dhe jeni shumë të lumtur me situatën që është, qoftë të funksionalitetit, kompetencave apo financave, besoj që edhe kjo do reflektohet më pas edhe në përfundimet që do ketë ky komision. Pra, tregohemi të sigurtë me njëri-tjetrin kur ka kamera shumë e vështirë, por këtë do e kërkoja nga pjesa juaj me insistim. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Dhe më tej me pyetjet. Nëse një nga deputetët ka një pyetje apo një çështje për të ngritur në raport me gjërat që kemi, që folëm.

Eno Bozdo:

Po. Faleminderit përshëndetje kryetarëve dhe kryetares së bashkisë. Disa pyetje që kanë lidhje me performancën e bashkive tuaja, ju lutem mbani shënim që të kemi mundësi pastaj t'i kthehemi. Do të isha i interesuar të kisha statistika në radhë të parë midis mënyrës se si i keni ndarë investimet në përqindje. Do të thoja, do desha shifra investime për frymë në qytet kundrejt versus investime për frymë në zonat rurale, për secilën nga bashkitë tuaja. Do desha gjithashtu dhe shifra që kanë lidhje me popullatën, popullatën në bashkinë tuaj në vitin 2015 versus popullatën në bashkinë tuaj në vitin 2026-2025, çfarëdo lloj të dhënë të jeni. Do desha të jepnit të dhënat për çështjet të shpenzimeve, sa kanë ndryshuar ata, rritur apo ulur, sepse një ndër premisat e reformës territoriale të vitit 2015 që vinte me centralizimin e territorit ishte dhe ulja e shpenzimeve. Në atë kohë u tha që Shqipëria do të, për shkak të kësaj reforme, do të kursente rreth 80 milionë euro në vit, pikërisht për shkak të uljes së numrit të punonjësve ekonomisë së shkallës. Ku jemi me shpenzimet 2015 versus 2025, meqë se 2026-ta është në vazhdim dhe sa përqind e buxhetit tuaj shkon për investime? Pyetja tjetër që kam është për secilin nga kryetarët, është duke parë ndarjen territoriale siç është tani, a mund të më thoni jeni të kënaqur me këtë ndarje territoriale? Jeni kundra kësaj ndarje territoriale? Mendoni që bashkimi apo ndarja e mëtejshme, cilado nga opsionet, mund të sjellë një performancë më të mirë të bashkisë tuaj në të gjitha kuptimet? Pra, dhe në kuptimin e investimeve, ekonomisë së shkallës, investimeve, por edhe në kuptimin e ekonomizimit të shpenzimeve. Pyetje specifike që kanë lidhje gjithashtu me territorin, pavarësisht se ne përqipemi ta shmangim këtë, sepse siç u tha dhe nga dy bashkëkryetarët, temat për të cilat jemi këtu janë krejt tjera. Ajo që në fund të ditës, atje ku konkludohet, është territori gjithmonë. Pse territori? Sepse territori vendos mbi gjithçka. Është e kotë që ne të flasim për rentabilitetin e investimeve nëse nuk marrim parasysh territorin. Është e kotë të flasim për investime në zonat rurale dhe mundësinë për t'i kushtuar vëmendje nëse nuk marrim parasysh territorin. Ashtu si ka një limit në ngarkesën fiskale, ku një ngarkesë më e madhe fiskale pastaj çon detyrimisht në evazion, në bindjen time personale ka një limit, veçanërisht në Shqipëri, për shkak të gjeografisë së saj, për shkak të thyerjes ekstreme të terrenit, dhe qarku Berat e ka në një pjesë të madhe këtë gjë, të centralizimit të mëtejshëm, çka do të thotë që centralizimi i mëtejshëm mund të çojë lehtësisht në një mungesë të shtuar të shërbimeve, të investimeve, ashtu si edhe tjetra, copëtimi ekstrem mund të çojë në mungesë të

efektivitetit të shpenzimeve. Ajo që ne përpiqemi të gjejmë këtu, në rastin e qarkut Beratit, por jo vetëm në rastin e qarkut Beratit, është a kemi një ekuilibër të artë midis dy pamjeve, fushave të ekuacionit? Kush është ndarja më e mirë territoriale, e cila çon ekzaktësisht në atë që ne kërkojmë? Çfarë kërkojmë ne në fund të ditës? Ne kërkojmë bashki që të kenë mundësi t'i shërbejnë qytetarit si në qendër, ashtu edhe në zonat rurale. Bashki që të bëjnë drejtësi në investimet në qendër versus investimet në zonat rurale. Bashki të cilat nuk dyfishojnë apo trefishojnë numrin e punonjësve, siç është rasti në të gjithë Shqipërinë, për këto para i marrin dhe i çojnë për investime, për shërbime publike, për gjithçka që komuniteti. Bashki ku edhe qytetari më i largët ka një të drejtë të trokasë, të dëgjohet dhe zëri i tij, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, të shprehet në këshillin bashkiak. Ky do të ishte, në koncept, një pushtet ideal vendor dhe duhet të gjejmë pikërisht këtë lloj ekuilibri. Kështu që unë mendoj që, në qoftë se do kemi shifra dhe ju mund t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve, do kemi një panoramë pastaj më të gjatë për të vazhduar diskutimin. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Do të doja që të bëjmë një podcast. Fillojmë me zonjën Luljane dhe pastaj me radhë me secilin prej kryetarëve për të gjithë pyetjet që besoj të keni mbajtur shënim për t'i kaluar. Faleminderit!

Juliana Memaj:

Shumë faleminderit! Shumë faleminderit të nderuar anëtarë të këtij komisioni. E vlerësojmë këtë dëgjës. Në fakt, desha të theksoj në momentin që gjithsecili prej nesh zgjidhet kryetar bashkie, nuk do t'i shikojë më punët apo shërbimet ndaj komunitetit me ngjyra politike. Ndaj ne jemi këtu për të thënë atë që duhet në funksion për t'i shërbyer sa më mirë komunitetit të cilit përfaqësojmë. Unë jam kryetare e bashkisë Dimalit, një bashki e cila për nga territori ka një sipërfaqe prej gati 170 km² dhe banorë në gjendje civile 40 mijë banorë, ndërsa në census afërsisht 28 mijë e 132 banorë. Pra, një bashki e menaxhueshme, gati 99% e qendër-fshati me rrugë nacionale janë të lidhura me asfalt. Investimet janë në një proporcion shumë të drejtë midis qendër, 41% nga buxheti, nga të ardhurat, gati raporti është mesatarisht 38% e buxhetit të bashkisë Dimal në këto vite shkon për investime kapitale. Ky është një ndarje e drejtë dhe kryesisht shkon në zonat rurale, duke qenë se edhe bashkia Dimal ka një karakteristikë, me kryesisht ka karakter rural. Gati 41% e investimeve të realizuara në këtë bashki janë me karakter urban dhe 59% e saj janë me karakter rural. Është bërë një ndarje e drejtë në të gjithë territorin, duke mos anashkaluar asnjë pjesë të tij. Ka qenë një vëmendje e theksuar. Desha të them që nga statistikat që ne kemi, gati 63 mijë lekë të vjetra janë për frymë investimet, ndërsa kostoja e këtyre investimeve shkon te 37 mijë lekë të vjetra. Pra, investohet dy herë më shumë sesa mblidhet në territor. Po të vësh re statistikat e bashkisë Dimal, vjet re, një rritje të ardhurave nga viti 2015 e kemi gjetur me 80 milionë lekë të reja dhe e kemi çuar në total në 200 milionë lekë të reja. Pra, ka një rritje të konsiderueshme të të ardhurave. Kjo kemi pasur edhe një rritje të tarifave në vitin 2017 dhe kjo falë për t'i shërbyer komunitetit rural, sepse ka nevoja të vazhdueshme për shërbime në ato zona, kryesisht në mirëmbajtje rrugë rurale apo në kanale kulluese, ku ne kemi bërë një punë shumë të

mirë në këto vite, duke bërë të mundur edhe shtimin e sipërfaqeve të serave në ato zona, duke qenë se është dhe një zonë intensive bujqësore dhe eksporton gati 25% të eksporteve të gjithë Shqipërisë. Është bërë një, patjetër që ka problematika. Unë mendoj që atë sfidën e 2014-s e kemi tejkaluar me sukses, sepse kemi arritur të jemi pranë qytetarit, jemi një bashki me potencial ekonomik dhe jemi përpjekur që çfarë mbledhim nga ajo zonë ta rikthejmë dy herë më shumë dhe të kemi investime në çdo zonë. Nëse ishte kjo një nga problematikat dhe mendoj se nga shërbimet në të cilat ne kemi qenë më efikasë, që ishte një nga pyetjet e juaja, kanë qenë shërbimet në sektorin ujitje-kullim, shërbimet në parashkollorë që janë përmirësuar ndjeshëm, jo vetëm në bashkinë tonë, por në çdo bashki, gjithashtu shërbimi i Zerfikës, edhe nga vetë raportet të ndryshme të bëra dhe nga organizatat tuaja, edhe jo nga ne, nga Koplani për shembull, është përmirësuar ndjeshëm para reformës territoriale. Gjithashtu, edhe strehimi social nga programet buxhetore që janë në tërësi gati 20 programe buxhetore. Ne arrijmë, sepse në fakt, nga çka është parashtruar në këto dëgjesa më shumë lidhet me funksionalitetin, qëllimi i kësaj reforme të re. Besoj që ka problematika shumë në funksione, edhe në kompetencat e bashkive. Kishte një tendencë shumë pozitive me ligjin e 2015-s, ku bashkitë gati po t'i rendisë ato kompetenca, mbase ligjet janë gati 37 kompetenca, me programe buxhetore i bie të jenë 20 programe buxhetore. Nga ajo që bashkia Dimal buxheton çdo vit, gati 17 funksione janë të buxhetuara në buxhet dhe ngelen jashtë tre funksione, por jo për faj të bashkisë Dimal. Do të doja shumë që ato që kemi folur shpesh, në fakt, edhe nëpër dëgjesa, edhe në këshillin konsultativ, shpesh nuk merren parasysh që ne parashtrjmë si përfaqësues të komuniteteve vendore në përkthimin e akteve ligjore apo nënligjore. Ka pasur tendencë të centralizimit në disa prej funksioneve. Një shembull ka qenë ai i Ussjellësit, që në fakt ne kemi qenë bashkautorë me delegimin e aksioneve tona në qendër, por ka rezultuar jo i suksesshëm kjo kompetencë. Gjithashtu, problematika në lidhje me kompetencat ka në bujqësi. Mendoj që, duke qenë edhe si një zonë, a po e zgjata shumë? Duke qenë një zonë me karakter kryesisht rural, vëmendja ime ka qenë e theksuar në këtë fushë kompetence. Mendoj që bashkitë nuk kanë kompetenca fare në fushën e bujqësisë. Janë të shkruara në Ligjin për Zhvillimin, për Ligjin e 2015-s, nja 4-5 kompetenca. Nga ajo që ushtrohet me efikasitet është ujitja dhe kullimi. Mund të themi deri diku dhe mbrojtja e tokës, sepse ajo është më e ndërthurur se më shumë është legjislacion, ndërsa pjesa tjetër nuk është efikase. Flitet aty për një regjistër ferme që, duke mos qenë i integruar me qendrën apo duke mos qenë implementimi sipas Ligjit për Zhvillimin Rural, i krijimit të bursës virtuale që është shkruar në ligj, është po ende nuk është bërë efikase. Nuk ka një standard të regjistrit të fermës për çdo, mbase u tejkalova pak në këtë pjesë, për çdo njësi vendore që të jetë e integruar dhe, në fund të ditës, të dalë me një bursë virtuale që është një kërkesë e herëpas-herëshme e komuniteteve që ne përfaqësojmë. Gjithashtu, edhe pjesa e shëndetësisë, do të thoja, ka një konflikt, edhe pse në Ligjin e 2015-s.

Eno Bozdo:

Po. Zonjë Kryetare, pyetjet e mia ishin shumë specifike. Ju lutem, mbajini pyetjet e mia. Nuk i pyeta për shëndetësinë, nuk i pyeta, edhe pse mund të bëja një mijë pyetje. Ju lutem, atëherë edhe njëherë: investimet, shpenzimet, stafi 2015-2022. Nëse mendoni që

jeni korrekt, jeni okay me këtë lloj territori apo propozoni ndarje të re sipas jush? Këto ishin katër shtyllat që unë pyeta. Ju lutem shumë, diçka më thatë. Kjo është kërkesë edhe për zotërinjtë kryetarë. Ju lutem, i mbahemi kësaj, sepse do kemi mundësi pastaj të merremi ndoshta me gjëra të tjera, por ajo që mua më intereson janë këto të dhëna. Faleminderit!

Juliana Memaj:

Në rregull, po. Për pjesën e investimeve e shpenzimeve, unë fola. Kemi një raport të drejtë të biles me një mesatar gati 38% të buxhetit zgjedh nga investimet kapitale në bashkinë Dimal. Me rritjen e pagave, kjo është ulur pak në 33% në vitin e fundit 2025, se patëm një efekt të rritjes së pagave që na e impakton buxhetin. Ajo që për reformën territoriale, edhe për ndarjen, atë që theksuat ju, unë jam e mendimit që bashki të tilla si bashkia Dimal, me një shtrirje të tillë, janë efikase në ofrimin e këtyre shërbimeve. Reforma e 2014-s, në fakt, kishte qëllim krijimin e disa bashkive me qendra urbane dhe të ishin të ndërthurura, urbane dhe rurale. Unë ndaj një mendim që ka bashki që, për shkak të karakterit të tyre, duhet të jenë më të vogla se ç'janë, jo në këto përmasa kaq të mëdha, sepse lihet pas dore pjesa rurale e tyre. Faleminderit! T'ju përgjigja, për çfarë? T'ju përgjigja, po se keni pasur mendjen. Popullata me regjistret të gjendjes, e kam thënë që në fillim, ishte 40 mijë banorë për urën vajguore, për bashkinë Dimal, më fal, dhe me censusin e fundit është 28 mijë e 132 banorë. Ka një rritje nga statistikari i vitit 2025, e vetmja bashki që rezulton me rritje popullsie nga censusi. Kjo falë edhe vetë atyre njerëzve punëtorë të ndershëm që punojnë tokat e tyre dhe është një... Po pra! Këtë pyetjen e stafit e kam dëgjuar me shumë herë. Ne kemi ruajtur një numër të ulët të stafit. Në administratë kemi gati 63 numër punonjësish si administratë, në total gati 300 punonjës. Kemi pothuajse të njëjtin numër pas shkurtimeve që bëmë të 2015-s, sepse patëm një shkurtim gati në 120 veta, kur e morëm në fillim që bëmë reformën territoriale. Mund të themi që kemi ruajtur një numër të ulët për të qenë efikas dhe të mund të kishim shpenzime kapitale në buxhetet tona. Dua të theksoj që, edhe pse me akte ligjore apo nënligjore, me akte ligjore dhe nënligjore, shpesh na janë rritur struktura të bashkisë që kemi pasur detyrim ligjor që të shtojmë punonjës, për shembull, siç kemi shtuar zjarrfikëset, më pak kemi se ç'kemi pasur. Mund të them te 13-14 punonjës.

Arbjan Mazniku:

Okej, dikush nga kryetarët e tjerë, ju lutem, mirë është që këto pyetje t'i marrim të gjithë. Kush ka informacion dhe mund ta ndajë? Zoti Ajdari, faleminderit.

Kreshnik Hajdari:

Do mundohem të jem shumë konkret, ashtu sikurse e kërkoi edhe deputeti. Do t'i filloj pyetjet me radhë. Ndarja e investimeve për frymë ishte të popullsisë në bashkinë Kuçovë. Dua të them që kjo ndarje ka qenë, ka goxha ndryshim nga 2015-a. Në fakt, nuk e kam informacionin për 2015-ën, por kam informacionin të 2017-ës, që ka qenë 759 lekë të reja për frymë në 2017-ën, ndërkohë në 2024-ën, është informacioni që kam unë, është 2410 lekë për frymë. Investimet për frymë. E kupto, e kupto, po pra, po, po pra, po, do ta them, po ishte edhe për frymë edhe do ta them edhe edhe atë. Ndërkohë, në investime që janë

bërë në territorin e bashkisë Kuçovë, kryesisht ato që kanë të bëjnë me infrastrukturën, domethënë rrugë, ujësjellës, kanalizime, shkolla. Besoj unë ka patur një ndarje të drejtë dhe në qoftë se flasim për qytetin vetëm, gjatë këtyre viteve janë bërë rreth 20 investime me një vlerë 405 milionë lekë. Këtu, në fakt, nuk janë ato investime që kanë të bëjnë me mbrojtjen ndaj shtresave sociale, në banesa apo rikonstruksioni që u bëjnë familjeve nevojë. Për njësinë Kozare janë 7 investime me vlerën 212 milionë lekë, përafërsisht. Në njësinë Perëndi 7 investime me vlerën 261 milionë lekë dhe në njësinë Lumas janë bërë 4 investime deri në fund të 2025-ës, pra. Me një vlerë përafërsisht 570 milionë lekë. Unë besoj se nga 4 njësi administrative që ka Kuçova, kjo është një ndarje e drejtë në kuadrin e investimeve dhe vëmendja duket edhe nga numri apo edhe nga vlera e investimeve që është pothuaj e barabartë në të gjithë territorin e bashkisë. Për sa i përket numrit të popullsisë, numri i popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile është pothuaj i njëjtë. Ndërkohë, sipas censusit ka një rënie prej 1000, rreth 1000 banorë. Sipas regjistrit janë 55 mijë banorë, ndërkohë sipas censusit të fundit janë afërsisht 34 mijë banorë. 55 me 34. Shpenzimet për pagat. Unë do të flas në përqindje. Në fakt, është ajo që tha edhe kolegja ime parafolëse, Eliana e Dimalit, që nuk është se kemi patur de facto numër të rritur të administratës, me përjashtim të atyre që sipas ligjit na janë deleguar funksione, sepse vërtetë ishim më pak në 2015-ën në momentin që u finalizua reforma territoriale, por mos harrojmë se në 2016-ën na janë transferuar arsimi parashkollor. Kështu që ndoshta kjo krijon dhe atë perceptimin që është rritur numri i punonjësve. Ka patur një rritje të vogël, por ato janë edhe për shkak të funksioneve që janë deleguara, si për shembull zjarrfikësja apo mbrojtja e pyjeve apo shërbime të reja që të cilat ne kemi vazhduar t'i ofrojmë, si për shembull menaxhimin e mbetjeve apo shërbime të tjera në fushën sociale që ne kemi krijuar dhe që natyrisht kanë kërkuar një rritje të numrit të fuqisë punëtore. E them në vlerë leku, e them në vlerë leku. Në raport me buxhetin, me buxhetin e gjithë bashkisë, sot shpenzime paga zënë afërsisht gjysmën e buxhetit total të bashkisë. Dhe kjo është e pandryshuar në 5 vitet e fundit. Dhe që të kalojmë edhe te pika tjetër se sa përqind buxhetit zë numri i punonjësve, është 410 total. Në 2015-ën, përpara se të transferoheshin në 2017-ën, 375, në qoftë se... 410. Në raport me buxhetin, shpenzime paga në bashkinë Kuçovë, thashë nga 2020-ta dhe në vijim zë diçka më pak, 48-49% të buxhetit total të bashkisë. Kurse përqindja e investimeve përsëri ka një stabilitet edhe te kjo pjesë. Gjithë pjesa tjetër, 50% tjetër, ndahet ndërmjet shpenzimeve operative dhe investimeve, që do të thotë nga viti 2020, nga viti 2020, më fal, dhe në vijim, pjesa e investimeve zë rreth 22-23%, varion në këto shifra. Për sa i përket...

Luçiano Boçi:

Kryetar, ja një ndërhyrje e vogël që të sqarojmë edhe kryetarët e tjerë të bashkive. Për çështjen e investimeve, kur kërkohet si pyetje nga deputetët, qoftë për frymë, qoftë investimet totale, ju duhet të ndani cilat janë investimet që vijnë nga buxheti i bashkisë dhe investimet që vijnë nga ministritë apo grantet konkurruese, FSZ-ja. Nuk duam FSZ dhe ministri. Pyetja që bëjnë deputetët është nga buxheti i bashkisë, se për këtë jemi këtu, që të shohim atë anën financiare, se kështu siç e interpretoni ju, pastaj i bie që çdo gjë është okay, jeni në rregull, sa bukur, sa mirë, por nuk kemi funksionalitet. Pra, qartazi, në qoftë se do ta japësh të ndarë, jepet të ndarë, nuk ka asnjë lloj problemi. Ne na intereson

edhe e kanë për të gjithë kryetarët e bashkive, buxheti i bashkisë për investime, jo këto tjerat. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Edhe njëherë, këtu kryetar, edhe njëherë butonin se ishte.

Kreshnik Hajdari:

Po, fal. Në total, meqë bëtë ndërhyrjen atë, nderuar deputet, në total në bashkinë Kuçovë janë rreth 17 miliardë lekë të vjetra investime gjatë kësaj periudhe, ku rreth 40%, në qoftë se flasim për vlerë leku, janë nga mbështetja e qeverisë, qoftë nga ujësjellës, kanalizimet, qoftë nga thirrjet që bëjnë ministrinë të caktuara, si në shkolla apo Ministria e Bujqësisë apo Emergjencia Civile. Ndërkohë, një shifër rreth 8 miliardë lekë, më fal, 7 miliardë lekë të vjetra, flas, janë të bëra investime të kryera me buxhetin e vetë bashkisë. Urdhëro.

Eno Bozdo:

Okej, okej, në rregull, në rregull. Unë mendova, faleminderit zotit Boçi që e sqaroi, mendova që pyetja ishte e qartë, e kërkesa ishte e qartë nga buxheti që keni, nga buxheti juaj, jo nga transportet, nga buxheti juaj që keni, sa përqind të këtij buxheti e ndani për investime? Dakord, pra. Dhe tjetër... Dakord, kjo duhet.

Kreshnik Hajdari:

E dhashë përgjigjen, pra ajo ishte përgjigjja që nga 2020-ta, që kam këtë informacion sot me vete, deri në vitin 2024, përqindja e investimeve... Okej. Ndërkohë, pyetja e fundit, nëse jam i saktë, kishte të bënte edhe me ndarjen aktuale territoriale, është apo s'është e duhura bashkim apo ndarje? Unë besoj se bashkia Kuçovë përgjithësisht mund të quhet që është në territorin e saj natyral. Natyrisht, në 2015-ën, veç asaj që njihet si rrethet e dikurshme, është bashkuar edhe ish-komuna Lumas, sot Njësia Administrative e Lumas, që tipologjikisht ose historikisht mund të ketë qenë më e atashuar me Beratin sesa me Kuçovën, por duke qenë se në gjithë këto vite, pas viteve '90, por edhe më përpara, pjesa më e madhe e banorëve të Njesisë Administrative Lumas kontaktin e kanë me bashkinë Kuçovë, janë transferuar me banim një pjesë goxha e mirë e këtyre banorëve, nuk e quaj të... jo të udhës ose nuk e quaj gabim që të vazhdojë të jetë me bashkinë Kuçovë. Një shtim më tepër, në qoftë se flasim në termat e funksionimit, mund edhe të diskutohet, por në qoftë se flasim në termat thjesht territorial dhe historik, nuk besoj se do t'i ngjiste bashkisë Kuçovë. Natyrisht, edhe ndarja patjetër që nuk besoj do të ishte efektive, domethënë copëtimi i mëtejshëm i bashkisë Kuçovë. Gjithë pjesa tjetër, 2 njësitë administrative, Perëndi, Kozare dhe vetë qyteti i Kuçovës, janë, po themi, në habitatin e tyre normal të territorit. Besoj se...

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, Ajdari.

Kreshnik Hajdari:

Në qoftë se ka nevojë për shtesë.

Arbjan Mazniku:

Zoti Mema.

Adriatik Mema:

Mirë, faleminderit. Edhe unë do mundohem të jem sa më konciz, nisur edhe nga përgjigjet që dhanë parafolësit e mi dhe t'ju përgjigjem ekzaktësisht pyetjeve që bëri zoti Bozno. Bashkia e Skarparit mbulon një territor prej 775 km², është një bashki tërësisht me relief malor dhe shumëthyer, e përbërë nga 8 njësi administrative dhe qyteti i Qorovodës. Popullsia sot që flasim, ose e majit 2026, është 15,066 banorë, me një rënie të lehtë, afërsisht 600-700 nga census i fundit. Dhe për të qenë korrekt me pyetjet tuaja, sa i takon investimeve në qytet... Nuk e kam atë.

15,066 jemi në shifrën e 1 majit të 2026-s. Kjo është shifra e qytetit. 2015-ën nuk e kam të saktë atë numër, por di që ka një ulje jo shumë të ndjeshme, që duhet të jetë 600-700. Mund t'jua jap edhe të saktë pak më vonë. Nuk e kam.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, Mema. Të dhënat e censusit të 2011-s dhe 2023-shit, ne i marrim nga institucionet që t'i kemi thjesht për... se është e dhënë administrative që është publike dhe e kemi kollaj ta administrojmë.

Adriatik Mema:

Dy të tretat e popullsisë së bashkisë jeton në zonat rurale dhe pjesa tjetër pastaj prej 5,163 banorësh është në qytet. Sa i takon investimeve, unë mund të them që nga buxheti i bashkisë, vit pas viti, përqindja e investimeve nga buxheti i bashkisë varion nga 15 deri në 20%. Unë kam gjetur një shifër që ishte diku tek 13%. Rreth 25% kalojnë për shërbime dhe pjesa tjetër është për paga dhe sigurime shoqërore. E përkthyer në frymë për popullsinë është 4,560 lekë për frymë sa i takon investimeve dhe 8,335 sa i takon shërbimeve për frymë të popullsisë. Do të ndalem pak tek stafi, tek numri i punonjësve. Bashkia e Skarparit ka pasur në 2017-tën një numër punonjësish prej 385. Sot kemi një ulje prej... aktualisht kemi 361 punonjës. Në kohën më të mirë ka qenë 361. Në kohën më të mirë ka qenë 350, por për shkak të disa funksioneve të tjera që janë deleguar, ky numër aktualisht sot është 361. Ndërsa më pyesni për investimet, nuk mund të pretendoj si kryetar bashkie se ka një balancë perfekte midis investimeve në zonat rurale dhe ato urbane, por jemi përpjekur që edhe në zonat më të largëta të bashkisë, në territoret më të thyera të saj, t'u ofrojmë shërbimet e duhura, kryesisht në infrastrukturë rrugore, sepse ajo është edhe kërkesa kryesore e banorëve të këtyre zonave rurale. Sa i takon taksave dhe tarifave, ato nuk kanë lëvizur, janë pothuajse në të njëjtin nivel vit pas viti dhe kjo referuar dhe bazuar edhe në gjendjen ekonomike të banorëve të bashkisë. Kështu që kemi rënë, si me thënë, në një dakordësi edhe me përfaqësuesin, me këshillin e bashkisë për të ruajtur të pandryshuar nivelin e taksave dhe tarifave. Sa i takon asaj që ju pyetët

për ndarjen territoriale, nëse jemi apo jo të kënaqur me këtë që është, unë mendoj se bashkia e Skarparit është, le të themi, në shtratin e vet tradicional kulturor të identitetit të saj, kështu që nuk shoh ndonjë problematikë sa i takon këtij aspekti.

Eno Bozdo:

Kryetar, një pyetje për ju. Dhe kjo vlen pastaj edhe për zotin Zotkaj të bashkisë Poliçanit. Ju jeni dy bashki me, le të themi, tipologjinë më të theksuar rurale. Ju vetë thatë që keni 8 njësi, ish-njësi administrative, ish-komuna dikur. Tani, nga komunat më të largëta për të zbritur në qendër të bashkisë, në rastin e Skarparit, deri diku e vërtetë edhe në rastin e Poliçanit, kërkohen shumë kohë. Infrastruktura rrugore është problem, siç e thatë ju, shumë problem, por mund të kërkojë edhe 2 orë për të zbritur nga një komunë e largët deri në qendër. Pyetja ime vlen për ju dhe për... Ja, ta bëj pyetjen dhe ta saktësoj. Pyetja ime vlen për ju, vlen edhe për zotin Zotkaj. A mendoni që për këta banorë që jetojnë në këto... që jetojnë ende, se duhet thënë kjo gjë, jetojnë ende, ju flisni për 15,000 dhe që shifra s'ka ndryshuar, por ju siguroj që në qoftë se do të bëhet një census i banorëve rezidentë, i rezidencës, jo ata që kanë gjendje civile, do shikoni që kjo shifër është thellësisht e reduktuar. Por a mendoni që duke dhënë një pjesë, duke vajtur në një model më të decentralizuar në njësi, si doni, në ish-komuna, ndoshta popullata nuk do të ishte larguar, se një pjesë e arsyeve më të forta të largimit të popullatës, veçanërisht në zonat rurale, është mungesa e shërbimeve? Është mungesa e shërbimeve, nuk ka absolutisht asgjë, kjo është thelbësorja në atë farë. A mendoni që centralizimi në këtë rast i ka bërë dëm shërbimit apo mendoni që është më mirë kështu se ç'ishte dikur, kur komuna ofronte edhe investime vetë ajo, edhe i përgjigjej problemeve kryesore të banorëve rrotull në territorin e saj dhe banorët të saj? Kjo është shumë e theksuar, veçanërisht në bashkinë tuaj dhe në bashkinë e Poliçanit, pikërisht prej tipologjisë shumë rurale dhe malore dhe të vështirë që ka zona.

Adriatik Mema:

Jam pjesërisht dakord me atë që sapo thatë ju. T'ju korrigoj që në qoftë se ju thoni 2 orë, unë po ju them është 4.

Në qendrën e njësisë është 4 dhe t'i themi gjërat siç janë, por nuk mendoj se shkak... E para, ajo që thatë ju, jam dakord, domethënë ka një diferencë midis numrit të gjendjes civile dhe të rezidentëve. Kjo ndodh kudo, nuk është se ndodh vetëm në bashki, por nuk jam dakord me atë që ju thoni që shkak kryesor i shpopullimit ose i largimit të njerëzve është mungesa e shërbimeve. Unë jam duke thënë dhe këtë e them në përgjegjësi që bashkia është munduar që t'i japi shërbimet bazike edhe në zonat më të largëta. Por, për të qenë i sinqertë deri në fund, po ju them edhe diçka dhe kur them që njësi më e largët është 4 orë ose fshati më i largët mund të jetë dhe 5 orë, ndërkohë që me gramshin është 45 minuta dhe le të jemi të sinqertë, kur kam hedhur idenë e disa lëvizjeve nga në rrethet fqinje, le të themi, ose në bashki të fqinje, edhe kam testuar me banorë pikërisht të këtyre fshatrave, asnjëherë nuk e kanë pranuar, se ju kam thënë troç që është shumë afër për ju të merrni shërbimet nga gramshi, se janë 45 minuta larg, ndërkohë që për të zbritur në qytet për një shërbim që do t'ju duhet, se jo domosdoshmërisht banorët duhet të lëvizin

nga vendi ku banojnë në qytet për të marrë një shërbim të caktuar. Për shkak të identitetit të tyre, thonë: "Jo, ne jemi skrapalinjë dhe do qëndrojmë të tillë pavarësisht se janë kaq afër me gramshin apo shumë afër me Përmetin në qoftë se do marrë skajin tjetër." Kjo është e vërteta.

Eno Bozdo:

Unë e pranoj plotësisht tezën e identitetit kulturor, madje jam, nuk po them i tharë, por mbështetës i saj dhe mendoj që çfarëdo gjëje që të ndodhë, sido që të ndodhë, ka qenë problem shumë i madh ky në reformën e 2015-s, në shumë zona edhe të Beratit, identiteti kulturor, për fat të keq, nuk u mor parasysh. Nuk është rasti i Skarparit dhe nuk po flas për këtë rast. Pyetja ime kishte të bënte më shumë: mos ishim më mirë atëherë që kishim më shumë njësi? Dhe kjo është një pyetje jo për t'ju sfiduar ju personalisht, në mënyrë absolute jo, sepse nuk e kam. Kjo është një pyetje që i bëhet absolutisht të gjithë kryetarëve të bashkisë. Dikur, një njeri zgjidhej për komunitetin që ishte 2 orë, 3 orë, 4 orë larg, zgjidhej me votë, quhej kryetar komune, zgjidhej me votë, i jepte llogari në votë, ishte i interesuar t'i shkonte mbrapa çdo kërkesë, pavarësisht se vinte nga votues të majtë apo votues të djathtë, sepse ishte ai përsëri në testim. Ishte shumë i interesuar t'i mbante shpenzimet sa më të ulëta dhe jua them këtë duke pyetur shumë njerëz, miq të mitë që kanë qenë kryetarë komune në atë kohë. Pse? Sepse deshte t'i bënte nga një nder t'i çonte pak asfalt gjithsecilit, të zgjidhte një hall për një tjetër, etj., etj. Në fund të ditës, kur vinte periudha katërvjeçare, përgjigjej para komunitetit të tij për atë që kishte bërë. Në një kohë që një ndër pasojat e reformës së 2015-s ishte shuarja e përgjegjësisë përballë komunitetit, meqenëse zonat rurale, kundrejt popullatës, kundrejt zonave qytetare, kanë gjithmonë më pak popullatë. Është rasti juaj, por në bashkitë e mëdha është shumë më e theksuar kjo, 80%-90% e elektoratit jetojnë brenda qytetit. Pjesa tjetër, kjo vlen për Tiranën, vlen për Durrësin, vlen për Shkodrën, vlen për Vlorën. Ka një rënie të madhe të mungesës së vëmendjes nga kjo gjë, përveç lartësisë që është shtuar dhe përveç faktit që kush bërtet më shumë, ai merr më shumë investime. Këto janë zonat e largëta edhe përfaqësi nganjëherë nuk kanë, edhe zë për të trokitur, edhe zë dhe mënyrë për të trokitur nuk kanë. Thelbi i pyetjes sime ishte: mos kemi qenë më mirë dikur që konceptohej që ishim më keq? Më falni, nuk e kam më sfiduese për ju personalisht, por unë mendoj që kjo është një pyetje që komisioni duhet t'i japi, edhe unë personalisht, pavarësisht çfarë mendoj, duhet t'i jap përgjigje me shumë ndershmëri. Kjo është arsyeja pse po ndërhyj këtu.

Adriatik Mema:

Jo, unë s'jam duke e marrë fare personale, sinqerisht, por kur ju thashë që në bashkinë e Skarparit dy të tretat e popullsisë jetojnë në zonat rurale, kjo i shton përgjegjësinë kujtdo që do të jetë në atë karike të shikojë me vëmendje këto zona. Por a qëndrojnë ato probleme të tjera pastaj? Nuk jam duke i kundërshtuar sa i takon shpenzimeve, por në aspektin e përgjegjësisë, sepse ju e ngritët në një këndvështrim gati-gati moral në raport me ta.

Juliana Memaj:

Një pyetje e thjeshtë, një përgjigje, besoj.

Luçiano Boçi:

Ja, një ndërhyrje e vogël, zoti Mema, një ndërhyrje, sepse preke një temë që është pjesë edhe e debatit të dëgjesave që kemi zhvilluar në qarqe. Çështja e shpopullimit dhe ju thatë që mungesa e shërbimeve dhe lartësia, nuk e thatë lartësinë, por po e shtoj unë, nuk është arsyeja kryesore e shpopullimit. Ju e pranoni që është arsye, por cila është arsyeja kryesore sipas jush e shpopullimit? Se edhe ne duam të dimë edhe mendimin tuaj, domethënë, cila është arsyeja kryesore?

Adriatik Mema:

Tani ju po mbajeni dhe po thoni që mungesë shërbimesh. Lëvizjet demografike janë shumë, është një koncept shumë më i gjerë sesa të thuash që s'e marr këtë shërbim dhe po iki nga ky vendbanim. Të jemi të sigurtë me këtë. Unë jam duke thënë që po, disa zona e vuajnë këtë gjë, nuk kanë infrastrukturën e duhur, nuk kanë shërbimin mjekësor, etj., etj., nuk kanë ndoshta, le të themi, edhe arsimit sot, dinamika e arsimit nuk është ajo që ka qenë përpara disa viteve. Të jemi të sigurtë, kudo mbyllen shkolla apo bashkohen klasa dhe kjo nuk ndodh vetëm tek ne. Kudo! Kudo ndodhin! Lëvizjet demografike kudo!

Luçiano Boçi:

Kjo mbyllja e shkollave janë stop njerëz, është një informacion që unë s'e kam edhe shpyqyr që na e jepni këtu në komision. Në cilat vende, shtete mbyllen shkollat? Na sqaroni, se edhe ne ta kemi në konsideratë.

Adriatik Mema:

Jo, jo, e thashë këtë që nuk është vetëm bashkia ime, kjo që bëhet.

Luçiano Boçi:

Kudo, po, në Shqipëri po, pastaj në Shqipëri është problemi dhe prandaj, dakord, prandaj dua ta sqaroja për këtë. Në Shqipëri ndodh shpopullimi, po pra, se mungon shkolla, mungon shëndetësia, e thatë shumë mirë, mungojnë shërbimet e tjera dhe normal, por pardon, se po, po, unë jam duke thënë që në qoftë se do të marrim...

Luçiano Boçi:

Po kjo do të jetë pjesë e pyetjeve, po ishte shumë kryesore. Ja, të lutem, ta mbarojmë, zoti Mema, të lutem, se ka një rregull. Pra, se nuk e kemi, ndoshta nuk e bëra për të gjithë, vetëm se s'dua të ta shpërndaj edhe të shfokusohej, por është çështje shumë delikate dhe prandaj e ngulmova në këtë pikë. Mund të vazhdoni me përgjigjet e tjera, se e mora përgjigjen, faleminderit.

Zoti Klosi, patjetër! Jo, normal, normal, prandaj edhe ne jemi të gatshëm.

Blendi Klosi:

Unë e vlerësoj shumë shqetësimin e kolegëve për situatën e menaxhimit të territorit, por mbase edhe në farë praktike që kemi kaluar si komision tani, ne nuk mund që të bëjmë, të zgjasim me orë të tëra pyetje që ne ja dimë përgjigjen dhe meqenëse ju pyetët ku ka ndodhur tjera që mbyllen shkollat, po pse, si është jugu i Italisë? Si janë shtetet e tjera dhe zoti Mazniku mund t'ju afrojë një grafik se si e gjithë bota e ka këtë efekt. Pra, për të cilën ne e kemi vetëm efekt viteve të fundit dhe nuk e kemi efekt para 30 viteve, sepse sistemi s'e lejonte lëvizjen që njerëzit të lëviznin për mirë dhe ne nuk mund të themi që t'ia frenojmë njerëzve dëshirën për të lëvizur për më mirë dhe unë e dëgjoj dhe kryetarët dhe ashtu si zoti Bos do dhe unë e njoh shumë mirë territorin, nuk diskutohet, po as nuk ka dyshim që Bashkia e Madhe e Skarparit ju shërben njësitë periferike shumë më mirë sesa kur njësitë kanë qenë individuale. As nuk bëhej fjalë që të kishte shërbime në njësitë që tashmë Bashkia e Skarparit i mbulon me shumë korrektesë. Aq sa mundet, padyshim, kemi nevojë për më shumë, prandaj jemi tek ajo faza tjetër, ta forcojmë pushtetin lokal. Po tani që të, po, për procedurë, ju lutem, ne nuk mundet ta mbajmë peng komisionin në një pikë. Shpopullimi është një debat tjetër, ose jo shpopullimi, por lëvizjet demografike, se ashtu siç pakësohen shkollat në Skarpar, shtohen shkollat në Tiranë, në Durrës, në Vlorë, edhe në Sarandë, po doni, ku kam të ardhur, sepse kërkojnë jetë më të mirë. Tani ky debat do të duhet të kalojmë nga kjo. Për sa i përket bashkive, të pestat bashki unë i shikoj, i njoh shumë mirë territorin edhe e vlerësoj maksimalisht atë çfarë kryetarët bëjnë në shërbim të periferisë. Nuk diskutohet kjo punë tani. Ne relative është, pastaj ju thoni ashtu, ne themi kështu, mos ta mbajmë këtu, kjo është ndërhyrja për procedurë, por ajo që do të thoja është që kështu po zhvillohet gjithë bota. Greqia shkon në 5 qytete, Italia në 5 tjera dhe gjithë bota me radhë grupohen te qytetet e mëdha. Tani kështu është, ne s'mund të kthehemi, hajde të kthehemi te 400 komunitat, se po të jenë 400 komuna, do i shërbehet më mirë në çepa. S'ka shanse, zero shanse.

Luçiano Boçi:

Atëherë po e vazhdoj dhe unë pak procedurën e zotit Klosi. Sipas statistikave, sipas statistikave të fundit, Europa është rritur me 5% në popullsinë e saj dhe Shqipëria ka humbur në total 15%. Dhe po pra, po, jo, jo, se je krahasim, akoma s'je në Europë. Mirë, me lapsin ta thashë kështu, del Klos, me lapsin e europianëve del ndryshe.

Adriatik Zotkaj:

Do na lini dhe ne të themi ndonjë fjalë?

Luçiano Boçi:

Po, patjetër, zoti Zotkaj, patjetër këtu jemi, sa doni ju kohë, ne jemi në dispozicion, mos e vritni mendjen për këtë. Dhe unë thashë se do ndërhyje te zoti Klosi, ti po ndërhysh tek unë, unë jam drejtuesi i komisionit, kështu që nuk është etike nga ana jote që të ndërhysh në rastin kur flasim.

Adriatik Zotkaj:

Është hera e parë që jam me ju.

Luçiano Boçi:

Dakord, po, po ka ca rregulla që duhen respektuar këtu, siç ne, në qoftë se vijmë të bashkia jote, ke rregullat e tua dhe do mundohemi t'i zbatojmë ato. S'mund të hyj unë, jam unë filani, bamë me shqelm derës, apo jo? Ka ca rregulla, edhe këtu ka ca rregulla. Dhe po vazhdoja këtë logjikën, se shpesh spekulohet, nuk lëvizin në drejtim të qendrës. Kush është ai që ka lëvizur në drejtim të qendrës? Tirana është shtuar vetëm me 15 mijë banorë nga 2011 deri në 2023. Hapni statistikën, 15 mijë! Dhe, dhe unë nisem me census dhe censusi është statistik dhe vetëm Elbasani ka humbur 40 mijë, Shkodra ka humbur 45 mijë, Beratit 1 mijë si qark ka humbur. Është e saktë ajo që thanë parafolësit dhe qarqet e tjera kanë këtë trend humbje. Mos na thoni tani lëvizin drejt qendrës, se me ardhë nga Skarpari në Tiranë, ku me blerë shtëpi ai apo me marrë shtëpi me gjëra? Këtu çmimet janë sikur janë në Nju Jork. Tani t'i themi të vërtetat ashtu siç janë, është një ndër arsytet, okej, po faleminderit, vazhdojmë.

Arbjan Mazniku:

Kisha parasysh që se hapët temë para se ta mbyllim. Ju kërkoj ndjesë së pari se u futëm në diskutim me ne, ndërkohë që do të flasim kryetarët, por meqenëse u hap si temë thjesht për të thënë numrat, atëherë...

Të lutem, zoti Mziu, sapo foli kryetari Boçi, pse s'ndërpret një moment? Tashi, tani të lutem, të lutem, se sa foli zoti Boçi qartë për rregullat që ka funksioni, jam duke folur unë, pastaj kur mbaroj unë, mund të flisni juve. Atëherë, së pari, së pari, në vitin '89, qarku i Beratit ka pasur 222 mijë banorë. Deri në 2001-shin, në 10-vjeçaren e parë, ka humbur 29 mijë banorë ose 13%. Në censin e 2011-s, qarku i Beratit ka humbur 51 mijë banorë të tjerë ose 26.5% të popullsisë së vet. Nga 2011-ta deri në 2023-shin, ka humbur vetëm 0.7% e popullsisë. Pra, që do të thotë, nëse do të flasim për rënien e popullsisë së qarkut, rënia e popullsisë së qarkut në fazën e vet më të madhe e ka pasur në periudhën 2001-2011, meqenëse e hapëm këtë temë. Së dyti, përsa i përket qyteteve, Bashkia e Beratit, nga censusi i 2011-s, censusi i 2023-shit, është shtuar me 3.7%. Dimali është shtuar me 3.1%, Kuçova ka rënë me 0.6%, Poliçani ka rënë me 20% dhe Skarpari ka rënë me 13.3%. Ndërkohë që qarku në tërësi, siç thashë, ka rënë vetëm me 988 banorë ose 0.7%. Që do të thotë, sapo konfirmohet këtu me numra, lëvizja nga periferia drejt qendrës, që është një proces të cilin, siç e tha dhe më parë zoti Klosi, është fenomen global. Tentativa për ta bërë këtë një çështje që lidhet me shërbimet, sepse meqenëse tha zoti Bos do që kemi qenë më mirë kur kemi qenë më keq, me sa duket të dhënat na konfirmojnë një gjë, që rënia e popullsisë në qarkun e Beratit, të paktën, ka ndodhur në periudhën 2001-2011 në numrin më të madh dhe pjesa më e parë ka qenë në vitin '89-2001. Ka 30 vjet dhe është një proces sistematik. Ne kemi qenë në një situatë në të cilën kemi pasur një sistem i cili i mbante njerëzit me zor në fshat, i çonte me zor në ca qytete, i çonte me zor në... Kemi luftuar për ta lënë pas atë sistem dhe për të ardhur në një sistem që njerëzit të lëvizin lirshëm ku duan.

Luçiano Boçi:

Dhe jo, për vazhdim, 1%, faljeno, po e pranoj që lëvizkën në formë migrimi, 1%, dakord, 1%, po 14% e gjithë Shqipërisë, se këtu u tha një e vërtetë, regjistri i gjendjes civile ndryshon nga censusi, apo jo? Edhe s'mund të nisemi nga regjistri. Censusi e tregon qartazi dhe humbja është marrë nga censusi. Mos bëjmë sikur njerëzit po lëvizin brenda territorit në të gjithë Shqipërinë. Po, qarku i Beratit ka 1%, nuk u mohua fare as nga Eno, as nga mua një gjë e tillë, edhe përgjigjja e kryetarëve e tillë ishte dhe ka edhe një element që ndikon, është i vetmi qark që lindshmërinë e ka pozitive, se kanë dalë statistikat, i vetmi qark ndër qarqet e tjera që e ka lindshmërinë pozitive, që ka atë 1% apo pjesën tjetër. Mos e fusim në debate të paarsyeshme shifrash. Zoti Bozdo do fjalë për ju.

Adriatik Zotkaj:

Po, atëherë ne fokusi kryesor është se si ka qenë reforma e 2014-s dhe ku jemi sot, besoj. Statistikat ne i kemi çuar me shkrim dhe i keni aty, qoftë për lëvizjen e popullsisë, qoftë për shpenzimet operative, qoftë për ndarjen e buxhetit në përqindje. Unë kam gati 25 vjet kryetar bashkie, i kam kapur të dyja reformat. Do thoja për reformën e 2014-s, për mua është një reformë e dështuar. Pse? Që në krye të herës, personalisht kam kërkuar të bëhesh më përpara se të bëhesh reforma territoriale, të bëhesh reforma e decentralizimit të pushtetit, që këto pasoja ne i kemi vuajtur çdo vit edhe më shumë. Kjo nuk u bë, u bë me hapa të shpejtë. Edhe në territor, pse u bë keq edhe në territor? Sepse u mor harta, ashtu siç po merret edhe tani, dhe po hiqet vija. Këtë komunitet do zhdukim edhe këtë do lëmë për arsye të ndryshme, qoftë politike, qoftë ekonomike, apo dhe në aspekte të tjera. Pse e them këtë? Po marr me fakte dhe me prova. Dy bashki që u bashkangjiten, dy komunat që u bashkangjiten Bashkisë Poliçane, po marr kryesisht komunën Vërtopë. Komuna Vërtopë ka fshatrat si Vodica, që është vetëm 500 metra larg Beratit, u bashkangjiti Poliçanit, që distanca e tyre u largua.

Komuna për të, Komuna Tërpan, ka fshatra si Plasniku që është në Memaliej, do është 87 kilometra të vijë në Policanë. Edhe nëse kjo njësi do të zmadhohet, imagjino do 3 ditë me ardhë dhe marrë shërbimin në Skapar apo kudo që të jetë. Pra po marr 2 aspektin e decentralizimit dhe të territorit. Unë mendoj se ju do ta shikoni si komision, në qoftë se e keni seriozitetin, po s'besoj se e keni këtë edhe forcën, nuk besoj. Nuk besoj se e keni. Po po desh t'ju them edhe edhe me faktin se e kam guximin t'ju them. Nuk e keni këtë, megjithatë unë po sjell faktet dhe provat të Bashkisë Policianë. Duhet të keni parasysh, jo çdo bashki është e njëjtë, kanë specifika të veçanta. Policiani ka qenë 1 qytet industrial, ka pasur 3500 punonjës. Dhe Bashkia është i vetmi institucion që punëdhënës është punëdhënësi më i madh dhe gjithë kjo barrë i ra Bashkisë e Punësimit. Patjetër që këto bashki që kanë qytete industriale do bëjnë buxhete sociale. Dhe ne sot, edhe pse kemi bërë buxhet social, Bashkia Policianë hyn te bashkitë e gjelbra, nuk hyn te bashkitë me risk financiar. Del me të ardhurat e veta. 1. E 2-ta, Bashkia Policianë investon më shumë nëpër fshatra, 75% nga buxheti i vet i ka investime nëpër fshatra. Ka bërë qendrat urbane e 1-ra fare përpara se të fillonte reforma e Arbrit edhe e Killosit. Ka bërë qendrat urbane. Ka shtruar edhe ka bërë qendra në të gjithë qendrat e fshatrave, qendrat urbane, jo vetëm

në aty, por ka bërë asfaltimin në shumë fshatra siç është Tërpani, Pronoviku, Kalluçi, Mrakua etj. Në transferimin që na u bënë ne si komuna. Patjetër kishin ato deficitet e veta. Ne sot e kemi 0 pothuajse detyrimet karshi të tretëve si bashki. Pjesa tjetër. Kur thashë për shërbimet, ne sot ofrojmë të gjitha shërbimet si bashki, qoftë në infrastrukturë, pra kemi bërë rrugë edhe në fshat edhe në qytet edhe në lagje me të ardhurat e bashkisë, me të ardhurat gjithmonë me të ardhurat e bashkisë. Për kanalet vaditëse edhe i pastrojmë edhe investojmë te zjarrfikësit me aq mundësi sa kemi, kemi marrë pjesë, kemi angazhuar dhe forca të tjera përveç forcës zjarrfikëse, 143 punonjës të tjerë me çanta dhe me pompa dore që kemi marrë dhe u kemi organizuar operacione për fikjen e zjarreve. Për pastrimin e qytetit, për mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve, çerdheve, varrezave. Edhe kudo tjetër, kudo tjetër bashkia ka qenë efiçente dhe këto janë me shifra edhe me fakte. 1 problem tjetër që sot është në gjithë Shqipërinë, po pothuajse në zonat që kanë qenë qytete industriale dhe sot ka 1 varfëri të tillë, Bashkia Policanë nga ana sociale ka ngritur 1 qendër sociale ku i japim ushqim mëngjes dhe drekë dhe ofrojmë dhe shërbimin në banesave 176 familjeve falas. Gjithë pensionistët e Policanit e pinë kafe dhe çajin, e pinë pa lekë si asnjë bashki tjetër në Shqipëri. Nxënësit e shkollave që nuk përfitojnë nga subvencioni i arsimit. I kemi vënë furgon në dispozicion që ai fëmija që është 7 vjeç mos ta vrasë i vetëtima rrugës dhe mos ta zërë shiu. Të gjithë ato familje që nuk marrin dot strehim për arsye të ndryshme. Bashkia i subvencionon strehimin dhe paguan bashkia, pra për këto shtresa sociale që sot duhet kthyer koka më shumë se kurrë se kanë qenë gjeneralë, deputetë, ministra dhe nuk e kthejnë dot kokën nga kafeneja. Këtë duhet të shikoni ju te kjo reformë, te ata njerëzit e varfër dhe mos shikoni vetëm shifrat sa buxhet shkojnë, sa përqind buxheti shkojnë për investime, sa shkojnë këto Suedia, Kanadaja, ku dëgjova unë etj. etj. dhe donit ta ktheni në ish-kooperativat apo në ish-komunitete ekzekutive. Vërtetë ato komunitete kishin atë efiçencë, po mos harroni 1 gjë të dashur që në çdo fshat kishte maternitet. Kishte arsim, kishte qendër kulturore. Sot juve po na detyroni në qoftë se kemi bërë shpopullimin e fshatrave, do shpopulloni qytetet, automatikisht do shpopulloni qytetet dhe unë po ja them me fakte dhe me prova. Në qoftë se Bashkia Policanë sot ka të punësuar 1000, jo në bashki, po them në gjithë territorin 1068 punësuar dhe 400 biznese, të nesërmen e shkrirjes së kësaj bashkisë asnjë nuk e aty. Dhe kush kush do le ta kundërshtojë dhe të thotë të kundërtën. Le të thotë të kundërtën. A jemi ne për për zmadhimin e bashkive të mëdha? Konkretisht thashë kam 25 vjet kryetar bashkie, kam kapur edhe ish-komunitetet ekzekutive. 34 vjet me Skrapari nuk u vuj 1 gur në Policanë. Ai popull e ka vuajtur. E ka vuajtur aq shumë sa kur e kujton atë plagë sot dridhet. Edhe gjithë komuniteti i Policanit, qoftë shoqatat, qoftë këshilli ju ftoi juve si komision të vini, sepse kushtetuta e thotë duhet të vini ta bëni digjesën atje në komunitet, jo të na mbledhni këtu apo në qarkun e Beratit apo Dibrës apo kudo tjetër, sepse Berati nuk ka interes. Nuk ka interes komuniteti i Beratit, nuk shkrihet. Dakord të them. Dakord ju hajde te komunitetet atje. Sepse u bë. U bë u bë dhe reforma e 1-rë erdhi nga projekti i 1-rë ashtu si u bë dhe sot ne vuajmë këto pasoja. Tani duhet të ketë edhe çik guxim TI thuash këto gjëra. Unë personalisht e kam mbyllur karrierën politike dhe nuk më intereson lufta me pushtetin, po unë nuk mund të hesht përpara, nuk mund të hesht përpara atyre njerëzve që më kanë votuar 25 vjet rresht. Edhe thashë edhe thashë është hera e 1-rë që jam me Luçjanën, me Luçjanën ose me krahun e podestës në rastin

konkret. Këta janë e di që maznikut nuk po i vjen mirë, po do ta them edhe atë të mirë që ka bërë mazniku që do ngelet që do ngelet te pushteti vendor. 1 nga të mirat që u bë pushtet vendor u rritën pagat edhe këtë unë ta falenderoj, e kam falenderuar. Edhe publikisht, po edhe sot përpara. Pagat u rritën në administratën vendore. Kjo ka bërë kjo kjo ka bërë që të kthehen shumë, të kthehen shumë intelektualë në qytetet tona për shkak të pagave dhe pushtetin vendor sot e shikojnë e shikojnë me shumë zili për shkak të pagave. Më fal si.

Luçiano Boçi:

Po.

Adriatik Zotkaj:

Eno po edhe 1 herë për Policanin do thoja, pra ne ne u bëmë 1 kërkesë nga ana juaj, nga nga ana juaj nuk na dha edhe 1 përgjigje për ata njerëz. Ne ne ne u shikojmë me shumë vëmendje, me shumë dëshirë. E shumë dëshirë me fjalë në të gjitha edhe i ndjekim të gjithë komisionet, nuk na dha 1 përgjigje mirë do të ishte pastaj, po që për kompetencat do të flas se këtë se shiko ore nuk ka gjë më të shtrenjtë se liria, se ne ne me këta kolegë edhe të tjerët e flasim nëpër tavolina, por nuk guxon njeri ta thotë. Ne na janë hequr të gjithë kompetencat si kryetar bashkie që nga koha e Berishës që na hoqën makinat, na hoqën telefonat. E kupton sot ju na hoqën kufizimin e mandateve se ju që jeni deputetë që votoni ju keni të drejtë, ju ne që ballafaqohemi përditë me qytetarët ne s'kemi të drejtë se kush kush ka kartonin. E kupton dhe kjo është 1 shkelje e kushtetutës dhe nuk e kam personale. Pastaj mos futemi për kompetencat e tjera se unë nuk mendoj që nga 1 nga kolegët e mi sot e ndjen veten kryetar bashkie. Nuk mendoj që është kryetar bashkie. Kaq kisha se nuk po vazhdoj më shumë se po më pickon Juli dhe thotë e prishe.

Luçiano Boçi:

Faleminderit zoti Zotka, fjala për zotin Bozo.

Eno Bozdo:

Faleminderit. Zoti kryetar, meqenëse thatë që nuk na keni kthyer përgjigje, po ju kthej unë përgjigje, besoj do t'ju kthej përgjigje edhe komisiones, është diçka që është diskutuar mes nesh. Edhe unë personalisht, por kërkesat nga 3 shoqatat komunitetit tuaj kanë ardhur dhe tek unë personalisht, por kanë ardhur edhe te komisioni. Sapo të mbarojë skedula, ne besoj do kemi mundësi të vijmë atje t'ju dëgjojmë, kështu që në të gjitha rastet, në të gjitha mënyrat ne do jemi aty tek ju të dëgjojmë komunitetin apo ato grupimet e komuniteteve për të kuptuar më shumë dhe është shumë e drejtë ajo që thatë ju që duhet të zbresim terren për të dëgjuar për të dëgjuar shqetësimet dhe problemet e njerëzve, se vetëm atje mund TI kuptosh sipas, por.

Jo, jo, ne do vijmë atje pa rregulluar traktorin dhe pa bërë ndonjë gjë tjetër përveç se kësaj do vijmë pasi të mbarojë skedula. Ka vlerë shumë, madje unë ju them që unë do të vij personalisht, do TI dëgjoj, do mbaj shënim dhe edhe në qoftë se zotërinjtë e komisionit

nuk vijmë, do t'jua përcjell atyre në mënyrë shumë të fortë, sepse kam detyrimin jo vetëm si anëtar i këtij komisioni, por edhe si deputet i qarkut të Beratit dhe duhet të dëgjoj gjithë komunitetet dhe ju them me shumë ndershmëri. Tutje dallimit vertikal, nëse doni të organizoni dëgjesa në bashkinë tuaj për problemet, për të gjitha llojet e problemeve do jem prezent atje pavarësisht kush i organizon, është detyrimi im personal dhe i deputetit zotit Ismaili, pavarësisht se jemi krahu i djathtë, por kjo s'ka lidhje fare kur vjen puna tek çështjet e komunitetit. Okej, faleminderit juve.

Luçiano Boçi:

Pra zoti Zotka, do vijmë patjetër, sepse e kemi jo vetëm për çështjen e Policanit, por e kemi edhe për të gjithë zonat e tjera të Shqipërisë që kanë bërë kërkesë në komision. Ka pasur 1 ko incidencë që ndoshta kemi bërë dëgjesën qartë që para dëgjesës me kryetarët e bashkive ose anasjelltas, por kjo nuk pengon fare punën e komisionit, ata që tha Eno. Eno ka insistuar shumë te kjo pjesë dhe ne patjetër do e realizojmë. Po zoti Mziu, fjala për ju.

Xhelal Mziu:

Faleminderit bashkëkryetar. Faleminderit Xhelali.

Arbjan Mazniku:

Eno, patjetër.

Xhelal Mziu:

E kemi sa të mbarojë zonja Ulona. Në fakt, në këtë takim, në këtë takim me qarkun e Beratit dolën çështje edhe nga diskutimi që bëri kolegu Zotka për problematikat të cilat ka sot pushteti vendor. Dhe shqetësimet, në fakt, nuk është se duhet të parcelizohen shqetësimet që i konstaton Partia Demokratike apo shqetësimet që i konstaton qytetari. Ajo se çfarë është e rëndësishme është. Qytetari, pushteti vendor, duke qenë totalisht i pavarur teorikisht nga pushteti qendror, duhet të ketë në themel të saj shërbimin ndaj qytetarëve, ofrimin e shërbimeve, investimeve dhe çdo lloj nevojë që ka qytetari. Por në fakt, ne kemi bërë regres. Kemi bërë regres në raport me 2014-ën, sepse jo pak pushteti vendor ka luajtur rol negativ përse i përket mbështetjes së qytetarëve dhe unë mbaj mend që kanë qenë 2 apo 3 kauza kryesore, ka qenë kadastra urbane dhe le të thotë secili prej jush që jeni 5 kryetarë bashkie, madje të majtë, a jeni, a keni në bashkitë tuaja ju kadastrën urbane, zyrat e hipotekës? Sepse ka qenë detyrim kryesor dhe nëse ka ndokush që humb nga kjo pjesë, është pushteti vendor. Pra, çfarë do të thotë ky durim, zoti Mema? Pra, ajo çfarë ishte kauza kryesore ishte kadastra urbane, sot jo vetëm që s'janë në bashkitë tuaja, por nuk do të jenë dhe në qendrën e qarkut, se do të centralizohen në Tiranë. Së dyti, po prapë duke shkuar te kjo pjesë, sa janë targat që ju merrni? Sepse jam i sigurt, siç ndodh në gjithë Shqipërinë, ju keni pafundësisht prona të cilat nuk janë certifikuar, nuk mblidhet taksa e pasurisë dhe për pasojë e vuan buxheti juaj në raport, po themi, me vendet e tjera të rajonit. Një tjetër element, le të thotë secili prej jush, nëse ju në ato pronat publike, ju nuk jeni zot i asaj, siç është në vendet e rajonit, ku kryetari i bashkisë është pronari i

vërtetë i këtyre pronave dhe çfarë do të thotë që bën një politikë në të cilën i vjen në ndihmë bashkisë. Ju, nëse doni të ndërtoni qoftë edhe një institucion publik, ju duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Ekonomisë, Financave etj., derisa të shkoni tek zgjidhja e një burokracie totale të cilën e kam vuajtur edhe unë, por jam absolutisht e vuani edhe ju. Pra, kjo shtyllë kryesore e reformës së 2014-ës absolutisht ka dështuar dhe mjafton kjo kadastër urbane për të treguar moskompetencën, largimin tashmë jo vetëm që nuk është në bashki, por nuk është as në qendrën e qarkut dhe ndërkohë pamundësinë financiare. Tjetër element. Element tjetër ishte që do të krijohet një pavarësi financiare që do të shkonim drejt vendeve të rajonit dhe vendeve të Bashkimit Evropian. Pyetja ime është, meqenëse një pjesë prej jush edhe mund të keni qenë, nëse jo kryetarë bashkie edhe në poste të tjera, përveç Zotkajt, a është rritur grandia që jepet sot bashkive? Dhe dëgjova disa nga kryetarët e bashkive që flasin me shifra, nuk flitet me shifra, flitet me përqindje, flitet me tendencë. Kush ka qenë tendenca? Ka qenë rritje apo ka qenë ulje? Pra, çfarë do të thotë që a janë rritur progresivisht të ardhurat tuaja? A janë rritur progresivisht, po themi, grantet që jepen nga buxheti i shtetit? Absolutisht jo! Dhe ju merrni vetëm 1% të transferteve së paku që u gëzuan në fillim të vitit. 1% ka qenë, 1% merrni. Ju tregoj që vendet e rajonit nuk po merren me Bashkimin Evropian, e kanë 2-3%. Madje është aq diskriminuese saqë 1% e merr dhe Berati, por 1% e merr dhe, po themi, Poliçani apo Skrapari, të cilët janë në zona më pak fizibël për të qenë tregtare, pra çfarë do të thotë që kostoja atje është shumë më e madhe, targat janë më të vogla dhe i vendos në një disproporcion. Vendet e tjera e kanë zgjidhur. Të gjitha ato bashki të cilat nuk kanë potencialin e nevojshëm fiskal për të grumbulluar targat mjaftueshme, jepet fondi i balancimit. Cila nga bashkitë tuaja ka marrë, po themi, kompensim për shkak të targave të ulëta që ka bashkia që ju drejtoni? Ju tregoj që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian kanë një fond balancimi që të gjitha bashkitë që janë poshtë mesatarës kombëtare të targave të pushtetit vendor i jepet ky fond balancimi dhe përdoret minimalisht 1% e GDP-së së asaj transferte që ju merrni më përpara. Së dyti, le të thotë secili prej jush dhe unë e sfidoj që a keni marrë grante konkurruese si më përpara? Jepeshin grantet, ja dërgonin bashkisë apo komunës dhe bënte investimet. Sot tani ato investime i bën Fondi Shqiptar i Zhvillimit, s'ka asnjë lloj lidhjeje me ju dhe ndërkohë ju nuk arrini që të shkoni tek qytetari. Një tjetër element absolutisht negativ që ka ndikuar tek ju ka qenë ajo 7 kompetencat e 2015-ës. U kaluan kompetencat, por le të thotë secili prej jush në cilën nga kompetencat, 7 kompetencat, pastaj shkoni bëni edhe 38 kompetenca, por po merrem me 7 kompetencat, në cilën prej jush kanë qenë të mjaftueshme fondet që jepen nga qeveria për të mbuluar kompetencën? A kanë qenë të mjaftueshme paratë që vijnë në dispozicion për zjarrfikëset? A kanë qenë të mjaftueshme fondet që vijnë në dispozicion për Bordin e Kullimit? A kanë qenë të mjaftueshme financimet që jepen për vaditjen? A kanë qenë të mjaftueshme fondet që jepen për shpenzimet e personelit parauniversitar? A kanë qenë të mjaftueshme fondet që jepen për pyjet? Absolutisht nuk kanë qenë të mjaftueshme, përkundrazi ju jeni detyruar, nëse e keni bërë shërbimin, për të marrë para nga ato targat e pakta të bashkisë, për të marrë dhe atë grantin dhe për t'i mbuluar. Pra, ka ardhur kompetenca, nuk është shoqëruar me mbështetje financiare dhe për pasojë ju jeni detyruar ose të mos i kryeni këto kompetenca ose të cënoni disa targa të tjera dhe transferta që jepet bashkia për t'i dërguar diku tjetër dhe le ta thotë secili prej jush nëse

keni patur apo s'keni patur mjaftueshëm e kjo për pasojë ka sjellur që të ngelen, po themi, hektarë tokë pa u vaditur, sepse aq kapacitet keni patur ju për të rritur sipërfaqen e tokës që vaditej. Për pasojë ju nuk keni arritur, po themi, që në zona të cilat kanë përmbytje të ish-it eficientë në Bordin e Kullimit ose tek kullimi apo kanalet të cilat janë rrezik përmbytje për t'u pastruar dhe për pasojë ju ka sjellur efekte negative tek bujqësia. Jam absolutisht i bindur që nuk e keni patur kompetencën, po themi, e arsimit parashkollor siç e kanë vendet e tjera të rajonit, sepse kudo që të shkosh, përjashtuar qendrave të qytetit, të kujtojnë ato shkolla kur shkon në zonat rurale sikur jemi pas Luftës së Dytë Botërore. Shkolla pa xhama, pa dyer pa dritare, pa ujë të pijshëm dhe një situatë katastrofike dhe ndërkohë edhe pa një rrethim dhe kjo vjen për shkak të atij delegimi të kompetencës dhe pamjaftueshmërisë financiare që ka, po themi, pushteti vendor. Le të thotë secili prej jush nëse ka pasur mjaftueshëm për ta rregulluar këtë sektor shumë të rëndësishëm dhe ndërkohë kur ti nuk ke kapacitetet e nevojshme për ta mbuluar këtë kompetencë, rrënohet bujqësia. Kur ti nuk ke mjaftueshëm para tek bashkia që ju drejtoni për të rregulluar shkollat, normalisht kush është ai prindër që do ta dërgojë fëmijën në një shkollë që ka një infrastrukturë absolutisht të padëshiruar e për pasojë është zvogëluar numri i nxënësve dhe që mbyllet shkolla në zonat rurale dhe që detyrohen për të ikur me furgon, me autobus, madje duke i shtyrë ai drejtuesi i mjetit që të ketë sa më shumë për të mos bërë një apo dy apo tre furgonë, por për të shkuar me njërin e për pasojë kush është ai prindër që rrit, por do të marrë fëmijët e tij të vijë në Tiranë apo të shkojë në një nga vendet e Bashkimit Evropian për të punuar për fëmijët e tij? Pra, dhe në aspektin e arsimit, sidomos në zonat rurale, absolutisht ka dhënë efektin e saj negativ. E njëjta gjë ndodh dhe për qendrën shëndetësore. Ikni të shihni qendrën shëndetësore, duken si ato gabinat elektrike të viteve '70, madje edhe të prishura dhe që nuk shkon askush, detyrohen pastaj për të shkuar tek spitali i qendrës së qarkut apo përtej kësaj, sepse nuk ka kapacitetet e nevojshme. Edhe ky është një tjetër tregues që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në shpopullim. Le të thotë secili prej jush, këshilli bashkiak që ju keni, a është i përfaqësuar si më parë? Sepse ato bashkëkomunat që kishte secila prej bashkive tuaja kishte një këshill bashkiak, kishte ca para që i shkonin atje. Sot, po themi, po marr rastin e kryetarit të bashkisë Beratit që intereson, po themi, për të marrë rrethinat, secili do të shohë qendrën e qytetit, pastaj sa të ketë mundësi për të shkuar diku tjetër, por kur më përpara e kishin këtë.

Arbjan Mazniku:

Zoti Mziu, janë bërë 12 minuta, ju lutem që të përqendrohemi tek pyetjet, sepse t'i dëgjojmë kryetarin. Nëse ti nuk i kupton pyetjet apo problemin juaj, unë po e ngre çështjen dhe pyetjet dhe e ke mësuar sa herë që i marr fjalën unë, më ndërhyjnë. Nuk ka asnjëherë që ke 12 minuta. Ka nja 50 minuta që jena marrë këtu, domethënë duke folur... Fare s'po flas herë, por nuk ka folur njeri 12 minuta.

Xhelal Mziu:

Mos më ndërhyjnë! Pyetja ime, pyetja ime ka të bëjë edhe njëherë: Si përfaqësohet një ish-komunë që sot s'ka asnjë këshilltar? Kush është ai që e çon të drejtën atij personi? Ju

kujtoj, në vitin 2015, kur u mbyll, po themi, 373 njësitë vendore dhe filloi me 61, shkonin 36.5% e parave të buxhetit të një njësie vendore, shkonin për investime kapitale. Sot ka shkuar në 18%! Pra, gati dy herë më pak! Pra, çfarë do të thotë që atë çfarë kanë nevojë qytetarët, kanë nevojë për të patur infrastrukturë, kanë nevojë për të patur shërbime. E kundërta ka ndodhur! Është rritur shpenzimet për pagat dhe sigurimin shoqëror dhe dal tek ajo çështja e dytë themelore që ka qenë atëherë: Do t'i kursenin buxhetit të shtetit 80 milion euro. Sot, secila bashki shpenzon shumë herë më shumë për pagat dhe sigurimin shoqëror. Është rritur nga 31% që ka qenë për pagat dhe sigurimin shoqëror, kur kishim 373 njësitë vendore, sot ka shkuar në 46.5% ose është rritur 15.5% më shumë, po themi, shpenzimet që shkojnë për pagat dhe sigurimin shoqëror ose e thënë ndryshe, më shumë sesa dy herë numri i punonjësve dhe ndërkohë duhet të përmend Berati dhe Dimali që është rritur tre herë më shumë fondi. A ndjeni ju si drejtues të këtyre bashkive komod që paratë tuaja nuk shkojnë për investime dhe shpenzime operative që shkojnë drejtpërdrejt tek qytetari, por shkojnë për pagat dhe sigurimin shoqëror? Një tjetër shqetësim: Pak ditë më parë doli raporti i 4-mujorit të pushtetit vendor dhe kishim 1.6 miliardë lekë më shumë detyrimet prapambetura, pra krahasuar me 31 vjetorin, vetëm në 4 muaj u rritën 1.6 dhe midis tyre ishte dhe Dimali në 4 bashkitë dhe pyetja ime është për kryetarin: Si ka mundësi që rriten detyrimet e prapambetura në këtë 4-mujor dhe futesh në 5 bashki me performancën më të dobët përse i përket borxhit publik? Një, ja se do ta jap radhën, shkruaj, shkruaj, shënoj, shënoj! Një tjetër shqetësim, pyetja ime ishte: Sepse besoj që keni qenë koherentë me qasjen që ka ky komision bipartizan. Kemi një qasje të mazhorancës që don të shkojë drejt centralizimit, pra nga 373 njësitë vendore në 61 njësitë vendore, për të shkuar tek komitetet e partisë të asaj kohe, pra diku te 26 apo 36, varet në cilën referencë do marrin. Ndërkohë, përfaqësuesit e partisë demokratike dhe të opozitës kanë një qasje tjetër. Meqenëse ne tentojmë për të shkuar një orë më parë tek vendet e Bashkimit Evropian, Bashkimi Evropian sfidë ka decentralizimin për të qenë sa më afër qytetarëve dhe sot mesatarja e qytetarëve të një bashkie në Bashkimin Evropian është 6 deri në 8 mijë banorë për njësitë vendore. Sot ne e kemi 70 mijë. Nëse shkojmë sipas oreksit të mazhorancës, do të shkojnë nja 100 mijë apo 110 mijë. A është decentralizim nëse, po themi, në 5 bashki që ju keni, do kemi vetëm 1 apo 2, varet sipas oreksit të mazhorancës? Pra, të kemi vetëm Beratin apo qoftë edhe Beratin dhe Skraparin? A do të ishit ju dakord si kryetar i Poliçanit, i Dimalit apo i Kuçovës, a do të ishin qytetarët më... A do të ishin qytetarët... A do të ishin qytetarët... Mos bëj zhurmusin! Edhe njëherë, mos më bëj zhurmusin!

Arbjan Mazniku:

Zoti Mziu, keni marrë një 16% të kohës së komisionit.

Xhelal Mziu:

Je shumë dobët në aritmetikë, sepse kur ishte paraforcimi, kam mbajtur nja një orë e sa unë, as 15 minuta s'kam shkuar. Të nderuar kryetarë të bashkive, a do të ishit dakord që të ishte Bashkia e Dimalit, Bashkia e Poliçanit, Bashkia e Kuçovës, madje pse të mos ishte dhe bashkitë tjera të cilat kanë propozime nga baza për të rritur numrin e këtyre

bashkive? Pra, kush është qasja juaj në lidhje me këtë çështje? O mallakastër apo nga je ti mo? Edhe po mos më bëj mua zhurmusin hë! Boll tashi, mos më bëj si papagall tashi, boll! Po mund të dalësh jashtë!

Luçiano Boçi:

Dakord, a ka mundësi mos t'i ndërhyjmë njëri-tjetrit? Se ti je mësuar në atë fushatën... A ka mundësi mos t'i ndërhyjmë njëri-tjetrit tani se s'ka kuptim? Po mos i ndërhyjmë tashi, po dakord? Po tashi, s'do i vëmë kohën e deputetit? Po tashi, komision është, anëtar komisioni është...

Xhelal Mziu:

Edhe njëherë, shqetësimi i qytetarëve shqiptarë është ajo se çfarë shkon tek qytetarët. Dhe ndërkohë, ne shohim që shpopullimi, rrënimi i bujqësisë, mbyllja e arsimit, mbyllja e qendrave shëndetësore janë problematika. A do të ishit dakord ju si vendet e tjera të rajonit që të kishin qarkullimin rrugor të qytetit siç e kanë vendet e tjera të rajonit? A do të ishit dakord? Thuajeni! Ose nëse nuk e thoni, pra ju s'pas keni parë se si funksionojnë vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian. A do të ishte normale që arsimit parauniversitar të kishte kompetencën e saj dhe pushteti vendor, natyrisht i shoqëruar me financa si dhe vendet e tjera të rajonit për të patur shkolla konform standardit, për të mos patur klasa me 4 klasa me një mësues, siç ndodh në zonat tuaja rurale dhe për pasojë për të mos patur ato shifrat që vetëm në këtë vit të fundit sipas INSTAT-it, më shumë sesa 6.5% e nxënësve të shkollës është ulur numri i tyre edhe për shkak të eksodit masiv. Ishin disa nga këto shqetësime dhe do të kërkoja edhe njëherë opinionet tuaja për t'u përgjigjur, gjithmonë duke e shikuar në raport me qytetarin dhe jo oreksin tuaj personal apo linjës politike.

Arbjan Mazniku:

Mos i kërkonit dhe si t'i japim përgjigje, tamam! Se tani kjo histori, mirë që dëgjuam 25 minuta, i dua jo ashtu, nuk kam thënë këtë gjë, i dua jo sipas asaj, por sipas asaj, tani do i ndikosh edhe si do i japim pyetjet, sipas mendimit tënd, ju lutem pyetjet sipas mendimit të zotit Mziu, jo sipas mendimit tuaj!

Xhelal Mziu:

Me shokun Mazniku thotë se si duhet të përgjigjeni, tani unë edhe njëherë po ju them, nëse keni qenë të vëmendshëm dhe i keni shënuar, do të doja një përgjigje për të gjitha shqetësimet që unë transmetoj që kanë sot qytetarët, jo vetëm në qarkun e Beratit dhe në gjithë Shqipërinë dhe ndërkohë qasjen e kundërt që ne kemi me mazhorancën sot.

Arbjan Mazniku:

Zoti Ceca!

Ervin Ceca:

Faleminderit, kryetar! Atëherë në djeshëm, po unë duhet ta filloj nga përgjigjet për zotin Bozdo, sepse akoma nuk e kemi ezauruar këtë pjesë. Në lidhje me statistikat që ju kërkuat zoti Bozdo, unë do ju jap ato që unë kam disponibël, patjetër ato që nuk mund t'i jap ne do ja përcjellim në mënyrë shkresore komisionit. Po e filloj nga pyetja juaj për investimet për frymë në qytet dhe në zonat rurale, unë mund të jap një shifër totale që është e 2600 lekë për banor, por të ndarë qytet-fshat do ja nisim në mënyrë shkresore, pasi nuk e disponoj. Ndërkohë për pjesën e popullatës, për të dhënat demografike besoj u ezaurua nga zoti Mazniku. Viojmë tek pjesa e shpenzimeve për pagat, që është dhe një nga shqetësimet që ngriti zoti Mziu. Unë kam këtu statistikat e 3 viteve të fundit. Për vitin 2023, Bashkia e Beratit ka pasur 787 të punësuar, për vitin 2024, 787 të punësuar, ndërkohë për vitin 2025 numri total është 816. Mund të duket një rritje, por patjetër që kjo është e justifikuar. Në Bashkinë e Beratit ne kemi pasur një sërë investimesh vitet e fundit që kanë sjellë nevojën patjetër për rekrutim të stafëve shtesë. Unë do të përmendja këtu parkimet e reja në qytet, do të përmendja sistemin Smart Parking në kala dhe në tregun e gjelbër që patjetër kanë sjellë nevojën për të rekrutuar stafe shtesë. Pra, jemi aktualisht në shifrën 816. Në 2015 nuk e kam këtë informacion, do ja përcjellim shkresërisht. Ndërkohë, për sa i përket qasjes time për reformën territoriale, pra pyetjet që bëtë ju në fillim për reformën territoriale, unë personalisht jam pro reformës territoriale, por fokusi duhet patjetër të jetë tek funksionet dhe tek financat. Pra, mos përsërisim ato që përmendën kolegët, këtu ne kemi një sërë problematikash, kemi funksione të cilat ne kemi vështirësi për t'i menaxhuar, funksione për të cilat nevojiten financa shtesë, unë patjetër do të përmendja emergjencat civile, do të përmendja menaxhimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse, arsimin parashkollor, patjetër që kemi nevojë për financime shtesë, kështu që qasja ime personale është pro reformës territoriale. Ndërkohë, me sa munda të mbaj shënim nga pyetjet e zotit Mziu, pra a janë rritur grantet, flas për Bashkinë e Beratit, ne vitet e fundit, të paktën 6-7 vitet e fundit, kemi pasur një sërë investimesh në infrastrukturë që vijnë nga grantet, por edhe investime të vetë bashkisë me buxhetin e vet. Mund t'ju jap një shifër të përafërt, janë disa dhjetëra milionë euro që të paktën 6-7 vitet e fundit janë investuar në qytet. Për pyetjen konkrete? Më fal!

Arbjan Mazniku:

Ju lutem!

Ervin Ceca:

Po, në përqindje është 17% për 2024. Po vjen pro reformës, më fal! Pro reformës, por çfarë janë?

Arbjan Mazniku:

Zoti Zotkaj, se ka mendimin e vet çdo kryetar, kështu që ju lutem të mbarojë...

Ervin Ceca:

Jo, është jo, të lutem zoti Zotkaj, ky është mendimi im personal, është qasja ime.

Arbjan Mazniku:

O zoti Zotkaj, të lutem! Zoti Ceca, ju lutem mbaroni përgjigjen tuaj, nëse mbaruat t'ia hapim një pyetje. Faleminderit! Zonja Memaj!

Juliana Memaj:

Në vijim të diskutimit të zotit Xhelal Mziu, i cili në fakt nuk bëri pyetje konkrete, por më shumë bëri deklarata, i jap një shpjegim për atë që e renditi me performancë të ulët Dimalit, është nga bashkitë me performancë më të lartë, pasi ka gati mesataren 38% investime në buxhet, ka investuar në këto 10 vite baraz me qeverinë me të ardhurat e veta, 49% janë investimet e bashkisë, 51% janë të qeverisë dhe këto raporte s'besoj se i ka ndonjë qeveri tjetër. Për lidhje me pjesën e detyrimeve që ka Bashkia e Dimalit, ka dy koncepte në ligj, ai i fiksuar në Ligjin për Financat Vendore dhe ai në procedurat tatimore, që një e detyrim faturat tatimore kur paraqitet përballë bashkisë dhe ai me financat vendore që ne operojmë me buxhete afatmesme 3-vjeçare, i cili ka qenë një ligj i 2008-s, po u vu në eficiencë për herë të parë në 2015 me reformën territoriale, pasi ish-komunat nuk i kishin kapacitetet për t'i implementuar këto buxhete afatmesme dhe një pyetje e thjeshtë është: si kanë operuar më mirë njësitë administrative kur në ish-komunat, kur në buxhetet e tyre nuk ka pasur as 5% buxhete për investime nga ata vetë, kur vetë buxhetet e tyre kanë qenë kryesisht për paga, ne sot arrijmë të kemi një mesatare në këto 10 vjet, të paktën Bashkia e Dimali, 38% investime, 28% shpenzime operative dhe pjesa tjetër është shpenzime për paga. Ka pasur një rritje të lehtë në 2025-n, për shkak të rritjes së nivelit të pagave në bashki. Në lidhje për sa i përket kompetencave, patjetër që duhet ndërmarrë një reformë e thellë, pasi mendoj që thelbi i kësaj reforme, nëse do të bëhet një reformë e tillë, duhet të jetë e fokusuar në funksione dhe kompetencat e pushtetit vendor dhe mund t'ju them që është dhe përgjegjshmëri e opozitës fakti që ne ndodhemi në këtë qasje të centralizuar të kompetencave, për shkak të tërheqjes së opozitës nga gara e pushtetit lokal në vitin 2019. Kjo bëri të mundur që edhe të kishim një qasje të tillë, që një pjesë e kompetencave t'i drejtoheshin pushtetit qendror nga pushteti lokal. Ajo që është e rëndësishme dhe që e tha zoti Mziu është e drejtë, për pjesën e kadastrës fiskale, kadastrës ose ASHK-së, ka funksionuar shumë mirë certifikimi i AMTP-ve në atë kohë, në fillimet e udhëzimit të 2015-s, kur iu dha një rol shumë i theksuar bashkive në atë kohë dhe është bërë një punë e mirë nga drejtoritë e bujqësisë në atë kohë në lidhje me certifikimin e AMTP-ve, por që pengojnë nëpër ASHK. Unë mendoj që të paktën për zonat rurale, certifikimi i AMTP-ve duhet të jetë funksion i njësive administrative vendore, sepse e bëjnë më mirë këtë punë dhe janë më afër qytetarit dhe nuk pengohen, sepse certifikimi i AMTP-ve është një proces shumë i rëndësishëm dhe mund të ndalemi dhe në faktin e shpopullimit që nuk vjen nga mosshërbimi i njësive vendore, të paktën mendimi im, sepse vetë treguesi tregon që ka një përmirësim të ndjeshëm të ofrimit të shërbimeve, të paktën në shumë sektorë, në mbrojtje civile, sepse ka fond të dedikuar në strehim social, në zjarrfikës, në disa shërbime që janë kryer shumë mirë gjatë kësaj periudhe, patjetër ka edhe shërbime apo funksione të tjera që nuk kryhen mirë edhe për shkak të mungesës së fondeve. Është e vërtetë ajo që granti në këto vite nuk është rritur, gati pothuajse ka ngelur i njëjtë, edhe pse në vlera nominale ka pasur një rritje, por në përqindje ka ngelur te 1% i

grantit. Funkcionet që delegohen duhen patjetër në bazë të Ligjit për Financat Vendore të jenë me mesataren e 3 viteve të fundit që e kanë pasur ato institucione që e delegojnë tek ne, mesatarja e atyre duhet të vijë dhe të delegohet në bashki sipas Ligjit për Financat Vendore. Kjo nuk ka ndodhur. Për shembull, mund të them që pjesa e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, pavarësisht se të paktën në Bashkinë Dimale ne ndërmorem një iniciativë në rritjen e tarifës, mbledhjen e tarifës dhe shërbimin të komunitetit, por fondi që vjen nga qeveria është minimal, vjen vetëm për pagesat e punonjësve, pra nuk vjen për të kryer me efikasitet këtë shërbim. Të tilla të tjera mund të themi për kompetencat veç e veç, ka përplasje kompetencash, si në rastin e parashkollorit, si në rastin e lejeve të ndërtimit që u centralizuan dhe një pjesë e mirë e kompetencave të pushtetit lokal shkojnë në pushtet qendror. Ne i kemi thënë këto në çdo tryezë, në çdo takim që kemi qenë. Ka problematika, por që mund të thuash që ka qenë më mirë shërbimi qytetar para 2015-s e pas 2015-s, kjo nuk është e vërtetë. Unë vij nga një përvojë e gjatë punonjëse në ish-komunat juriste dhe e shoh shumë mirë ndryshimin. Kam pasur atë fat që të bëj një krahasim dhe them që janë shumë më funksionale sot bashkitë sesa kanë qenë ish-komunat, ku disa çështje juridike i zgjidhin në allbançe, meqë ti të kemi zënë këtë tokën se bëmë një pus, do të marrim në punë. Pa kontrata, pa shpronësim, ka pafund nga këto. Ndaj mendoj dhe jam e qasjes për pyetjen përfundimtare që bëri zoti Mziu, Bashkia e Dimalit është një bashki që ka treguar që është e pavarur nga pushteti qendror në këto vite dhe mund të menaxhohet shumë mirë. Ka një potencial ekonomik zhvillimor dhe duhet të jetë e vetme. Pastaj, mendimi im, unë e thashë që në fillim që ka bashki të tilla që kanë profile të ndryshme brenda territorit të vetë, ngaqë ato në reformën e 2015-s patën një karakter urban dhe rural, të gjitha pothuajse 61 bashkitë, ka bashki që kanë profile dhe avantazhe konkurruese si në turizëm etj., që kanë dhe një sipërfaqe shumë më të mëdha, që duhet të rishihet në ato raste, nëse të bëhen dhe bashki më shumë, sepse të jenë më afër qytetarëve, të paktën në kuadrin e shërbimit ndaj fermerëve. Faleminderit!

Luçiano Boçi:

Zonja Memaj, unë falenderoj posaçërisht se, të them të drejtën, sot mora një përgjigje për një pyetje që kemi kohë që e vërtisim dëgjesat tona, madje është angazhuar e gjithë qeveria për këtë, është angazhuar parlamenti për të gjetur atë çështjen e fajit të kompetencave. Sot e mora përgjigjen, unë dritçova, paska pasur opozita, shumë faleminderit, se në fakt për çështjen e kompetencave, jo, opozita e ka fajin, ke të drejtë. Unë po them, po të jap drejtë, sepse edhe Ligjin për planifikimin urban. Ligjin për planifikimin urban, zonja Memaj, e ka bërë opozita, atë mbi 6 kate, opozita ja ka ashtu imponuar Edi Ramës. Edhe ligjin, jo, mos e ndis, mos e ndis. Edhe ligjin për menaxhimin e ujërave e ka bërë opozita, edhe ligjin për menaxhimin e mbetjeve që ju marrin ju kompetenca, opozita e ka bërë, opozita i ka të gjitha fajet. Ka ngelur ajo, po për këtë të fundit që na ke bërë, domethënë, atëherë ne do mblidhemi veç si opozitë, do bëjmë kompetencat specifike të pushtetit. Më vjen keq që këtu s'ka në gjuhën e qeshur dështimin tuaj që

Juliana Memaj:

ju keni bllokuar nga zgjedhjet lokale në 2019-n, mos ma faturoni mua, sepse është i juaji.

Luçiano Boçi:

Ju lutem shumë dhe qasja, dhe qasja, përsërim dhe qasja, këtu duhet të jetë ajo që tha zoti Zotkaj, shumë e qartë, jo me ish-komunat 373-shin, që na morën një shembull pusi, nuk e di çfarë shembulli, është me atë çka arriti në raport me pritshmëritë, sepse për shembull, unë nuk isha ndërmend të bëja pyetje, se doja t'i lija kohë të tjerëve dhe nuk do bëj, por unë gjykoj nga ajo që parashtroni ju, që ju keni performancë të mirë, bie teza që bashkitë e vogla nuk mund të ekzistojnë. Po pra, po, bie kjo teza dhe ne jemi këtu pikërisht për të ndarë këtë shqetësim bashkë, që duhet të qëndroni apo duhet të shtohen në rastet kur largësitë janë shumë të mëdha, duhet të ketë një zgjidhje tjetër, që janë 3 orë, e pranon dhe vetë kryetari. Jo më pyetje,

Arbjan Mazniku:

Tani jo, po më tani të lutem se... Mos ta mbyll, jo, po s'është etike, po më heq mua, domethënë, se s'po e kuptoj, po jo, unë dita vetë kam mundësi fjalës. Po pra, dakord, pra do ja kalojë zoti Tjahi, po. Po pra, po, po pra, po. Po pra, po, nga ana e opozitës... Ja, një minutë, një minutë. Jo, të lutem, kanë folur dy njerëz rresht nga ana e opozitës, nuk ka folur asnjë nga maxhorancat. Dakord, dakord, dakord, po. Jo, të lutem, jepni fjalën një personi të kompetent. Ja, një minutë, të lutem, në këtë moment. Ja, pra, ja, një minutë, se jo, jo, jo, ngatërrohet një gjë, domethënë, që... Ja, ngatërrohet një gjë, tani urdhër këtu nuk më jep kush, ta kam thënë dhe një herë tjetër, po jo, s'më jep dot, jemi në pozitë të barabartë edhe unë nuk pretendoj që të jap urdhër dhe një herë, asnjë rregull nuk... Po, edhe një herë, asnjë rregull, asnjë rregull, po nuk është... Dy veta nga maxhoranca. Po, tashi, nuk është etike, nuk është etike që... Dhe një herë, nuk është etike që ndërhyt në fjalën time. Tani e tepruat, e tepruat, e tepruat. Po, e tepruat, pra. Po s'po bëj pyetje, e bëra parashtrim tashi, edhe një herë tjetër. Kaq, jepni fjalën një personi. Dhe një herë, edhe një herë, mirë, mirë, unë e kuptoj që fjala pyetje ju agjiton, se unë thashë, do bëja pyetje, po s'do bëj pyetje, se nuk e dëgjuat deri në fund. Po pra, po atëherë ta përfundoj unë. Nuk vazhdoj kjo histori, nuk mund të vazhdoj kjo histori. Edhe një herë, nuk vazhdoj kjo histori. Po fjala ime, edhe një herë, edhe një herë, ja këtu, prit një minutë, se edhe unë s'mund ta jap fjalën, se po ma ndërpret mua bashkëkryetari dhe unë po bindem. Dhe një herë tjetër, jo, po s'bëhet kjo sfidë në këtë lloj forme, se jemi edhe live, unë s'pranoj dhe sfida të tjera, jo të pranoj një sfidë kaq të vogël në komision, as mund të pranoj unë sfida të tilla në komision. Dhe një herë, dhe një herë, dhe një herë tjetër, nuk po marr setin e pyetjeve, sepse e bëra marrëveshjen me veten time që do i le kohë kolegëve, qoftë nga maxhoranca dhe opozita, por parashtrimin tim nuk dua të ma ndërpresë kush, askush, asnjë deputeti, s'mund t'ia ndërpresim dhe ne, jo më të ndërhyjmë ne në punën tonë si bashkëdrejtues. Këtu stop orkestra, është një fjalë e urtë popullore. Tani, jepini fjalën tashi, se po e bën si sfidë, po. Po tashi, mos e bëjmë tani, edhe një herë, domethënë, se unë e kuptoj shumë mirë, je live edhe je para asaj që unë duhet të jap fjalën dhe do e jap fjalën, se s'po e marr unë mikrofonin. Po e mban? Dhe po ta mbaroj fjalën, se tashi... Jo, pra, jo, jepni fjalën, thjesht kaq. Po mos e bëj si kalamamër burrë, ta mbaroj tashi, ç'është kjo

ishite, po ç'ështëë kjo ndërhyrje, unë s'e kuptoj. I keni në dy orë. Jo, jo, po jo, jepe, jepe, jepe. Jepni fjalën një personi të maxhorancës, tash. Po dakord, më dakord, po ta mbaroj, më ta mbaroj unë. Nisi pikë. Edhe një herë tjetër, edhe një herë tjetër, në qoftë se, në qoftë se, edhe një herë tjetër, në qoftë se nuk kuptoni pyetjen nga pohimi, është çështje e konceptit gjuhësor. Dhe po atëherë, atëherë jemi në momentin dhe fazën që po japim një shfaqje shumë të bukur si komision, që as unë s'e dëshiroj, as kolegët e mi, askush nuk e dëshiron, por me nerva të qeta, sepse ky komision sfidë ka edhe durimin, në fakt, se është komision që zgjat shumë. Jemi në situatën që zoti Mziu ka bërë pyetje për të gjithë kryetarët e bashkive dhe e di shumë mirë që jemi në kufizim kohe. Është shumë e vështirë me 5 kryetarë bashkish të menaxhosh një dëgjes, dy orë, kur ke dhe dëshirë nga deputetët për të folur. Të jemi logjikshëm. Kështu që është dhënë vetëm një përgjigje nga zonja Memaj dhe të vijonë dhe të tjerët në përgjigjet e tyre, se kemi ardhur të dëgjojmë kryetarët e bashkive. Parashtrimin e bëra, se mora një dëgjes.

Arbjan Mazniku:

Jo, po, jo, po, ju thashë, po do e marr patjetër, dëgjoni thashë, po patjetër, po merrem patjetër, po tani, jo, pra, bëre parashtrimin, po bëre parashtrimin, more, more fjalën. Dakord, patjetër do e fus në xhep, do e fus në xhep tani. Po ky të tregon autoritetin tënd se si është. Jo, jo, autoritetin tim e tregon, o zoti Boçi, mos, e marr patjetër dhe e para, mos abuzoni me hapësirën që ju është lënë. Jeni duke vazhduar patjetër, që ç'ke me të, mund të vazhdosh i qetë. Sot nuk mund të vazhdohet në mënyrë sistematike me abuzimin sistematik nga ana e opozitës, me hapësirën që ju është lejuar, ju është dhënë në mënyrë sistematike për të folur. Sot jemi në orën e dytë, nuk i është dhënë akoma fjala një personi të vetëm nga ana e maxhorancës dhe kjo gjëja, dhe kjo gjëja, jo, jo, dhe kjo gjëja është e padrejtë, e padrejtë dhe e palogjikshme dhe jo normale dhe të merret fjala në mes të pyetjeve për të bërë parashtrime në mënyrë sistematike. Tani ka radhën për të folur një person nga ana e maxhorancës, ju lutem, zoti Klosi.

Blendi Klosi:

Faleminderit, faleminderit, kryetar. Tani kam diskutim. S'ka asnjë koment, mos e keni bërë koment derisa keni dashur, s'ka asnjë koment, fare. Ka radhën për të bërë pyetjet, zoti Klosi. Zoti Mziu, ja kam thënë dhe herë të tjera dhe në komision, keni një meritë të veçantë që gjeni gjithmonë argumente edhe bravo ju qoftë që keni vullnetin edhe i shprehni të gjithë këto argumentat edhe me forcë, po tani ne këtu jemi për të folur dhe për të thënë disa të vërteta, sepse nuk jemi vetëm ne anëtarët e komisionit dhe kryetarët e bashkive, është një, gjithë qytetet e interesuara, njerëzit e interesuar na ndjekin edhe duan të dëgjojnë disa të vërteta që kanë të bëjnë me reformën territoriale. Unë e kuptoj të 5 kryetarët e bashkive, kur në fjalët e tyre padyshim thonë dhe çfarë mund të ishte bërë më mirë. Në fjalën e tyre thonë se si mundet që procesi i forcimit të pushtetit lokal të eci në rrugën e duhur dhe nuk diskutohet që e mira nuk është as me reformën e 2014-s, as me këtë që do bëjmë tani dhe prapë do të kemi kërkesë për një reformë tjetër ose për përmirësime tjera gjithmonë në vazhdim, por ne tani duhet të themi disa të vërteta dhe në qarkun e Beratit unë kam pasur fatin që së bashku me të 5 kolegët të shkoj në çdo fshat,

nuk ka një fshat që unë nuk e kam shkelur, natyrisht për arsye të menaxhimit territorial, por edhe të fushatave elektorale që unë kam bërë me të 5 dhe unë e di shumë mirë se çfarë thotë Adriatiku kur thotë se sa larg është Terpani me Bashkinë e Poliçanit, por po ashtu di të them që falë edhe Këmbënguljes së Adriatikut, janë bërë investime në Terpan që Komuna e Terpanit as nuk bëhej fjalë që t'i kishte realizuar. Di të them se realizimi i rrugës që e lidh Terpanin me Poliçanin dhe po ashtu rruga e re që e lidh Beratit me Tepelenën është investim real për ato zona dhe aty është kthyer jeta falë këtij menaxhimi më të mirë të territorit. Unë e di që Jolinda ka komente përsa i përket kompetencave, por di të them se sa shumë më shumë ju shërbehet fermerëve të zonës së Fushës, ku ka aq shumë prodhim dhe është nga zonat më prodhuese të vendit dhe falë asaj Bashkisë së Madhe të Urzës Vajgurore tashmë Dimal, që janë bërë aq shumë punë te kanalet e tyre dhe prodhimi i tyre falë edhe kontributit të Bashkisë së Madhe del më shpejt në treg, del shumë më mirë në treg edhe ata fitojnë më shumë para dhe më shumë mirëqenie dhe padyshim edhe aty ka probleme në të gjitha komunat e Dimalit, por ama e vërteta është që situata e shërbimeve është shumë herë më mirë dhe po kështu me të 3 kolegët për të 3 zonat, padyshim Bashkia Skraparë, e thashë dhe para, ju shërben shumë më mirë sepse ka mundësi t'ju shërbejë dhe tani për të folur për të vërtetat dhe e kam thënë në fakt edhe në takimin tjetër, po ja u them prapë, njerëzit e gjykojnë këtë punë, qytetarët e komunave nuk dëgjojnë shërret tona për përqindje se nuk dhe i kuptojnë, por ama duhet të thoni fakt në zgjedhjet e fundit në Berat, këta njerëz e kanë votuar Partinë Socialiste si në asnjë qark tjetër, 5 me 2 e kemi ndarë garën elektorale, kanë fituar në Poliçan nga 80% falë shërbimeve që ka bërë dhe Adriatiku që thotë që është tërhequr nga politika, po s'tërhiqet ai, se gënjen, edhe ai që bën sikur është i mërëzitur me reformën, e ka ndjerë reformën, komunat edhe Bashkia Poliçan, edhe kështu në të gjitha zonat fitojnë mbi 62% në Dimal, në Berat, në Skraparë, në Kuçovë, 60 e ca përqind falë shërbimeve që u janë bërë komuniteteve atje. Flisni për pagat, flisni për aparatet, flisni për aparatet, flisni për aparatet, janë disa të vërteta, janë disa të vërteta që duhet t'i themi, duhet t'i themi të vërtetat. Punonjësit e aparatit të Bashkisë së Beratit në 2014-n kanë qenë 210, në 2025-n janë 82, 61% më pak, po a janë shtuar shërbimet në Bashkinë e Beratit dhe Bashkia e Beratit si aparat është zvogëluar, megjithëse ju shërben tani 5-6 njësive, por ama ka marrë shumë më tepër shërbime dhe kjo është arsyeja pse janë shtuar punonjësit pranë Bashkisë së Beratit. Pra, Bashkimi i Njësive e ka bërë Bashkinë shumë më të fortë dhe ka rregulluar shumë më tepër situatën. Po kështu në Kuçovë, ka pasur 152 në 2014-n, ka 54, 65% më pak punonjës në aparat. Po kështu në Bashkinë Skraparë, ka pasur 195, ka vetëm 84 punonjës në Bashkinë Skraparë, pra reduktimi në njësitë qendrore ka sjellë shumë më tepër përfitime. Pra, ne jemi, dakord, më dakord, mi kanë thënë gabim, thashë, këto shifra kanë pak rëndësi për veshët e njerëzve, shërbimet dhe atë çfarë bëjnë bashkitë dhe se si e kam parë vetë Jolinën duke pastruar kanalet e Samaticës edhe Drenovicës, andej si janë ato, e kam parë Adriatikon duke hyrë në Vërmajë dhe Skraparit edhe për të shkuar për t'u kujdesur për bashkitë që ka mundësi tashmë Bashkia Skraparit t'i bëjë ato shërbime që nuk i bënin dot kurrë komunat. Tani, prandaj këto janë të vërteta dhe thashë, e vërteta më e madhe është fitorja e jashtëzakonshme e Partisë Socialiste dhe reforma që kemi bërë ne tek ata njerëz në Skraparë. Të 5 kolegët janë aty siç jemi dhe ne, duan më mirë, prandaj jemi këtu. Po të ishim ne si ju, do të thoshim shumë mirë e kemi bërë

2014-n, hajde merremi, bëjmë ndonjë muhabet tjetër tani, po ne merremi me reformën sepse duam ta bëjmë gjënë më mirë. Ne merremi me reformën se mendojmë që ka nevojë për përmirësim, ne nuk merremi me reformën për të reduktuar, për ta bashkuar një bashki me një bashki tjetër, por merremi me reformën për të kuptuar se si janë shërbimet e qytetarëve, si është Bashkia më e fortë, si ka mundësi Bashkia që të investojë, të krijojë këto ndërmarrjet e përbashkëta që po krijon tani, si ka mundësi Bashkia të bëhet vetë aktor ekonomik në jetën e komunitetit, si ka mundësi Bashkia. Dhe ka mundësinë tani dhe të 5-ta bashkitë po e krijojnë ndërmarrjet e përbashkëta për zhvillimin e ekonomisë lokale, por një komunë e vogël nuk ka pasur asnjë shansë, ka 0 shansë ta realizonte këtë që po bëjnë bashkitë e mëdha. Prandaj, s'ka më rëndësi, ju bëni debatin tuaj politik, jeni në të drejtën tuaj, shumë mirë që jemi në këtë platformë, e kam thënë dhe herë të tjera, duhet realisht të dy bashkëkryetarët, megjithëse bëjnë sikur kanë kontradita me njëri-tjetrin, po luajnë një rol shumë të mirë që kjo gjë të funksionojë, se po të mos ishin dy njerëz të mençur në drejtimin e kësaj gjëje, gjëja nuk do funksiononte, por shumë mirë që ne dëgjojmë edhe shumë mirë që kryetarët flasin jo me zërin e linjës zyrtare, po dalin edhe një çikë nga linja zyrtare, se thonë të vërtetat e territorit dhe ne duhet t'i dëgjojmë këto të vërteta. Por në qoftë se ne, pjesa e politikanëve, bëjmë më shumë debat sesa pjesa e atyre që çdo ditë duhet të interesohen për një zetar që është prishur një agregat, apo për një infermiere që nuk shkon në majë të malit, apo diku që rrëshqet toka, apo diku që duhet mbështetur prodhimi për të dalë sa më shpejt në treg, ata e dinë situatën dhe le të flasin ata më shumë sesa flasim ne. Ndjesë që fola, por realisht kam një supervlerësim për të 5 kryetarët e Bashkisë së Beratit edhe për popullin e asaj zone që realisht është i mrekullueshëm edhe na dëgjon tani dhe e vlerëson punën që ata kanë bërë. Faleminderit shumë!

Arbjan Mazniku:

Po, kush kishte ende për të folur për pyetje? Zoti Mema!

Adriatik Mema:

T'ju përgjigjem pak pyetjeve që bëri zoti Mziu, se për mendim, jo, pyetjet tuaja, s'kam folur, për pyetjet tuaja, t'ju përgjigjem pak pyetjeve të zotit Mziu, se për shkak edhe të eksperiencës së tij të mëparshme, ato që ai trajtoi në parashtrimet e tija janë pak a shumë sfidat kryesore që ndeshet një bashki, pavarësisht territorit të saj, si ka qenë, si është apo edhe si mund të jetë pas kësaj reforme. Por unë do të ndalja tek ajo që është pikante tek ai që përmendi zoti Mziu, që ka të bëjë me pronat. Regjistrimi i pronave është vërtetë një sfidë e madhe për ne, të paktën për Bashkinë e Skraparit, për shkak se kostot e regjistrimit të pronave pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë vërtetë të papërballueshme dhe kjo mbetet një sfidë për Bashkinë, në mënyrë që të gjenerohet një regjistër i saktë i pronave që disponon një bashki, në mënyrë që ajo të gjenerojë pastaj të ardhura përmes dhënies me qira apo formave të tjera ekonomike, kështu që jam dakord. Sa i takon çështjeve të tjera siç janë bordi i kullimit, kanalet vaditëse, zjarrfikëset, arsimit parashkollor, gjithkush që do të donte të kishte sa më shumë fonde në këtë, ne përpiqemi që me këto që na japin nga qeveria të administrojmë në maksimum dhe të bëjmë në efikasitet këto

shërbime që janë jetike, të paktën për Bashkinë e Skraparit, për shkak edhe të natyrës sikurse e thashë që në fillim, bujqësore dhe blegtorale të saj. Por lipset më shumë, këtë duhet ta themi, sa i takon investimeve në bujqësi. Ne administrojmë sot kanale vaditëse që janë afërsisht 132 km, fondet që marrim, duhet ta pranojmë, nuk japin një efikasitet maksimale. Ne përpiqemi që me fondet që marrim, vëmë ato të cilat janë më të përdorshme, se jo të 132 km sot janë funksionale ose të domosdoshme, por në disa zona që kanë luginë e Osumit, për shembull, që ka tokë nën ujë, ne përpiqemi që t'i vëmë ato në efikasitet. Edhe diçka tjetër që e ngritët në parashtrimin tuaj ka të bëjë me pyjet. Bashkia e Skraparit ka një specifikë të veçantë në raport me tjetrët, ka një sipërfaqe shumë të madhe pyjore, gjë që sot nuk gjeneron aq të ardhura në raport me sipërfaqen që ka. Kjo edhe për shkak se mungojnë planet e mbashtimit që janë pak a shumë si plane urbanistike, siç bëhet një plan urbanistik, ashtu lipset të bëhet edhe një plan mbashtimi për pyjet. Por dua të them edhe diçka, zoti Mziu, konstatimi që ju bëni sa i takon arsimit dhe nivelit të infrastrukturës nuk është i saktë. Në Bashkinë që unë drejtoj, nuk ka shkolla pa xhama, madje ju garantoj që investimet që janë bërë në fushën e arsimit janë nga më cilësore të bëra, të paktën 25 vitet e fundit dhe një minutë se do të pranoj edhe ato të videos, por do të tregoj dhe unë video pastaj se si kanë qenë objektet arsimore dhe se si janë sot dhe këtë ta them me përgjegjësi se siç keni qenë juve dikur kryetar bashkie, unë kam qenë drejtor arsimit dhe e di fort mirë dinamikën e kësaj, por të garantoj që investimet që janë bërë në arsim nuk ka pasur asnjë shkollë me ambiente sportive në Skrapar. Janë kryer këto vite, por nuk kam ardhur këtu të dëshmoj se çfarë kam ardhur t'ju përgjigjem pyetjeve tuaja dhe të them ato që qëndrojnë, jo një sekondë. Kështu që shkolla pa xhama, unë, unë, jo, jo një minutë, zoti Mziu, unë pranoj atë që po, janë mbyllur shkollat, unë pranoj atë që po, ka klasa kolektive, se kjo është situata e popullimit të atyre zonave. Ka dhe një problem tjetër sa i takon Këshillit Bashkiak. Ne jemi përpjekur dhe e kemi përmirësuar nivelin e përfaqësimit, por nuk jemi në maksimumin e saj. Në konceptin tim, çdo njësi administrative duhet të ketë të paktën përfaqësim në Këshillin Bashkiak. Në Skrapar që flasim sot, e kemi në 5 njësi, nuk e kemi në 3 njësitë e tjera. Kjo është një gjë që mund të konsiderohet nga ky Komision. Unë mendoj që sa kohë është ngritur një Komision i tillë, do të thotë që ka lindur një nevojë për të bërë diçka më të mirë, ka lindur një nevojë për ta parë këtë reformë tash e më mbrapa 10 apo 15 vjet kur Shqipëria do të jetë anëtare e BE-së dhe sa i takon asaj që thatë juve që bëtë lidhjen me BE-në, me numrin e popullsisë për çdo njësi të bëhet, unë di të them, ashtu sikurse ju e dini që pushteti vendor, pushteti lokal në gjithë Evropën vepron mbi parimin e decentralizimit dhe të subvencionimit. Dakord? Dhe kjo është edhe tek ne. Sa i takon pastaj madhësisë që ju më pyetët a do të jetë kaq apo si mund të funksionojë, unë di të them që vendimmarrja në çdo njësi të qeverisjes vendore në Evropë sot, sipas parimit, është në njësinë më të poshtme të mundur për të marrë vendimet e duhura në raport me shërbimet që do të marrin qytetarët. Se sa do të jetë kjo njësi e mëposhtme, do të jetë sa Skrapari apo çdo pak më tepër apo merr pak nga Skrapari, kjo nuk më takon mua, ju takon juve si Komision. Ju faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Për çështje korrekte, janë bërë dy herë pyetje nga ana e anëtarëve të opozitës, së pari nga zoti Bozdo dhe së dyti nga zoti Mziu dhe ka pasur vetëm një ndërhyrje, po e quaj pyetje nga zoti Kloca, pavarësisht se është pyetje, kështu që për çështje ekuilibri mendoj që është momenti për të bërë një pyetje tjetër nga ana e maxhorancës, t'i themi dy e dy folësit. A të marrëdhënie zoti Kloca patjetër? A në qoftë se s'ka folur, patjetër? Pas përgjigjes së zoti Zotkaj për ekuilibër. Për çështje, dëgjo, në patjetër, patjetër, po në kohën e zoti Bozdo, zoti Bozdo, zoti Bozdo, zoti, ju lutem, të nderuar, të nderuar, të nderuar kolegë, të nderuar kolegë, zoti Bozdo, sërish, zoti Cara, zoti Cara, atëherë, atëherë, ju lutem, ju lutem, o miq, zoti Cara, ju lutem...

Luçiano Boçi:

Atëherë ta marrim pak mikrofonin, meqenëse këtu mikrofonin merret në këtë lloj forme, zoti Cara, zoti Cara, po. Arogancë duke nisur nga bashkëkryetari dhe normal që përcillet kjo dhe është krejtësisht e papranueshme. E para, mos abuzoni me vullnetin tonë që duam që të reflektojmë këtu kërkesat e qytetarëve në raport me pushtetin vendor dhe të kryeni akte të tilla që përpos mesazheve negative tek njerëzit nuk përcjellin asgjë. E para, as mikrofonin nuk merret me zë, as fjala nuk merret me zë dhe erdha këtu për të folur, nuk erdha këtu për t'ju dëgjuar, se domethënë nuk e meritoni që t'ju dëgjojmë dhe meqenëse ju vazhdoni me këtë lloj arrogance, unë e di shumë mirë, në fund fare ju doni t'ia lini fajin po opozitës, se ky është synimi juaj dhe urdhërat që ju vijnë nëpër telefona, megjithatë, meqenëse ju e dëshmoni që keni këtë lloj arrogance në raport edhe me Komisionin, në raport edhe me mënyrën e sjelljes politike në tërësi, që të qetësoni ju, 5 minuta pushim, marrim vendimin tonë dhe pastaj mund të vazhdojmë. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Dhe 2 minuta do ju mbaj. Atëherë, duke qenë se nuk po kthehen deputetët e opozitës, janë të lirë të vijnë çdo moment dhe të marrin të shfrytëzojnë mbledhjen, por nuk mund të presim në mënyrë të pafundme. Meqenëse mbledhja ndërprehet për 5 minuta pushim, i dhamë gjithë kohën e duhur për t'u kthyer përtej 5 minutash. Po bëjmë më shumë se 30 minuta. Meqenëse u ndërpre mbledhja, do të doja që përpara se të mbyllim pjesën e parë të dëgjimit, nëse ka ndonjë nga kryetarët diçka që do të shtojë nga pyetjet që janë ngritur, çështjet që janë thënë, diçka që ka ngelur pa thënë, secili prej kryetarëve, nëse ka diçka për të thënë, është më se i mirëpritur përpara se të vijmë tjetrën. Kështu që kushdo që nga kryetarët që ka një merak, diçka që donte ta thoshte. Po, zoti Ceco.

Ervin Ceca:

Faleminderit, zoti kryetar. Atëherë, një, le të themi, një sugjerim të vogël në lidhje me një propozim saktë që do të doja të bëja për rishikimin e transportit të pakushtëzuar. Në bashki si Berati, por jam i bindur dhe në bashki të tjera që kanë flukse të mëdha turistike, ne kemi kosto shtesë, kosto të mëdha në ofrimin e shërbimeve. Pra, do të doja që të kishte ndonjë rishikim të formulës duke futur dhe komponentin e flukseve turistike në bazë të statistikave. Ky është më tepër një sugjerim që do të doja ta ndaja me ju.

Arbjan Mazniku:

Shikojmë shumë drejt. Faleminderit, kryetar. Ta marrim parasysh patjetër në elementin kur të diskutohet çështja e financave. Meqenëse hapët këtë temë, unë mendoj që në këtë temë ka shumë diskutime ku ky është një ndër to, po elementet e densitetit të popullsisë, përveç totalit të popullsisë, elementet e mënyrës se si bëhen elementet e taksave ndare, janë çështje që besoj që kanë vlerë për t'u diskutuar nga bashkitë. Dhe unë do ju ftoja që këto sugjerime të vijnë edhe në formë të shkruar, pasi do na ndihmojnë shumë në momente specifike kur të bëjmë këto diskutime. Faleminderit, zoti Ceco. Po.

Klevis Jahaj:

Në fakt, unë doja të përshëndesja edhe kryetarët e bashkisë së Qarkut Berat për të gjitha përgjigjet. Këtu dolën qartë në këtë dëgjim, pavarësisht propagandës që u mundua të bëhej dhe nuk kishin pyetje më saktë se sa komente, por dolën saktë se reforma e parë territoriale patjetër që ka sjellë fuqizim më të madh të bashkive dhe drejtpërdrejt ka sjellë edhe shërbim më të mirë për qytetarët. Dhe kjo patjetër që është përkthyer edhe në investime më shumë. Jam i sigurt që nuk besoj që kur kanë qenë komunat pastroheshin më shumë kanalet, i shërbehej më mirë qytetarëve, kishte më shumë investime në ujësjellës ose kanalizime, apo në infrastruktura të tjera. Besoj patjetër që ka sfida që duhen të delegohen në reformën aktuale dhe prandaj ne bëjmë këtë dëgjim me kryetarët ekzistuesë, por edhe me të gjithë aktorët e tjerë. Si gjithashtu dua të theksoj se u përmend edhe nga kryetarja e bashkisë së Dimalit në lidhje me reformën e ujësjellës-kanalizimeve, që patjetër ka funksione të cilat mund të diskutohen dhe të bëhen ndërbashkiake, për shkak të kostave që mund të ketë për menaxhimin e tyre. Dhe mjafton të përmend disa shifra në lidhje me këtë proces, jo vetëm në Qarkun e Beratit edhe në bashkinë e Dimalit konkretisht. Në qoftë se përpara reformës ka pasur një detyrim të energjisë elektrike prej rreth 200 milionë lekësh, nuk ka asnjë lloj detyrimi aktualisht. Në qoftë se më përpara ka pasur detyrime që kanë pasur operatorët e tjerë që merrnin shërbime dhe ofronin shërbime për ujësjellësin e Dimalit, patjetër që nuk kanë asnjë detyrim. Në qoftë se më përpara mbulohej 50% e kostove direkte nga ujësjellësi i Dimalit, tani vetë njësia e Dimalit mbulon 70% dhe pjesa tjetër patjetër mbulohet nga shoqëria rajonale, duke mos krijuar asnjë detyrim tjetër. Pra, këto janë shembuj konkretë që në qoftë se ka një bashkërendim ndërmjet pushteteve lokale dhe rajonalizim të disa shërbimeve të cilët mund të kenë kosto më të larta dhe janë deleguar sipas funksioneve të pushtetit lokal, patjetër që mund t'i shërbejë më mirë qytetarëve. Dhe unë besoj që ka shembull konkret të investimeve që ka sjellë qeveria ose kjo reformë në të gjithë bashkitë e Qarkut Berati, ashtu si ka sjellë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Dhe këto janë që duhet të shënohen dhe këto janë pjesë e shembujve të cilët duhet të merren edhe në reformën e ardhshme territoriale, që pikërisht funksione të caktuara të cilat bashkitë aktualisht mund të kenë vështirësi për t'i kryer në kushtet aktuale dhe të financave që kanë, mund të jetë një shembull shumë i mirë dhe të institucionalizohen në reformat e tjera për t'u bërë rajonale dhe për të mundur t'u ofruar sa më shumë shërbim qytetarëve, jo vetëm për ujësjellësit, por ju e përmendët edhe këtu për shërbimin e emergjencave civile dhe për shërbime të tjera si ai i menaxhimit të mbetjeve e të gjitha me radhë. Shumë faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Zonja Melma.

Juliana Memaj:

Në lidhje me sa parashtroi deputeti i ajë, pasi ka qenë edhe drejtori i përgjithshëm i ujësjellës-kanalizimeve, ajo që parashtrova unë kishte të bënte me shërbimin ndaj qytetarit. Pastaj për shifrat që mund të jenë performanca më e mirë për shkak se përgjigjja ndaj qytetarit nuk është ajo e duhura, po mendohet më shumë për efikasitetin ekonomike të ujësjellësit, kjo është gjithçka tjetër. Unë flas për bashkinë Dimal, investime për ujësjellës-kanalizime janë bërë më shumë para se të bëhej bashkëpunimi ndërbashkiak. Gjithashtu, edhe reagimi ndaj qytetarit për problematikat ka qenë më i shpeshtë. Ne në atë kohë, para organizimit ndërbashkiak nga 10 fshatra që gjetëm me furnizim me ujë, falë investimeve po që erdhën nga qeveria, kjo nuk mohohet, shkuan në 21 fshatra. 7 fshatra furnizim 24 orë me ujë dhe qyteti 24 orë me reformën u kufizua furnizimi me ujë në këto për shkak të ruajtjes së efikasitetit të organizimit ndërbashkiak. Ne jemi këtu për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarit, jo për shifrat ekonomike të një ndërmarrjeje të caktuar. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ka ndonjë koment? Po, zoti Zotkaj.

Adriatik Zotkaj:

Po, edhe një gjë, duke falënderuar pleqësinë, sepse falë tij ta vazhdoj. Falë tij ne kemi ujë 24 orë sot në qytet, që ishte një ëndërr për qytetin e Poliçanit. Po, ka një gjë, transferimi i ujësjellësave. Sot qeveria qendrore ka marrë vetëm magjistarin kryesor. Fshatrat na i kalon prapë bashkisë. Pra, ujësjellësin e qytetit e menaxhon qeveria, fshatrat të gjithë përsëri janë në kurriz të bashkisë. Kjo do të thotë.

Luçiano Boçi:

Zoti Zotkaj, faleminderit. Do më falësh një minutë se tani këtu po prishen të gjitha rregullat, jo prej jush, prej drejtimit të komisionit. Ne kërkuam pushimin tonë për të marrë një vendim dhe qartazi duket që edhe kjo nuk është konsideruar. Dhe keni vazhduar pa opozitën. Cili është mesazhi juaj që ju nga fitorja në fitore? Se s'po e kuptoj këtë gjë. Domethënë, ju vazhdoni se ju doni, jeni ata që impononi. Këtu komisioni është me paritet dhe duhet të zbatohet rregullat e këtij pariteti. Nuk mund të dalë këtu të prevalojë dikush se unë jam maxhoranca në raport me opozitën, sepse bëhet fjalë për një reformë që është kërkuar nga ju, është pranuar pariteti me bashkëpunimin e ndërkombëtarëve dhe prania jonë, dhe ky komision funksionon mbi bazën e rregullave, jo mbi bazën e dëshirave. Dhe rregullat qartazi e tregojnë që dëgjimet bëhen me prezencën e opozitës dhe sigurisht zbatohen dhe pjesë të tjera të rregullores së funksionimit të komisioneve në Kuvend. Kur kërkohet pushim, fjala është pushim, nuk është punë, se unë nuk e di, ju ngatëroni dhe konceptet. E di shumë mirë atë presionin politik që merrni, që zbatoni si urdhër mbas në qëndrimet

tuaja, por mos mendoni që ky presion që merrni ju do transmetohet dhe tek pjesa jonë. Së pari, për të gjitha këto qëndrime që janë mbajtur deri më tani, do t'i ndërpres kryetarët e bashkive, sigurisht si drejtues i komisionit, sepse absurdi kap absurdin në këtë komision dhe për qëndrim të ntejshtë nga mënyra si po vepron ju, dua që të flasim edhe kolegët e mi. Kjo situatë që ju po ndërtoni është e qëllimshme, nuk është e rastit, se në logjikën më të thjeshtë duhet të kishit pritur ardhjen tonë dhe të vazhdonin me dëgjimet përderisa mbledhja u ndërpre me kërkesën tonë për pushim. Se ku do të dilni, unë e kuptoj shumë mirë, ju kërkoni që të përjashtoni opozitën nga ky proces, nga procesi i reformës. Qartazi i keni synimet tuaja për të ulur numrin e bashkive dhe provokoni në çdo rast qëndrimin tonë me qëllim që mos hidhen opsionet që kërkojnë qytetarët, i kërkojnë dhe kryetarët e bashkive që ose të qëndrojnë, ose në rastin më të keq politikisht për ata të shtohet numri i bashkive në territoret e bashkive aktuale. Dhe unë dua dhe kërkoj që kjo mënyrë sjelljeje nga ana juaj të ndërpritet. Prosesi që kemi përpara nuk është i lehtë, sigurisht këtu nuk jemi në këmishën e forcës së kohës, jemi dy orë apo jemi tre orë. E ka përkufizuar në një debat shumë të qartë zoti Carat kur tha: "Unë për qytetin tim nuk lodhem së foluri" dhe deputetët e Qarkut Beratit nuk lodhen së foluri. Deputetët nuk ia kufizon njeri as kohën, s'ia kushtëzon njeri as fjalën, as mendimin dhe as pyetjet që ai do drejtojë. Dy fjalë për ju, zoti Maznigu. Me gjestet tuaja, se njeriu nuk flet vetëm me fjalë, fjalët mund t'i ketë shumë të bukura. Po dëshmoni që doni të sabotoni punën e këtij komisioni duke ndërtuar një lloj marrëdhënie jo korrekte dhe nuk zbatoni SPAK-un dhe atë etikën elementare. Unë di ta shkel shumë mirë etikën, por nuk besoj që kjo vlen për punën dhe interesin e qytetarit. Dhe në qoftë se ju vazhdoni në këtë lloj forme, patjetër që përgjigja është shumë e shpejtë, meqenëse doni dhe përgjigje. Por mendoj që e keni të gabuar këtë lloj forme imponimi këtu. Në qoftë se është paritet, të drejtën e kanë fjalës edhe deputetët e opozitës dhe deputetët e maxhorancës. Secili zgjedh kohën e vetë, mënyrën e vetë, formën e vetë të folurit dhe nuk ndërhyhet fare dhe nuk kushtëzohet, sepse vazhdimisht ka ndodhur kjo edhe në seancat e tjera dëgjimore kur në cilësinë tuaj si bashkëkryetar keni ndërhyrë, keni kushtëzuar përmbajtjen, jo pse është parashtrim, jo pse është pyetje dhe kjo nuk është fare korrekte parlamentare nga ana juaj. Shumë mirë keni qenë atje në kabinet, në kabinet në rresht janë të gjithë, në parlament nuk janë në rresht. Secili ka autoritetin e vet, secili ka të drejtën e vet, sepse është i votuar dhe do mbrojë interesat e atyre qytetarëve që e kanë votuar. Që të kenë emocione deputetët me njëri-tjetrin për mendimet e tyre, e kuptoj shumë mirë dhe të përplasen. Po të ndërhyjë bashkëkryetari për t'i ndërprerë fjalën deputetëve, do aq më tepër në bashkëdrejtim, kjo është krejtësisht alogjike. Të paktën nga përvoja ime, nuk ka ndodhur dhe çuditërisht për shkak dhe të presionit vjen edhe ky lloj reagimi. Kjo mënyra pastaj se si vazhdoni ju pa prezencën tonë, kjo nuk e di, kjo është domethënë shumë absurde dhe e papranueshme. Gjithsesi, për këtë vlerësim të situatës ia kaloj fjalën kolegëve të mi. Pse do fjalën? Po prit njëherë, prit njëherë, prit njëherë, stop njëherë, mos e merr, prit ta mbarojë njëherë, prit njëherë se mos e tepro, mos e tepro, mos e tepro, çfarë bëje tjetër, mos e tepro. Po jo, unë e ngre zërin, e ngre zërin shumë, e ngre, e ngre zërin, ngre zërin edhe ngre edhe gjëra të tjera, po edhe njëherë tjetër, e ngre dhe mos e përsërit më, mos e përsërit edhe mos e kap ashtu, mos e përsërit. E fjalën, fjalën po ja kaloj, fjalën, jo fjalën po ja kaloj unë kolegëve të mi, do ta marrin, do ta marrin

kolegët e mi. Shkeljen e keni bërë ju, shkeljen e keni bërë ju dhe fjalën do ta marrin, fjalën do ta marrin kolegët e mi. Kush do, kush do e marrë fjalën? Po, zoti Ismaili.

Zija Ismaili:

Faleminderit, faleminderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar kryetar, të nderuar kryetar.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Rif. Atëherë, atëherë një sekondë se u tha fjala. Tani foli zoti Boçi dhe tha disa gjëra. T'i japim një përgjigje zoti Boçi. Së pari.

Luçiano Boçi:

Çfarë përgjigje do më japësh ti mua? Do të jap përgjigje këtij mandati. Përgjigje do më japësh ti mua, ti përgjigjen, ti po vazhdon seancën. Çfarë përgjigje do më japësh ti mua? Ti po vazhdon në mënyrë të padrejtë kundër rregullores dhe kundër etikës seancën dëgjimore kur ne kërkuam pushim dhe ju e aprovuat dhe ne dolëm. Çfarë përgjigje do më japësh ti mua? S'ke përgjigje. Përgjigjen ta japin ty deputetët e opozitës, sepse ke ofenduar bashkë me mua dhe këta të gjithë dhe gjithë opozitën dhe në këtë rast është e drejta e tyre të thonë fjalën e tyre, sepse ju e keni treguar me akt. Thashë, nuk flasim vetëm fjalët, flasim dhe aktet dhe në këtë rast akti juaj është ky i padrejtë dhe opinioni duhet të kalojë te matanë, se po prishje ekuilibrat e një komisioni shumë të rëndësishëm që ka pritshmëri shumë të mëdha, që është ndjekur nga qindra mijëra vetë dhe sot ju keni dalë në një situatë tjetër, sepse ndjeni presionin që vjen nga dëgjimet, vjen nga publiku, vjen edhe nga përfaqësuesit tuaj në një formë apo në një tjetër. Nuk është kjo rruga për të arritur qëllimet. Keni bindur që e keni gabim. Të vazhdojnë deputetët e opozitës, jo më, të vazhdojnë deputetët e opozitës. Ti s'mund të flasësh, sepse unë fjalën ja kam kaluar, ja kam kaluar deputetit, e kam të drejtën si bashkëkryetar. Po jo, po jo, se po të kishe këtë parim ti, po të kishe, po të kishe ndjekur këtë parim ti, do më kishe lënë mua të flisja. Jo, jo, jo, erdhe, ike, kur deshe, ike, kur deshe, fole, sepse do të marr leje ty unë. Po, pra, pse unë s'kam marrë të marr leje ty? Sepse e ndërpreve fjalën, ja, pra, e ndërpreve ti fjalën e parë dhe tani nuk do e marrësh fare, s'ke për ta marrë, do ta marrë zoti Ismail. Pse ajo quhet "dike këtë" apo e dike vetëm për veten tënde? Po, për të tjerët nuk e dike ti këtë, sepse unë e kisha fjalën dhe e ndërpreve ti. Zoti Ismail, të lutem, vazhdo, vazhdo, sepse nuk mund të ashtu, nuk mund të vazhdohet në këtë lloj.

Arbjan Mazniku:

Po kalamat dy vjeç?

Luçiano Boçi:

Po patjetër, tani merre dhe atë, ta gëzosh edhe këtë një vjeç. Tani, opozitës në këtë komision i janë dhënë në mënyrë sistematike. Janë dhënë gjërat që i takojnë në paritet, na i keni dhënë ju, na i jep jeta parlamentare, s'janë dhurata këto, nuk janë dhurata këto

dhe mos mendoni që janë dhurata. Së pari, i është dhënë pariteti, po thuaj çfarë duash, po merrni më dhe paritetin, në qoftë se e doni, merreni më, se është dhënë e mirë kjo për dëgjimet, është dhënë e mirë dhe mënyra se si ju na jepni ne dakort, mënyra se si e jep jeta parlamentare më e kushtozon, më e kushtozon. E kushtozon, po edhe zhurma, merr me ato që s'kanë as sjellje as etikë, ka vlerë zhurma, ka shumë vlerë, prandaj se jam profesor dhe e di vlerën e kësaj. Por nuk ka mbaruar, sepse fjalën ja kam kaluar zoti Ismail. Atëherë ti duhet ta lësh deputetin që shprehet, shprehet si deputet i zonës dhe nuk mund të vazhdojë ky komision duke insistuar ti dhe ta marrësh fjalën si do ti, sa herë do ti dhe si e do ti. Të flasë dhe ai deputet, sepse është i zonës, ta mbyllim me këto dhe vazhdojmë me Fierin dhe në një situatë tjetër, pasi të qetësoheni edhe gjyqësore, sepse ajo që krijuat si precedent nuk mund të zgjidhet. Të flasë zoti Ismaili dhe pastaj do vazhdojmë edhe me Fierin. Jo, jo, po duhet të vazhdojë deputeti dhe njëherë, unë ja kam dhënë fjalën, unë ja kam dhënë fjalën si bashkëkryetar një deputeti dhe njëherë ke kohë t'i kthesh përgjigjet sikurse ka kohën e vet në dispozicion deputeti i Beratit për të bërë pyetjet e veta, po sepse unë në cilësinë time ja kam kaluar fjalën atij dhe ai do e vazhdojë 5 minuta, ai do bëjë pyetjet, ai do bëjë pyetjet e veta dhe parashtrimet e veta, se ka 3 orë që po pret, ka 3 orë që po pret aty, ka 3 orë që po pret aty, sigurisht mund të flasim, po në qoftë se e do edhe një i maxhorancës, po më ja kalojmë dhe të maxhorancës, patjetër ja kalojmë, patjetër me shumë kënaqësi, nuk bëhet fjalë fare. Flasi zoti Ismaili, flisni ju dhe të flasë një deputet i maxhorancës. Zoti Boçi dhe nderuar anëtarë të. Atëherë zoti Ismaili, po merre, merre fjalën, sepse merre fjalën, se fjala është për ju, e keni marrë, e keni marrë. Zoti Boçi dhe anëtarët e maxhorancës, së pari, po ju them në mënyrë sistematike, sot keni bërë një abuzim sistematik me parlamentarizmin dhe me të drejtën. Po jo, mo, jo, se s'është bërë, s'është bërë asnjë lloj abuzimi, sepse abuzimin e keni bërë ju. Parimi i parë kemi thënë do të flasë kryetarët e bashkisë për të folur, së dyti abuzimin e keni bërë ju. Po le ta shihni, jo, kaloje, kaloje atij fjalën dhe kaloje deputetit fjalën, po mos e vendos ti, mos e vendos ti, mos e vendos ti, do e vazhdojë ai. Pa mbaruar unë fjalën time, po mbyllëm më mbledhjen, mbyllëm sa të duash, edhe jep tjetër, mbylle nga ana jote ti, meqenëse do ta mbyllësh mbledhjen, mbylle, po deshe mbyllëm mbledhjen nga ana jote. Deputeti ka fjalën, apo unë i kam dhënë fjalën deputetit, si mund t'ia heqësh ti të drejtën e fjalës, do të thotë që po drejtojmë komision. Qënia ime në pozitën që kam, po ti merr fjalën tënde më, merr fjalën tënde, e ndërpreva kryetarin, jo ty, kryetari i kërkova ndjesë, i thashë stop, sepse unë po drejtoj dhe unë po ja kaloj fjalën, sepse ju s'duhet të kishit vazhduar. Ndërprerja ka ardhur si rezultat i shkeljes rregullore dhe etikës nga ana juaj, nuk ka ardhur se desha unë, sepse ne u larguam për të marrë një vendim dhe ju s'duhet të kishit vazhduar, është çështja më e thjeshtë që ekziston në përvojën parlamentare, në jetën parlamentare. Erdhëm në këtë moment, e ndërpreva, ja kaluam fjalën që të shkojmë në normalitet, bëj pyetjet dhe gjithçka është në normalitet dhe kjo. Po s'ka, po se vendos ti normalitetin dhe anormalitetin, sepse jo, ka një gjë, ti jo, e jo, pse unë jam në opozitë, unë jo, e jo, unë e vendos mbas forcës që më jep pozicioni im. Tani ti vendos anormalitetin, ti vendos dhe normalitetin, anormalitetin e krijoje ti dhe unë po kërkoj normalitetin, unë po kërkoj normalitetin, këtë rast dhe e keni krijuar ju duke shkelur rendin, duke shkelur radhën. Deputeti duhet të marrë domosdoshmërisht fjalën, duhet të marrë domosdoshmërisht fjalën, duhet ta marrë patjetër çdo deputet duke mos e zgjasur

domosdoshmërisht fjalën. Së pari, jo më s'ke pse i thua ti, po të them që të shkojmë me të, o Luçano. Po e ku vjen momenti, sepse ja kam kaluar fjalën deputetit, ja kam kaluar fjalën deputetit dhe duhet ta marrë ai fjalën, duhet. Po për Gazi Bodhës je bërë ti, domethënë se ti po dëshmon këtë pjesën e mungesës së seriozitetit, sepse vijove komisionin, kërkon të marrësh me zor fjalën, ja ta marrë ai si deputet dhe duhet të vazhdojë si deputet, po jo, unë sekretar tani, jo, jo kishit mbaruar, s'duhet të kishit vazhduar dhe ti si sekretar s'duhet ta kishe pranuar, po s'duhet ta kishe pranuar si sekretar më, po mirë atëherë do vishim, kishim një vendim për të marrë, pse për procedurë, po kaloje fjalën për procedurë. Jo, jo, s'ka për procedurë, kaloje, apo e kaloje, merre për procedurë, pse s'e merre për procedurë?

Arbjan Mazniku:

Për procedurë e kërkoj ju fjalën, për procedurë e kërkon bashkëkryetari, do marrë fjalën për procedurë.

Luçiano Boçi:

Po kërkon fjalën për procedurë, po unë s'jam si puna jote, merre për procedurë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ah, shkëlqyeshëm. Tani, për procedurë, sot kemi bërë një dëgjim në të cilin pas pyetjet e para i bëri zoti Bozdo dhe pas zotit Bozdo u morën përgjigjet, pyetjet e dyta i mori zoti Mziu. Jo, jo, po një sekondë, ore, të lutem, se unë kam memorien e mirë. Një sekondë, një sekondë, një sekondë, një sekondë, të lutem, të lutem, se foli zoti Mziu. Pasi foli zoti Mziu, që u bënë dy nga ana e opozitës, me kohë të gjatë të gjitha pyetjet, duke i marrë në mënyrë sistematike kohë kryetarëve, foli zoti Klosi. Pas kësaj, në mënyrë krejt normale, duke qenë se kishin folur dy nga anëtarët e maxhorancës, pavarësisht zoti Klosi nuk bëri pyetje që të merrte përgjigje, bëri një koment, e rimori fjalën zoti Boçi dhe filloi të bëjë pyetje. Tani, nuk mundet që hapësirën e lënë në mënyrë të tejmasë të maksimale nga ana e maxhorancës, që deputetët e opozitës të flasin, të thonë, të bëjnë gjithë gjërat që duhet këtu dhe në çdo dëgjim tjetër, të abuzohet në mënyrë sistematike në kurriz të dy elementëve të parlamentarizmit. Një, kryetarëve që kemi thirrë këtu, ju jam lutur në mënyrë sistematike në çdo takim, të mos i marrim kohë kryetarëve, t'i bëjmë pyetjet, t'i japim kohë kryetarëve të flasin, sepse po e kthejmë këtë në një teatër ku flasin deputetët që kanë gjithë kohën për të folur, në kurriz të kohës kryetarët sot kanë ndenjtur të gjithë bashkë, u bënë 3 orë që rrinë këtu, në pattë fol një kryetar më shumë se 4 minuta, 5 minuta secili prej tyre, ndërkohë që thirren në komision parlamentar për të pasur mundësi për të folur ata, jo për të pasur mundësi që të flasin në mënyrë sistematike deputetë nga 20 apo nga 30 minuta. Dhe pikërisht për këtë çështje dhe për çështjen e paritetit të kohës dhe për çështjen e paritetit mes palëve, i kërkova zotit Boçi që nuk bënte sens që kur kanë folur dy njerëz nga opozita, të flasin prapë një i tretë nga opozita. Unë e vërteta me këtë çështje dhe iku, pasi u kthye, u vendos të marrin 5 minuta pushim. 5 minuta pushimi do të thotë 5 minuta pushim. Mund të jenë dhe 10 minuta, mund të jenë dhe 10 minuta, mund të jenë dhe 20 minuta, pritëm 30 minuta. I kërkova sekretarit të komisionit, sekretarit teknik

të komisionit, thashë: "Shko flit me opozitën, do vijë?" Jo, nuk më tha, nuk më tha, në momentin e parë më tha: "Kërkojnë që nuk na kanë thënë që do vijë." Më thanë kur do vijë, pasi ne kishim vazhduar takimin. Në atë moment, për respekt të kryetarëve të bashkive që kanë ardhur, për respekt dhe të kryetarëve të bashkive që janë përjashtuar, që u presin prej një ore e gjysmë, detyra jonë është të dëgjojmë kryetarët e bashkive. Opozita është këtu, është e mirëpritur të vijë, është e mirëpritur të flasi, është e mirëpritur të bëjë pyetjet, por nga ana tjetër këtë gjënë nuk mund ta kthejmë, jo pra, jo, jo, por ore, ore, me zgjedhje është, me zgjedhje është kjo punë, është me zgjedhje, çdo deputet ka deputetë që duan me ardhë, ka deputetë që s'duan të vijë, pra çështja është, kjo është me zgjedhje. Shkon, por ama nuk mundet, nuk mundet që, nuk mundet të kthehet fakti që ne kemi kërkuar dhe i kemi dhënë mundësi opozitës të jetë këtu, të ketë bashkëkryesinë, të kthehet ky në mekanizëm, as për t'u zhyrtuar, nuk ia ka dhënë ligji, thashë: "I të lutem, nuk ia ka dhënë ligjit, sepse magjie kujt e cili ligj i thuhet ky?" Po ma thuaj cili ligj, ma citove ti, po ti the e thotë ligji, sa thashë unë, ti thuaj cili ligj, cili, cili, më thuaj nenin dhe kodin, më thuaj ti, njohësi i mirë i ligjit, më thuaj cili ligj dhe cili nen. Ta them unë e cilin nen. Dëgjimet, dëgjimet, dëgjimet parlamentare nuk kanë nevojë për forum, sepse nuk ka vendim. Dëgjimet, jo, jo, ore, jo, jo, nuk u mora unë me opozitën, maxhorancën, nuk merret, rregulloreja e Kuvendit nuk flet për opozitën, maxhorancën, flet për forum ose jo forum. Dëgjimet, kur nuk ka vendimmarrje, nuk ka nevojë për forum. Kjo është, pra, po the pa opozitën, po s'po the, ore, ore, një sekondë, Kushtetuta, zoti Cara, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë thotë një gjë, thotë: "Deputeti pasi zgjidhet është deputet i Republikës së Shqipërisë, nuk është i maxhorancës dhe i opozitës, është i Republikës së Shqipërisë. Çdo deputet është i barabartë dhe është deputet që përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe çdo qytetar." Pra, këtu jemi të gjithë, përfaqësojmë qytetarët, jo opozitën dhe maxhorancën, kur jemi zgjedhur për të marrë pjesë në këtë komision, marrim pjesë në këtë komision, në qoftë se dikush s'vjen dot, s'vjen dot, mund të jetë një, mund të jetë dy, mund të jetë tre, mund të jenë pesë, nëse ka vendimmarrje për të marrë, pa dyshim që ka nevojë për forum. Nëse s'ka vendimmarrje për të marrë, ne do të vazhdojmë dëgjimin dhe në respekt të faktit që kanë lënë detyrën kryetarët, kanë lënë detyrën sot dhe kanë ardhur këtu nga 3 orë, kanë një orë e gjysmë që presin jashtë kryetarët e Bashkisë së Qarkut Fier, që presin të dëgjojnë, ndërkohë që këtu ne debatojmë për dy elementë që janë elementë minorë komunikimi dhe elementët minorë komunikimi i kam kërkuar që ditën e parë, i kam thënë: "Të kufizojmë në kohë të arsyeshme, 3 minuta, 5 minuta, s'ka rëndësi sa doni juve kohën e pyetjes dhe t'i themi që ne duhet të themi 30% të kohës ta marrin deputetët, 70% të kohës ta marrin ata që kemi thirrur për të dëgjuar." Ne kemi përfunduar në mënyrë sistematike që 70% të kohës e harxhojmë ne dhe as 30% të kohës nuk ia lëmë kryetarëve. Tani, nëse ka dikush që më thotë që kjo kërkesë nga ana ime, që kur ne bëjmë një dëgjim, ta ndajmë kohën 30 deputetët, 70 palë të dëgjuara, thotë që kjo është gabim, thotë që e keni gabim, se nuk do të flasim ne 70, po unë kërkesa që kam është kaq e thjeshtë, them: "Kemi lënë dy orë kohë gjithsej, në këto dy orë janë 120 minuta, 40 minuta të bëjmë pyetjet, pjesa tjetër të jetë pothuajse e përgjigjeve dhe thjesht kaq, në momentin që ne bëjmë pyetje 25-minutëshe, nuk ka më, secili bën 25-25, nuk do të lëmë kohë për kryetarët, kaq ka qenë kërkesa ime dhe kjo ka qenë një gjë e miratuar dhe e dakordësuar mes palëve dhe tentativa këtu për të keqpërdorur dakordësinë

e maxhorancës për t'i dhënë hapësira. Përtej dhe logjikës, nuk thashë unë asnjë, pra, foli zoti Bozdo, e mori fjalën zoti Mziu, nuk bëri asnjë fjalë, s'ka problem, folën dy nga një krah, nuk ka problem. Do e ekuilibrojmë duke folur dy njerëz nga ana tjetër, jo, tani kjo gjë nuk mund të ndodhi, kaq dhe ta vazhdojmë, jam shkretë, nuk takon dhe i takon një anëtar të maxhorancës dhe pyetjet pastaj zotëria në fjalë, sepse janë bërë pyetje nga dy anë, nga opozita dhe vetëm një nga maxhoranca. Si? Jo, komunikimi im ishte, thashë, nëse ka dikush pyetje të mbetura, se kishin mbetur pyetje nga zoti Mziu dhe i thashë: "Kush ka pyetje nga zoti Mziu për të vazhduar përgjigjet?" Përgjigjet, po, të lutem.

Ramadan Likaj:

Faleminderit. Në qoftë se ne, zoti kryetar, do të vazhdojmë, siç e thatë edhe ju, ne jemi këtu tash 3 orë, sigurisht që e drejta e çdo deputeti është për të bërë pyetje. Unë mendoj që, në qoftë se ne vazhdojmë pafund të diskutojmë, të replikojmë, absolutisht ata do të vazhdojnë me orë këtu të rrinë dhe unë mendoj që treqarqja është e pamujtur që ne të vazhdojmë të bëjmë pyetjet tona, sigurisht që edhe kryetarët të kthejnë përgjigje. Unë mendoj që të vazhdojmë pyetjet, në qoftë se edhe ata janë të gatshëm të kthejnë përgjigje. Sigurisht që dy orë janë të pamundshme për të marrë ato çarralisht që qytetarët presin. Pyetja ime drejtpërdrejt për ju është që, në qoftë se të sot në qarkun e Beratit, jo, mora fjalën se jam anëtar i komisionit. Thashë unë po bëj pyetje. Janë po, përqind.

Arbjan Mazniku:

Normalitet, pra, po, normaliteti njëson, normalitet patjetër dhe jam shumë dakord me normalitetin. Tani, jua thashë paraprakisht për sa kohë që kanë bërë pyetje me të drejtë dy anëtarë të opozitës, le t'i japim drejtën një anëtar të maxhorancës, një pyetje, dy pyetje, pastaj kthehemi prapë, nuk ka problem. Po ju më e kërkove për procedurë, e kërkove për, po, mbaroi, dakord, po ma kërkove për procedurë, po vazhdo, s'ka problem. Po, se secili ka. Zoti Zotka e do përgjigjen e vetë zoti Mziu përpara se të marrë fjalën zoti Face.

Adriatik Zotkaj:

Mbase kaloi kohë e gjatë tani dhe ne i harruam dhe pyetjet, por pak a shumë zoti Mziu ishte tek 7 funksionet që na ishin transferuar ne, që nga ujësjellësat, që nga zjarrfikëset, pyjet, arsimit parashkollor, etj. Të gjitha këto kompetenca që ne na janë transferuar, na janë transferuar pa fonde dhe pa fonde nuk kanë vlerë. Ky është mendimi im, të gjitha kompetencat që transferohen pa shoqëruar me fondet janë pa vlerë. Pyetje tjetër, sepse mbaj mend pyetjen tjetër pastaj zoti Mziu për. Absolutisht jo, të paktën Bashkia e Policanit e ka një eksperiencë të hidhur 34-vjeçare që në 34 vjet, në 34 vjet nuk është vendosur një gur në Polican dhe kjo do të largonte shërbimet, do të kishte shpopullim, shpopullim total dhe unë nuk jam dakord me atë që ka thënë zoti Mazniku në çdo takim që bashkitë nuk kanë kapacitete njerëzore për të krijuar dhe për të bërë projekte. Unë po ju them sot me faktin me prova, shikoni te ministria juaj, keni 62 projekte që presin atje të financohen dhe nuk besoj që ka kryetar bashkie sot në Shqipëri që s'ka projekte, se ai kryetar bashkie që s'ka projekte nuk është kryetar bashkie. E dyta, dhe nëse, dhe nëse nuk kanë kapacitete juristë, po themi arkitekt, urbanist, etj., etj., sot është fare e lehtë i drejtohesh një studie

projektimi, i jep lekët, bën 100 projekte sa të duash dhe kjo nuk është arsye për t'u shkrire bashkia dhe Bashkia e Policanit, unë siç e thashë edhe në fillim, i kërkoj dhe komisionit të thellohet, të thellohet dhe të shikojë dhe financat e Bashkisë së Policanit që nuk është bashki me risk financiar, ofron të gjitha shërbimet dhe përtej atyre që takon dhe shërbimet sociale, se njerëzit janë në fokus kryesor, njerëzit janë njerëz që mbijetojnë, mezi mbijetojnë, u priten dritat, u priten ujit, i lënë pa bukë në shtëpi dhe aty duhet të jetë bashkia e para, në qoftë se shteti nuk është për këtë kategori njerëzish, për çfarë janë bashkitë? Për çfarë janë bashkitë në qoftë se nuk mbajnë dot jetën gjallë të atyre qytetarëve? Unë e kam thënë në çdo takim që më është dhënë e mundur, edhe sot po them, jam kundër shkrires së bashkisë, i bie shpopullim dhe nga viti 2015 deri sot ato statistikat nuk janë të qarta, nuk janë të qarta, vetëm nga Bashkia e Policanit nga 2015 deri sot kanë ikur mbi 5000 banorë. Ato duhet t'i shikoni pastaj si bëhen statistikat, është tjetër gjë dhe nesër nuk, në qoftë se kemi shkrire fshatrat, do shkrijmë qytetet, nuk do ekzistojnë më qytete.

Kreshnik Hajdari:

Mirë, mund të vazhdoj.

Arbjan Mazniku:

Po, të lutem.

Kreshnik Hajdari:

Atëherë në vijim edhe të kolegëve për pyetjeve që deputeti Mziu parashtroi më herët, një pjesë edhe ato që ishin si më të përgjithshme edhe u thanë edhe nga parafolësit, nga kolegët e mi dhe nuk e gjykoj të udhës që të vazhdoj të përsërisim të njëjtat gjëra. Në raport me grantet apo me transfertat që na sjell qeveria, nuk e mbaj mend si e parashtroi deputeti, por e vërteta është që grantet kanë ardhur në rritje. Ndoshta në përqindje të GDP-së mund të jetë e njëjta vlerë, por në vlerë nominale është shumë më e madhe sesa grantet që transferoheshin në vitin 2015. Dhe për sa i përket edhe financave që ka vetë bashkia nga të ardhurat e veta dhe unë besoj se kjo është një nga më të mirat kryesore që ka prodhuar reforma e 2015-s. Nuk mbarova, por nuk po dëgjon. Po kam ardhur përsëri të pyetjet. Është një nga, unë besoj se një nga të mirat që ka sjellë reforma e vitit 2015 është pikërisht konsolidimi i financave vendore dhe Bashkia e Kuçovës, unë besoj se është një nga shembujt pozitivë. Si shumë bashki të tjera ndoshta, jo vetëm Bashkia e Kuçovës, që sot që flasim ose në mbyllje të vitit 2025, detyrimin ose borxhin e ka vetëm 0.4%. Dhe kjo besoj unë është një, është një event shumë pozitiv që tregon që bashkitë në këtë formë siç janë performojnë goxha mirë nga ana financiare. Nuk besoj se i kemi lënë vend pa prekur të gjitha shërbimet që na takon me ligj, por e vërteta është që në çdo moment që mund të na pyesësh ne, mua personalisht, kolegët e qarkut apo të gjithë kolegët e tjerë të 61 bashkive, natyrisht që kërkojmë mbështetje më të madhe financiare. Mund të diskutojmë edhe për format dhe mënyrat se si mund të vijë ajo mbështetje. Por janë disa nga funksionet bazë që edhe na janë transferuar me kalimin e viteve, jo thjesht ato që janë kaluar në vitin 2015, që kërkojnë një vëmendje nga qeveria qendrore më të

lartë. Këtë e gjykova të kthej përgjigje, sepse pjesa tjetër më duket sikur edhe kolegët kthyen përgjigje dhe nuk ka nevojë të.

Ermal Pacaj:

Atëherë, faleminderit kryetar, unë në fakt nuk kam asnjë koment e asnjë pyetje, e mora vetëm për të djegur rrallën që mos ta kthej në normalitet se kanë 5 orë kryetarë që janë këtu dhe kanë 2 orë të tjerë që po presin atje edhe nuk është normale, kështu që unë e zaurova pjesën time, faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, a ka kërkesë tjetër për? Po, po, po zoti Isfandi, fjalë e përsëritur.

Zija Ismaili:

Faleminderit zotëri bashkëkryetar të këtij komisioni, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar kryetarë të bashkive të qarkut të Beratit. Duke ju falënderuar për pjesën e gjysmë transparencës së asaj çfarë ju përgjigjet pyetjeve të kolegëve tanë të opozitës. Nga dëgjesa që arrita të kuptoj në analizën që u bë të sukseseve imagjinare të reformës vrasëtare. Të vitit 2014, reformës territoriale, e cila do ta them vrasëtare pasi indikatorët në të cilët ne i prekim terren dhe i analizojmë janë në atë lloj natyre që i kanë detyruar njerëzit të braktisin veptarin e tyre dhe të largohen pafund. Nëse do marrim një nga indikatorët shëndetësor, dua t'ju them se në një nga ish-komunat e Beratit, që sot është e bashkisë, kemi një mjekë drejtoreshë qendre shëndetësore, është kryetare e Partisë Socialiste, është anëtare e këshillit bashkiak, është në specializim pasuniversitar, është anëtare e kempit në një bashki tjetër të qarkut të Beratit dhe në fund është patronazhiste. Unë nuk e di se çfarë sistemi shëndetësor dhe çfarë shëndetësie dhe çfarë shërbimi do marrin banorët e kësaj ish-komune. Unë nuk pashë ndonjë indikator, të vetmi indikator që kam e di që një i sëmurë nga zona më e thellë e Skaparit do transportohet me ambulancë për të ardhur në spitalin bashkiak të Skaparit, do vijë me një ambulancë tjetër për të ardhur në Spitalin Rajonal të Beratit dhe pastaj do drejtohet drejt spitaleve qendrore ose qendrës paruniversitare Nënë Tereza ose qendrës kombëtare të traumës. Dhe sot treguesi i vetëm, indikator i vetëm i matshëm për pjesën e shëndetësisë që kemi ne në qarkun e Beratit, Spitali Rajonal i Beratit, nis drejt qendrës kombëtare të traumës ose qendrës paruniversitare Nënë Tereza minimalisht 16 ambulanca në ditë. A mund ta imagjinojnë qytetarët e Beratit nëse do marrim në analizë shëndetësinë minimalisht para 30 viteve, çfarë ka pasur shëndetësia dhe ku e kemi katandisur? Kjo është ajo që ka. Duket Spitali Rajonal i Beratit sikur është dyqan, vijnë mjekët nga Tirana për specialitetet që kanë në orën 11:00, mbyllen të gjitha shërbimet dhe mjekësia bëhet on-call. Nëse ka ndonjë mjekësi që zhvillohet në ndonjë vend të shteteve të besë për të cilat ne aderojmë se mund të bëhet on-call siç bëhet në Spitalin Rajonal të Beratit, por edhe në shumë spitale të tjera, atëherë unë jam dakord që të them po, kjo reformë e ka pasur këtë sukses. Nëse do kthehem te arsimit, e vërtetë është ajo zoti kryetar që janë mbyllur shumë shkolla, por që t'i jepet mësim fëmijëve klasë të parë deri në klasë të nëntëmbëdhjetëvjeçarë vetëm me një arsim të ardhshëm, se janë 5 fëmijë, kjo nuk besoj se zhvillohet në vendet e Europës

dhe atje ku ne duam të terminojmë. Dhe të jemi të bindur që në qarkun e Beratit kemi shkolla ku arsimi zhvillohet nga klasa e parë deri në nëntë nga një pedagog, nga një profesor, dhe ai është për t'u falënderuar se pjesa tjetër ka ikur. Pastaj, nëse do t'i futemi kriterëve të shpopullimit e të shikojmë se si është gjendja faktike në dhjetëra e dhjetëra fshatra të qarkut të Beratit, unë nuk dua të flas më shumë se vetë banorët e këtyre zonave tregojnë vetë. A e dini juve, zoti kryetar i bashkisë së Skaparit, që ke 10 infermierë të cilët të rinj në Tiranë dhe në Durrës dhe aktualisht marrin rrogën sot në shërbimin shëndetësor të kësaj? Nëse doni ja vëja pemërat, janë nxjerrë këtu, tashit ja vëja. Dhe kjo është e vërtetë dhe ju pretendoni se reforma territoriale ka siguruar dhe iu ka dhënë shërbim shëndetësor atyre njerëzve. Meqënëse të gjithë këto indikatorë unë nuk e mora përgjigjen nga dëgjesa tuaj, kam disa pyetje normalisht në lidhje me këtë dëgjese që është. Po të filloj me kryetarin e bashkisë së Beratit. Kryetari i bashkisë së Beratit në dëgjuesen e vetë e dëgjova me shumë vëmendje, tha ishte shumë dakord për reformë territoriale. Kam një pyetje, nëse ka dëgjesa edhe ka komunikim me banorët e zonës së bashkisë së Beratit për tre ish-komunat, për Tepanin, të Sinjës dhe të Belabishtit, të cilët kërkojnë që të jenë një njësi administrative në vete të quhen bashki, a është dakord sot kryetari i bashkisë së Beratit? Është pyetje e drejtë për juve. Ndërsa për juve, zonja kryetare e bashkisë së Dimalit, e dini shumë mirë që ish-komuna e Cugalatit, një pjesë të mirë të kohës ka qenë me bashkinë e Roskovecit. Dhe si e tillë, largësia nga bashkia e Roskovecit mund të jetë jo më shumë se 2 kilometra, ndërsa për të ardhur pranë qendrës së bashkisë së Dimalit është diku te 27 ose 30 kilometra. A mendoni që ju, në kuadër të reformës së re territoriale, bashkia juaj të bashkohet me bashkinë e Kuçovës dhe ish-komuna e Cugalatit t'i bashkangjitet pjesës së bashkisë së Roskovecit? Mbase do të ishte zgjidhja më e mirë dhe ne do t'u vimë më afër qytetarëve tanë që t'u vimë në pjesën e shërbimeve. Për juve, zoti kryetar i bashkisë së Skaparit, e kam të njëjtën pyetje me zotin kryetar të bashkisë së Policanit. Është e vërtetë që një pjesë e mirë e fshatrave të zonës së Molitës mund ta marrin shërbimin, të gjitha shërbimet pranë bashkisë gramsh, dhe kjo është e vërtetë, pasi distanca për infrastrukturën e tmerrshme që është, që ju dhe unë dhe deputetët e qarkut e dimë, duan 4 deri në 6 orë në fshatin fundor për të marrë një shërbim pranë bashkisë së Beratit. A jeni të gatshëm juve që t'i propozoni këtij komisioni të nderuar që ajo zonë t'i bashkangjitet bashkisë së Gramshit dhe ju të bashkoheni bashkë me Policanin, ndërkohë që kryetari i bashkisë së Beratit për zonën që tha dhe kryetari i bashkisë së Policanit për zonën e ish-komunës Vërtopit, mund t'i bashkangjitet Beratit dhe Skapari dhe Policani të jenë një bashki? Unë dëshiroj një pyetje nga një përgjigje nga të pesë kryetarët. Faleminderit, nuk kam pyetje tjetër.

Arbjan Mazniku:

Po, i lutem kryetarëve përgjigje të fillimit, zoti Ceca, meqënëse ishin të fokusuara te ajo, më pas zonja Memaj.

Ervin Ceca:

Faleminderit, zoti Ismaili. Në lidhje me observimin tuaj në lidhje për pjesën e njësive Sinjë dhe Belabisht, patjetër që jam në kontakt, patjetër që ne i takojmë banorët, marrim

shqetësimet e tyre, por ajo që doja të theksoja unë është qasja ime. Qasja ime është, e thashë dhe në fillim, unë jam pro reformës, por me fokus tek funksionet dhe kompetencat, nuk hyj fare në debatin për ndarje territori. Unë jam i bindur sot dhe këtë e kanë treguar dhe vetë banorët me zgjedhjen e tyre. Jam i bindur sot që në të gjitha njësi të administrative të qytetit ka një shërbim më të mirë. Ka kushte më të mira sesa në krahasim me ish-komunat. Që të firmoset që të ndahet në dy bashki, bashkia e Beratit, një këto tre ish-njësi administrative dhe pastaj ju të merrni pjesën e. Është një propozim që nesër do ta ndeshin terren ish-komuna e Vërtopit, bashkangjitet Beratit dhe tre bashki, tre ish-komunat të kenë një bashki më vetë, bashkia e Shpirakut, që kërkojnë edhe shumë organizata dhe shumë pjesë të komunitetit në atë zonë. Këtë desha si përgjigje. Pastaj për shërbimet, indikatorët u kam analizuar, se vetëm në komunën e ish-komunës së Sinjës është kjo doktoresha që ta thashë, edhe unë e di shërbimin sikurse është në atë komunë dhe në ish-komunën e Sinjës është kjo që ta thashë, kjo mjekja, meqënëse e kërkoje që tek këta e marrin dhe e dini shumë mirë sikurse është. Atëherë, në lidhje me pyetjen tuaj, unë jam i bindur që bashkia e Beratit funksionon shumë mirë kështu siç është dhe nuk ka nevojë për ndryshime. Më thatë për, jo, jo, më thatë për ndarje. Më thatë për ndarje dhe bashkim për një bashki të re, bashkia Shpirak. Jo, jo, mos e keqinterpretoni, më thatë për një bashki të re, bashkia Shpirak. Jam pro reformës me fokus në funksionet dhe kompetencat, mos keqinterpretoni ato që unë them.

Juliana Memaj:

Faleminderit për pyetjen. Nga parashtrimet tuaja për funksionalitetin si dy fusha përgjegjësie, siç ishte arsimit dhe shëndetësia, që nuk janë fusha të përgjegjësive së pushtetit vendor, por janë fushë përgjegjësie të pushtetit qendror, e vetmja kompetencë që kemi ne në shëndetësi që na kaloi me 2015-ën, por nuk u bë efektive, ka qenë mirëmbajtja e qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Ne patëm një përpjekje në fillim të punës sonë, kemi bërë tre qendra shëndetësore në bashkinë Dimal dhe shtatë ambulanca të reja me fondet e bashkisë dhe dy me donatorë, por nuk na merreshin në dorëzim nga Ministria e Shëndetësisë. Ka pasur një konflikt, edhe pse ishte e shkruar në ligj që është kompetencë e bashkisë apo e njërive vendore. Edhe vazhdon që këtë kompetencë ne nuk e ushtrojmë, por ashtu siç ju theksuat, nuk është godina apo ndërtesa gjëja që lidhet direkt me funksionin. Mendoj që këto funksione duhet t'i kalojnë një pjesë edhe pushtetit vendor, që ato të jenë më efikase. Sot nuk janë. Marrim rastin dhe të infermierëve, me të drejtë ka raste që edhe ne na ankohen për prezencën e infermierëve në ndonjë fshat të thellë. Duhet që listë prezencë, të paktën minimumi, të mbahet nga pushteti vendor dhe të mbajë përgjegjësi për paraqitjen dhe shërbimin ndaj qytetarit. Nuk po flas për më tutje, edhe në lidhje me arsimin, me fushën e përgjegjësive së arsimit, kurrikula nuk është pjesë e jona. Ne kemi mbajtjen e shkollave dhe godinave që e kemi bërë shumë mirë, besoj pas reformës territoriale ka pasur një përmirësim të ndjeshëm. Ne kemi ndërhyrë gati në rikonstruksion të plotë falë financimit të qeverisë, me bashkëfinancim dhe nga njësi vendore, në 12 shkolla të reja nga 21 që kemi gjithsej, në 8 rikonstruksione të pjesshme në bashkë me të ardhurat e bashkisë në këto 10 vite. Kështu që mirëmbajtja e shkollave dhe infrastruktura e këtyre godinave është përmirësuar ndjeshëm para 2015-ës. Mund të sillni dhe foto sa të doni, po të paktën për bashkinë

Dimal, por edhe më tutje kjo rezulton më e saktë. Ka një, kaloi në atë kohë edhe parashkollori si funksion që e kemi ne, edhe aty ka përmirësim të ndjeshëm. Biles, bashkitë kanë filluar të punësojnë edhe mësues ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara. Ka pasur edhe një ndihmë nga projekti i bashkisë Forta në këtë kohë dhe ka pasur goxha progres në këtë fushë përgjegjësie. Ajo që besoj që do vijë dita, që edhe në një funksion ai parashkollori, që është parauniversitarit, që është deleguar me pilotim në disa njësi si bashkia Berat, më duket që ndër qarku, nuk di ende çfarë efekti ka pasur ky delegim asimetric, por besoj që do ishte më e mira që këto funksione në një pjesë të tyre të delegoheshin dhe të kishte përgjegjshmëri edhe për qendrat shëndetësore, ashtu siç ju e thatë nëpër bashki, që apo ambulanca të ketë një kontroll për pjesën, të paktën siç e thashë, të kësaj. Në lidhje me pyetjen që bëre për territorin, unë besoj që në përgjigjen time të parë e bëra një profil shumë të saktë të kësaj bashkie, që ka pasur një vëmendje të theksuar për investime kudo në territor, edhe në njësinë më të largët, Cugalat. Ne kemi ndërhyrë falë dhe investimit të qeverisë, ka pasur investim në ujësjellës aty ku për gati 100 vjet shtet nuk kishte ujë të pijshëm. I çuam ujë të pijshëm gati tre fshatrave nga pesë që gjithsej presin financimin për fazën e dytë, investime në rrugë, mirëmbajtje rruge, edhe në rrëshqitje derash në fshatin më të thellë. Kemi qenë prezentë falë edhe delegimit të mjeteve në atë kohë që u bë e mundur me reformën e 2015-ës, që ne aksesojmë dhe ndërhyjmë, sepse unë e thashë, bashkia Dimal ka një profil të tillë që është e menaxhueshme për shkak të sipërfaqes së vogël dhe tenducisë së banorëve. Jemi e vetmja bashki me rritje në censusin e fundit. Kjo tregon që i kemi shërbyer me efikasitet qytetarëve për pjesën që i takon funksioneve që ne ushtrojmë dhe vetë, jo për funksione që nuk varen nga ne. Dhe besoj dhe një decentralizim më i madh funksionesh në njësitë vendore do t'i bënte ato akoma më efikase dhe qytetarët do të mbaronin punën më shpejt. Po, jo, jemi kundra. Ne jemi për, unë e biles kam bërë një parashkrim në pyetjen në përgjigjen e parë të zotit Eno, që përderisa ne jemi funksionalë dhe kemi bërë investime gati njësoj me qeverinë në këtë bashki, në këto 10 vite kemi një raport shumë të mirë për të shpenzimet investime kapitale. Aksesin në territor është gati 99% të fshatrave kemi të lidhur me rrugë nacionale. Mendoj që nuk ka ndonjë arsye për këtë. Edhe vetë njësia Cugalat, për nga tradita, ka qenë në historikun e vete e lidhur me rrethin e Beratit. Nuk ka qenë ndonjëherë me rrethin e Fierit. Faleminderit.

Zija Ismaili:

Faleminderit. Po, kështu. Faleminderit. Ajo që unë kuptova nga dëgjesa e kryetarës së bashkisë së Dimalit është që reforma e vitit 2014 e implementuar në vitin 2015 nuk i ka plotësuar standardet e veta, edhe pasi transferimi i disa shërbimeve, mungesa e kompetencave dhe mungesa e investimeve në këto njësi administrative ka bërë që të jetë mungesa e shërbimeve. Dhe ato pastaj të gjitha këto ndaj mora, unë nuk mora përpyetje për pjesën e shëndetësisë dhe të arsimit. Mora indikatorë që unë kam analizuar se si reforma ka qenë e suksesshme apo ka qenë e dështuar. Në këndvështrimin tim, të lutem, të lutem, në këndvështrimin tim dhe qytetarëve, reforma me indikatorë që ne i analizojmë është totalisht e dështuar. Pra, unë thashë, nuk ka dhimbje më të madhe sesa dikush që

braktis vatanin e vet. Të lutem, të mbarojmë se unë të dëgjova. Ndërsa për pjesën e për pjesën e asaj që ishte pyetje drejtpërdrejtë, në lidhje që të gjithë këto mungesë kompetencash që juve sapo i thatë janë dështim i reformës, normalisht se kjo është në kompleksi i asaj që unë kuptova vetë, mbase kam kuptuar gabim. Pra, unë e kam, e kam në patronazhim godinën, por nuk kam në mbikëqyrje infermierët dhe mjekët. E kam shkollën, do ta pastroj, por nuk kam arsimtarin edhe nuk e di çfarë bëhet. Kam transportin, por nuk kam fondin. Kam këto, pra, elementë të cilat janë shërbime bazike për qytetarët. Kjo është ajo që doja të thosha dhe në pjesën e asaj që në kuadrin e afrimit të shërbimeve tek qytetari, që të jemi sa më afër qytetarit për shërbimet, se ndaj po e bëjmë dhe këtë diskutim dhe këtë gjest, është që a jeni ju të gatshme që për hir edhe të mos kompetencave, se mbase dhe ashtu se nuk e di nëse ka dhe një arsye tjetër, ka ndonjë indikator tjetër, mbase juve nuk keni dhe administratën. Nuk keni arkitekt, inxhinier, jurist, ekonomist, pra nuk jeni të papajisur me dhe mbase do bëhen diku tjetër këto projekte, këto tre gjëra. Pra, a jeni, jeni të plotësuar me performancë të mirë të të gjithë personelit teknik: ekonomist, jurist, inxhinier, arkitekt që bën projektet, apo jeni të gatshëm të bashkëpunoni me bashkinë e Kuçovës dhe të jetë një bashki e vetme e cila mund të vijë më afër shërbimit të qytetarëve? Pastaj, kjo ishte pyetja që unë do e thosha dhe juve sa thatë që nuk jeni dakord, besoj, apo jo? Që s'jeni dakord për këtë dhe okej, unë e kam marrë përgjigjen time për këtë. Faleminderit.

Juliana Memaj:

Ja, në vijim të diskutimit tuaj, nuk jam katërpërsërisë dakord për faktin që nuk ka qenë e suksesshme reforma e 2014-s për kompetencat që u deleguan. Ka pasur sukses dhe ka qenë afër qytetarit, të paktën për bashki të nivelit dhe të dimensionit të Dimalit. Flas, është folur këtu që bashkitë e mëdha janë më efikase nga raportet apo performancat e paraqitura. Pra, nesh unë them që në lidhje me ato ç'ju parashtruan, dy funksione e arsimit dhe shëndetësinë që nuk kanë qenë ndonjëherë tonat dhe nuk janë deleguar për nivelin e cilësisë së shërbimit, për kurrikula, kurse për pjesën e godinave janë deleguar. Por reforma ka qenë e suksesshme, sepse ne kemi arritur në këto vite të bëjmë 574 km kanal pullus. Kemi arritur të kemi mirëmbajtje rrugësh në mënyrë të vazhdueshme. Kemi ndërtuar gati 12 shkolla të reja, shtatë ambulanca e me radhë, ndërkohë që një njësi me të ardhurat e veta më parë nuk mund ta bënte. Ish-njësitë, unë ja u thashë, kam qenë vetë juriste dhe kam punuar në atë kohë dhe e njoh se si funksiononin ish-komunat. Po nuk ka nikur nga shërbimi i bashkive, që nga funksionet që kanë bashkitë. Këtu ngatërroheni. Nga funksionet që ofrojmë ne, nuk janë larguar nga funksionet. Më vjen keq, s'jam dakord.

Adriatik Zotkaj:

T'i përgjigjem pyetjes tuaj, zoti Zian. Mua më bëhet qejfi që më në fund doli ai produkt që ju e keni nën tavolinë. Vath një variant. Pak a shumë pa dashur, vath një variant. Ju të opozitës apo MET-it që thatë po të bashkohen, nëse po ato, nëse të janë poshtë tavolinës. Okej, okej. Pse pikërisht morët skraparin dhe policanin? Pse pikërisht morët policanin skrapaj? Pse s'morët policanin e Beratit? Më fal, okej. Po ja u kthej përgjigjen. Po ja u kthej përgjigjen. Jam i qartë. Jam i qartë, i dashur. O, më fal, o zotëri deputet. Zotëri

deputet, të lutem, përgjigja ime është nëse unë jam dakord. Të lutem, thjesht t'i lëmë kohën secilit mbarojë përgjigjen e vet. Nëse unë jam dakord, kryetari i bashkisë policanit është dakord të bashkohet me skraparin. Unë e thashë që në krye të herës. Nuk ka një bashki në Republikën e Shqipërisë që ka hequr në kurriz këtë bashki e policanit, sepse e kemi qenë të tillë. Ne nuk kemi pse bëjmë provë me plagët dhe plumbat që kemi marrë në trupin tonë. Nuk kemi pse i rikthejmë kësaj historie. Dhe nga ana funksionale, po ju them, bashkia e policanit është 272 km edhe 700 e ca, nuk e di saktë sa është skrapar. Ndosht që 1000 e ca kilometra do t'i vijë më pranë shërbime qytetarit, më afër qytetarit. Më thoni. Tjetër, në qoftë se ne sot, në qoftë se ne sot kemi shpopullimin e fshatrave, thashë do vijë të qytetit dhe nëse sot janë 15 shkolla në bashkinë e policanit, pastaj do ketë një shkollë dhe do ketë shkollë të bashkuar që do rrisim një brez të parë si mua. Pra, ju këtë reformë do ta shikoni në shumë drejtime. Unë thashë mendimin tim.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Zotkaj. Ka një pyetje tjetër? Po, të lutem. I nderuar kryetar. Më fal. Po, zoti Emem.

Adriatik Mema:

T'ju jap edhe unë përgjigjen, sepse edhe pyetja ishte e drejtpërdrejtë. Shiko, doktor, unë e thashë atë në fillim të parashtrimit tim për shkak se kur ka qenë periudha e pandemisë, gjithë ajo zonë që ju e njihni shumë mirë i ka marrë falë ndërhyrjes tonë shërbimet nga Gramshi. Dhe faktet janë fakte. Fshati më i largët, më periferik i skraparit sot është 45 minuta nga Gramshi. S'ka nevojë të përmendim emra, se ju i dini dhe s'kanë, edhe sikur t'i them, nuk do t'ju, do ta mbajnë mend. Dhe ajo që thashë në fillim të fjalës time është: nuk është tabu që këta, këto fshatra, jo e gjithë njësia, për hir të vërtetës, të kalojnë me Gramshin për shkak të afërsisë gjeografike, etj., etj. Edhe në sistemin e kaluar ka pasur gjëra të tilla. Nga njëra anë, por të ecim sot, thashë, me këtë logjikën që skrapari sot kufizohet me 6 bashki dhe të fillojmë ta ulim perimetrin, sepse ky fshat kufizohet me Përmetin, ky me Gramshin nuk funksionon kështu një reformë. Më duhet që të them që në krye të herës, po, unë jam pro reformës territoriale, por unë them që ajo reformë që është bërë në 2014-n e ka kryer misionin e vet dhe fakti që ju jeni në këtë komision do të thotë që ajo ka nevojë të përmirësohet dhe të gjithë jemi dakord që ajo reformë ka nevojë të përmirësohet. Edhe thashë edhe njëherë dhe po e përsëris që sa kohë Shqipëria synon që shumë shpejt të anëtarësohet në Bashkimin Europian, ne duhet të përmirësojmë disa standarde që t'ju afrohem vendëve të Bashkimit Europian. Por më bësh këtë pyetje që të krahasim pak tej dhe t'u japim policanit, a jemi dakord? Më duket si pyetje kështu provokative në thonjëza dhe nuk jam unë personi i duhur që duhet të jap përgjigje për këtë gjë. Pse, më fali një sekondë, nuk e përdora në kuptimin e keq fjalën provokativ, kupton? Doktor, ato dy fshatra që kemi unë dhe ju në mendje, mendon se do popullohen po vajtën me Gramshin? Ke fshatrat e shumë të rëndësishëm këto këtu. Ke fshatrat e shumë të rëndësishëm. Po, jo, po marrim këto. Po, po, po marrim këto, ato dy që kemi ne ndërmend, do popullohen ato? Njëra e njëjta. Duhet marrë tashmë, dita e majit tashmë është shërbimi polican i përdorur. Nuk e di distancën andej. Unë isha, unë isha duke thënë. Shërbimi

polican i përdorur. Nuk isha, isha duke thënë që një sekondë, unë isha duke thënë se unë jam bërë këtë pyetje të drejtë, e kisha provocative...

Zija Ismaili:

Thashë që në formën asaj. 2014-s me ato vizat elektorale që u vendosën që ne të bëjmë një ndarje. Nëse jeni ju të gatshëm, e cila do t'i shërbejë shumë.

Arbjan Mazniku:

Zoti Ismaili, se u bë pyetja. Të mose, zoti Ismaili, të lutem, mos e bëjmë debat. A e dëgjojmë, zoti Emem?

Adriatik Mema:

Kjo nuk bëhet me matematikë. Ka 775 km katrorë skrapari, i shtove dhe 200 e ca që thotë ai i policanit edhe hajde ta bëjmë bashki. Nuk është kështu, nuk funksionon kështu. Ashtu sikurse nuk është e vërtetë që ai thotë që 34 vjet s'është vendosur një gur, po pse çfarë ka qenë policani 34 vjet? Ku? Kur është bërë bashkia? Le të flasim. Po bëj muhabetë kot.

Arbjan Mazniku:

Ju lutem, se nuk e hyjmë dot në këtë debat. Jo, të lutem, zoti Zotkaj, se nuk, me gjithë dashamirësinë, nuk do të funksionojë kështu ky ushtrim. Ka. Atëherë, po, zoti deputet, ju lutem, edhe ta përmbyllim këtë seancë, sepse jemi dyer në dhomë me fjalë. Zoti Zotkaj, të lutem. I nderuar kryetar. Po, zoti Zotkaj, vazhdo. Dakord, vazhdo. Po, nuk mbaroi. E para.

Adriatik Zotkaj:

Edhe njëherë, edhe njëherë, kryetari, unë thashë në përgjigje që tha zoti Zihan dhe thashë 34 vjet se ky është fakti dhe hajdeni dibeni të gjesën në qytetin e policanit. Nuk është vënë një gur dhe këtë e them me plot bindje. Një gur.

Arbjan Mazniku:

Në cilin 34 vjeçar flisni? Jo, pra pyetja që ishte, cili 34 vjeçar? Në mbasuj kohën, nga cili vit në cilin vit?

Adriatik Zotkaj:

Po flas para kohës, me fjalë, flasim në kohën e verës, jo në vitet e demokracisë. Nëse para '90-s, nuk është vënë asnjë gur polican. Nëse Arbër Pomaznik, nëse ka, nëse Klosi tha një statistikë, Pomaznik, do të dëgjosh apo? Nëse Klosi tha një statistikë që policani është i pari në Shqipëri që ka votuar 80% Partinë Socialiste, ka qenë vetëm prej reformës që kur është bërë qytet dhe ka bërë shkëputjen e tij nga skrapari, sepse historikisht nga Bogova e këtej ka qenë, ja jap, e kam dhe këtu, ja do t'ua kaloj edhe në telefon të gjithëve këtyre ose në media, ka qenë nahia e Beratit. Policani kurrë s'ka qenë i skraparit. Kurrë s'ka qenë asnjëherë i skrapari dhe nuk mund të bashkohet kurrë. Dhe kjo është që nuk

është vënë 34 vjet, nuk është vënë një gur në atë qytet, sepse po të flasim me historinë, hajdeni në polican, shikojmë statistikat dhe shikoni se si do presin ata njerëz. Pra, Partia Socialiste është votuar 80% vetëm prej kësaj reforme dhe kjo reformë, në qoftë se do bëhet sot, besoj se do e kalojë këtë krah tjetër. Se s'ka parti tjetër.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti zotëri. Zoti deputet.

Hysen Buzali:

I nderuar kryetar, të nderuar kryetarë të bashkive, të nderuar kolegë. Nuk dua të thellohem, sepse kryetari i parashtruan ato çfarë kishin për të kaluar në tërësinë e bashkive. Kështu, skrapari dhe policanit kanë afërsisht. Vetëm skrapari ka diku te 106 fshatra, nëse nuk gaboj. Dhe 20 e ca dhe 28 janë dhe të policanit. Shtrirja gjeografike e parashtruar të dy kryetarët shkon në 1000 e ca kilometra katrorë. Askush nga ne këtu nuk është për të mbrojtur interesat personale. Ne këtu jemi për të mbrojtur interesat e qytetarëve. Se si është më e mira për të mbrojtur interesat e qytetarëve, unë do t'i kërkoja atij komisioni që ndoshta, në fund të fundit, unë jam deputet i qartë ku të Beratit nuk jam vetëm i policanit dhe i skraparit, por jam shumë i sigurt që këto dy bashki kanë një specifikë të veçantë. Shkurtimisht, do t'i kërkoja që të ketë një vëmendje të veçantë dhe një mirëstudim për atë çfarë ne po flasim. Sepse në 1000 e ca kilometra katrorë do të ishte jashtëzakonisht shumë e vështirë që të menaxhojnë në një bashki. Pastaj, nëse policanit do të shkojë në Berat apo Berati, më fal, do të shkojë në skrapar, kjo është diçka që bashkërisht do të ishte mirë për t'u thelluar dhe për ta vendosur këtë lloj ndarjeje. Por do të kërkoja që, për shkak të specifikës së shumicën e fshatrave, për mos thënë dhe 90% unë i kam shkelur vetë, për shkak të specifikës si zonë, sa do të kërkoja një ndarje deri diku dhe kirurgjikale. Nga ana tjetër, nuk jam dakord me zotin Ismaili që kur parashtroi që në skrapar janë 10 i fermerë që nuk shkojnë në punë, e sfidoi duke i thënë të më japin emrat dhe në të kundërt t'i drejtohet deputetit që ju është e vërtetë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Atëherë, zoti kryetar, për. Një sekondë, një sekondë. Po, sfidoj. I nderuar koleg.

Zija Ismaili:

Deputet, radhë të parë do të falënderoj jashtë mase për guximin që more dhe që i kërkon kolegëve të tu të mazhorancës. Se unë ta mbaroj. Që reforma e re që kërkohet për t'u bashkuar skraparin me policanin, ju jeni i pari dhe jeni kundër kësaj reforme dhe nuk keni dakord se ky është plani që ka bërë dhe për këtë duhet të falënderoj, të lutem. Për këtë, për këtë do të, për këtë do të, për këtë do të falënderoj. Të jesh i bindur që ju i keni studimet dhe i keni dhe planet sa e pranoi kryetar i bashkisë policanin që i keni poshtë tavolinës ABC si i keni si kështu. Kështu që ti nuk qaje kundra këtyre të treja planeve që ka Partia Socialiste dhe mazhoranca për ndarjen territoriale dhe për reformën e re që kërkon të bëjë në lidhje me personelin i cili jeton në Tiranë dhe në Durrës shëndetësor dhe nuk dhe merr

pagën aty. Të jesh i bindur që do t'i vendosë shumë shpejt. Do t'i të regjistrohet. Çfarë teme kemi? Jo, nuk është e regjistruar. Është, është e regjistruar dhe po nxirrni ekranin pa merak, jeni la. Në lidhje me pjesën e personelit mjekësor të cilët të marrin pagat në rajonin e bashkisë Skraparit dhe jetojnë në Tiranë dhe në Durrës dhe nuk kanë afrojnë shërbim, për këtë të jesh i bindur që do t'i paraqesë me video, me foto në qendrat, në qendrat dhe ambulancat ku ata punojnë dhe nuk janë asnjë ditë në punë. Edhe këtë do t'ia drejtoj dhe organeve të procedurës për këtë ta garantoj. Përsa për këtë dua të falënderoj dhe njëherë që thashë që normalisht më në fund paska dhe një njeri të ndershëm socialist i cili është kundra kësaj mazhorance, është edhe kundra kësaj reforme e cila nuk do të jetë brastare, por do ta garantoj që do t'i dënojë me vdekje shqiptarët nëse do të bëhet me atë projekt që ka Partia Socialiste. Faleminderit.

Hysen Buzali:

Zoti Ismail, ajo unë asnjë moment nuk e thashë që jam kundra ndarjes territoriale, por thashë për të mirë të qytetarëve duhet një bashkëpunim dhe të ecim përpara për të arritur atë çfarë ata kërkojnë. Për sa i përket këtij të dytës, të pres shumë shpejt duke vënë emra në dispozicion dhe duke i bërë ndoshta dhe publike, por jam shumë i sigurt që e ke të gabuar. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Tani, përpara se sa besoj ta mbyllim këtë seancë duke falënderuar kryetarët e bashkive, dy fjalë të fundit vetëm për një qartësim i cili tenton të ngrihet rregullisht. E kemi nisur në orën 10:00, është fjeri që pret jashtë, qy nga ora 12:00. Pra, kemi lënë kryetarët e bashkive, të një qyteti dhe deputetët e një qerre prej 2 orë e 10 minuta që presin mbas dere dhe kemi, domethënë, është ashtu ka vazhduar historia. Kemi fjerin, e bëni aty gjithë dy minuta. Tani, të them unë vetëm një fjali, do të them. Së pari, në mënyrë sistematike, tentativa për të hedhur idera dhe teori që ky do të shkrihet me këtë, ky do të bashkohet me këtë, ky do të ndahet nga ky, janë gjëra të cilat në mënyrë shumë të qartë dhe të qëndrueshme, mazhoranca s'e ka thënë kurrë. Krijimi i tezave hipotetike, ky atje e ai andej, po sikur kështu e sikur ashtu, e kthen këtë diskutim në një lojë kungulleshkash. Ndërkohë që synimi i këtij komisioni duhet të jetë të shohim faktet, realitetet dhe të bëjmë vendimmarrje bazuar mbi të dhëna të cilat kombinojnë edhe efektivitetin funksional dhe mundësinë për t'i ofruar njerëzve shërbime dhe identitetin zonal dhe identitetin historik dhe mundësinë për të ofruar shërbime njerëzve. Kështu që, po të merreshim edhe ne që si u dashka me u nda Berati me tre pjesë dhe po e ndan Beratin me tre pjesë, çfarë do të ndodhë me ato komunat? Pra, me të marrim në analizë hipotetike, teza hipotetike, ky debat nuk mbaron në 100 vjet. Kështu që, kërkesa që kam për të gjithë palët, përfshirë këtu dhe një kryetar bashkie pasionant, është që të mos hedhim hipoteza dhe. Po pasionant me popullin, pra po janë të shkruajtur të dyja bashkë ato. Po, nuk është, zoti Zotkaj, zoti Zotkaj, është fjalë e mirë, nuk është fjalë e keqe. Është fjalë e mirë, më beson. Patjetër, po ta them, ta thashë për kompliment, ta thashë për kompliment dhe po them që ta thashë për kompliment, merret si të tillë dhe po them që na duan më shumë. Po, prandaj e kemi vënë gjithë këto vite, se e kemi shumë të mirë. Po se zu, more përkundrazi, unë

sapo e lavdërova. Tani, po të them, po them që në tërësinë të logjikës është që jemi duke analizuar dhe vlerësuar si i bëhet më mirë qytetarëve, edhe atyre që janë të zoti Zotkaj. Faleminderit, ta mbyllim këtë takim. Po, po.

Igli Cara:

Faleminderit, zoti kryetar. Atëherë, së pari, e kam për procedurë, shpesh dëgjojmë këtë fjalëshin: "Kohë e humbur, po na presin kryetarët e bashkive, kemi vendosur një kalendar." Jo, kam thënë dhe më parë, zoti kryetar. Tani, në qoftë se neve jemi këtu në këtë komision thjesht për të bërë një fasadë që po bëhet një reformë administrative territoriale, unë besoj që nuk na vlen. Në qoftë se keni vendosur një kalendar që duhet të bëjmë tre bashki treqarqe në ditë, fakti ka treguar që kjo gjë nuk po funksionon dhe kjo pastaj, duke na kufizuar dhe me oraret, na keni bërë që edhe mos të jemi produktivë. Pse jo të kalojmë në debate me njëri-tjetrin, t'i marrim kohën njëri-tjetrit, pastaj të shkojmë tek ato veprimet që pamë që ne ikim për pesë minuta, ju pastaj në mënyrë të paimagjinueshme filloni vetë dhe me radhë. Që mos të ndodhin këto, unë propozoj që, fundja, me këto bashki që na kanë ngelur, këto qarqe që na kanë ngelur, mos i bëjmë më brenda ditës, se nuk ka sens, nuk ka kuptim. Po bëhemi qesharak, sepse nuk po japim kohën e duhur as kryetarëve të bashkisë, por edhe ne me njëri-tjetrin dukemi sikur nuk jemi ardhur këtu për t'u zgjedhur për kohën, për t'u grindur për kohën, nuk ka kuptim kjo. Ndërprite. Sepse dy orë po presin kryetarët, ky tokë fjalësh nuk duhet të ekzistojë, sepse kjo punë që ne po bëjmë do ketë efekte, nuk do ketë efekt një vit, do ketë katër vjet, tetë vjet, dymbëdhjetë vite, nuk kemi pse të lutemi. Në qoftë se kemi për të bërë një punë për t'i dhënë përshtypje publikut që ne po bëjmë punë, po s'po bëjmë asgjë, më mirë mos na thërrisni, se nuk ka sens, jua thashë edhe rastësisht, se ai debati juaj për punën, se dhe ju të rrëmbeni mikrofonin, se më takon mua, me thënë të drejtën, nuk po japim ne përshtypje të mirë, se nuk ka sens. Tani, do i dëgjova me respekt dhe me thënë të drejtën, unë personalisht nuk njoh asnjë nga kryetarët e bashkive, por ama tre gjëra dhe më shumë ato na thanë sot, të vërtetën. Teoria që bashkitë e vogla nuk kanë kapacitete e rra, sepse siç dhe ato thanë që ne në bashki të vogla kemi funksionuar më mirë këto ditë.

Arbjan Mazniku:

Tre procedurë, të lutem, kalove në analizë. Po bëjmë prapë fillove. Meqenëse na bëre një diskurs shumë të mirë për ndarjen e kohës dhe për rregullin e funksionimit, si duhet të funksionojë koha.

Igli Cara:

Po atje e mbylle pa ma lënë mua mundësinë të marr kohën, po të shih. E mora këtë një minutë që unë e kisha bërë.

Arbjan Mazniku:

E merr për procedurë dhe pastaj bën analizën e çfarë të mësuam sot.

Igli Cara:

Folëm për pavarësi. S'është procedurë më. Për pavarësi. Po më jep edhe unë një konkluzion, po unë mund të them jo, po kaloj tre minuta që më ndërprit. Po kaloj tre minuta që pastaj do të kaloj, të jesh i sigurt. Pra, folëm për pavarësinë. Të pesë kryetarët, në një farë mënyre, na thanë që kemi nevojë që disa të kompetenca që na janë marrë nga kryeministri t'i kthehen, apo jo? Folëm për autonominë financiare, të thanë që kemi akoma më tepër mundësi për të rritur autonominë financiare, apo jo? Dhe një nga treguesit është, për shembull, që e kanë ngritur edhe një qark tjetër i Durrësit, ku thashë, për shembull, transporti rrugor është një taksë qarkullimi që merret tek nafta, por mjetet nuk lëvizin vetëm në rrugë kombëtare, lëvizin dhe në bashki, pikërisht në bashkitë e tyre, në rrugët e tyre. Duhet t'i kthehet një pjesë e mjeteve, t'i shtojë më tepër para, më tepër mundësi për të investuar në zonat e veta. Pra, të gjithë, pse po e them këtë? Zoti kryetar, kryetarët janë të vërtetë, sepse do ballafaqohen nesër me elektoratin e tyre dhe kjo është një gjë e mirë, se ne sot morëm disa të dhëna, pikërisht nga pesë bashki, të cilat janë të mazhorancës, që ato çfarë deputetët e opozitës kanë thënë, kanë qenë të drejta. Shërbimet më të mira merren kur janë bashki që janë më pranë qytetarit dhe kur jo janë periferike larg. Siç na ka ndodhur edhe me Durrësin gjithë kohës, që shërbime larg qendrës nuk merren. Ky është fakti. Prandaj, mirë është që këto që na thanë sot kryetarët, ato që i vlejné reformës, t'i mbajmë shënim dhe ato teza dhe ato që ne themi, nuk kemi nxjerrë teze. Ju keni nxjerrë një teze, keni thënë dhe për rajonet dhe unë prisja sonte që të ngrihet një teze e re, pra në bashkitë, që t'i kthehen në rajone, të bëjmë rajone më të mëdha, më të që dhe të marrin disa kompetenca të kryetarëve, se dhe kjo do të jetë një teze, se kur të vijë momenti që do të votohet, mirë është që t'ia merrni një mendim. Se janë dakord që të vendoset rrethi apo qarku mbi ju, që të bëjë organizim për investimet, ndërbashkiaket e me radhë? Jeni dakord ju për këtë pikë, se i bjen që do ju merren ca kompetenca të tjera, përveç atyre që ka marrë kryeministri. Gjithsesi, për ta mbyllur, zoti kryetar, unë bëra një propozim dhe e uroj që së bashku me zotin Boçi ta keni në konsideratë. Këto komisione për qarqe, kur mbyllen brenda dy orësh, më besoni, nuk kanë efekt. Mirë është që ta bëjmë katër orë, pse jo dhe pesë orë? Minimumi, ne si opozitë kërkojmë që vetëm ne si opozitë të kemi minimumi një-dy orësh. Në qoftë se ju doni ta hiqni kohën tuaj, hiqeni, por nuk mund ta thoni që brenda dy orëve, sikur të flasim nga dhjetë minuta, ikën një orë, e marrin vetëm kryetarët nga dhjetë minuta në total. Po çfarë ngel për ne? Atëherë, që të mos bëhemi dhe joproduktivë, i bëjmë një ose dy qarqe në ditë, na shtoni ditët e punës, se vijmë ne, nuk po përkthejmë, por mos na e bëni tre qarqe brenda ditës, se thjesht po bëjmë fasadën këtu dhe produkt nuk do të kemi. Faleminderit, zoti. Jo, po.

Xhelal Mziu:

Për të shkuar në atë se çfarë thotë zoti Cara, duke marrë shkak edhe nga dy takimet e tjera që kanë bërë më nga tre qarqe, ku jemi të cunguar në kohë, sot ishte një tjetër zhvillim që e cungoi kohën e komunikimit. Propozimi im është që Shkodrën mund ta lëmë për një ditë tjetër, madje kemi edhe tre qarqe që të paktën të kemi vetëm dy, jo tre, se kështu bëhet pak qesharake, bëhemi të padrejtë në kontakt me kryetarët e bashkive që vijnë dhe presin. Pra, të kemi kohë mjaftueshëm dhe ndërkohë të mos ndodhim përpara kësaj situatë dhe në dëgjuesën tjetër. Kështu që unë do të propozoj që Shkodra ose t'i bjen që ne të rrimë deri në orën tetë e nëntë apo dhjetë dhe të marrim masat për dëgjuesën tjetër

që janë tre qarqe. Pra, është e pamundur për të patur një efektivitet komunikimi të drejtuesve të bashkive në lidhje me komisionin.

Arbjan Mazniku:

Tani, unë teksa bie dakord me idenë që nëse është e mundur takime të tjera, sepse kjo është kalu nga takimi i dëgjësës në një çështje procedurale, që është e drejtë që t'i bëjmë dy, por kjo kërkon ditë. Që do të thotë, unë i kam kërkuar opozitës formalisht që hajde të bëjmë dhe këto në dëgjesa. Unë s'kam asnjë problem, se çështja është të mërkurën kemi dëgjesa, të martën dhe të enjten kemi dëgjesa në terren. Unë dhe zoti Boçi kemi qenë në terren në këto ditë dhe në udhëtim dhe në lëvizje. Unë nuk kam asnjë problem të hënën apo të premten të bëjmë dëgjesa, edhe këtë të premte të bëjmë dëgjesa, edhe të hënën, edhe të hënën tjetër. Po, por më është thënë që nuk ka pasur dakordësi se kanë angazhime tjera. Kështu që unë nuk ka rëndësi të gjithë, që të mos e bëjmë diskutim këtu, sepse nuk ka vlerë. Nëse bie dakord nga ana e opozitës për një ditë tjetër, e hëna shumë ok dhe e adjustojmë gjënë. Për çështje, por ama unë kam dhe një diskutim tjetër, unë kam një diskutim tjetër që duhet të bëjmë. Diskutimi që duhet të bëjmë është ky: e duam dy orë, e lëmë dy orë takim. E doni ta bëjmë tre orë? Të lutem, i dëgjova, nuk kam asnjë problem, këtë po ju them. E duam ta bëjmë tre orë? E bëjmë tre orë. E duam katër? E bëjmë katër. Por ama gjëja që do të bëjmë dakord është që për sa kohë që jemi në një dëgjes, që do të thotë kemi thirrë disa njerëz për të dëgjuar, jo që t'i japim një leksion kryetarëve të bashkive, ne do ta ndajmë kohën, një raport 30% ne, 70% ata. Dhe duhet të bëjmë dakord 30% që fillon të ndahet, pastaj e lëmë tre orë, një orë ne, dy orë ata. Një orë që të ndahet 30 minuta e 30 minuta, pastaj 30 minuta që ta ndajmë pesë veta nga dy minuta, një vetë 30 minuta, të shënë si ka, por ama logjika është matematika, matematika e çon ushtrimin kështu. Nëse do të bëjmë dakord, flasim 30% ne të bëjmë pyetje, 70% opozita, më fal, kryetari të përgjigjet. E duam tre? E bëjmë tre. E duam katër? E bëjmë katër. Po ama raporti duhet të jetë 30-70 dhe tridhjetëshin do ta ndajmë 15% mazhoranca, 15% opozita, por ama, por jo, jo, një sekondë, ne do kemi, ne do kemi, ne ne pastaj, nëse zoti Mziu, nëse doni të bëjmë një seancë tjetër komisioni pa kryetarët e bashkive, ku ne të debatojmë me njëri-tjetrin, diskutojmë, debatojmë, flasim, lejmë pesë orë dhe lejmë dy orë e gjysmë ju, dy orë e gjysmë ne dhe flasim sa doni, nuk kam problem, por në qoftë se i kemi vënë emrin seancës dëgjes, në atë moment kemi thirrë njerëzit t'i dëgjojmë njerëzit, duam të bëjmë një seancë debati ne me njëri-tjetrin, për çfarë teme doni juve, ulemi dhe bëjmë debat, për një element, cilindo element që doni, të bëjmë debat, për financën, për shërbimet, për funksionet, për territorin, nuk ka rëndësi, por ama në këtë fazë kemi rënë dakord që do të dëgjojmë palët. E bëjmë 30-70, e doni ta bëjmë? Nuk ka problem, dëgjo, unë jam shumë i hapur dhe e kam treguar gjënë, e doni 46 vjet? 46 vjet, po të biem dakord për një rregull dhe t'i qëndrojmë rregullit. Do t'ju jap vetëm një të dhënë, të lutem, dhe me këtë ja çfarë ka treguar historiku. Zoti, e kuptoj, e kuptoj, po shkojmë bashkë këtu, ja t'ju jap një, po patjetër që ka nevojë dhe për dokumente, t'ju jap një tregues të vogël, është grafiku i kohës në dëgjesën e Korçës. Është folur 130 minuta, nga këto 34.7 minuta ka folur zoti Mziu, 27 minuta kam folur unë, 25.2 minuta ka folur zoti Boçi, 21 minuta ka folur zoti Nallbati, 9 minuta zoti Pacaj, 6.6 minuta zoti Jaj dhe 6.6 minuta zoti Pendavini. Në konkluzion, janë folur 80.9 minuta nga opozita ose 62.2% dhe 49.2 minuta nga

mazhoranca ose 37.8%. Ato i ka zgjedhur populli, po tani ato nuk do t'i heqim kryetarët tani, do bëjmë, po si do e bëjmë? Kështu që kjo, jo, jo, po flas, deputetët, deputetët kanë kohën e vetë, ata kanë kohën e vetë. Tani, falenderoj kryetarët për kohën dhe bëjmë pesë minuta pushim sa të futet dhe të rregullohet Fieri.